



SOCIOLOGJIA ISLAME

Dr. ALI SHERIATI

Me emrin e All-llahut

Kurrsesi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e All-llahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre. (Ali Imran: 169)

Nga frika e vetmisë deri sa kërkoja vendstrehim në histori u takova me vëllain tim Ajn el-Kuzat i cili ishte dënuar me dënim me vdekje për shkak se kishte ditur, kuptuar dhe nuk kishte pasur frikë të mendojë.¹ Në një kohë kur padituria ka qenë dominante, “dituria” është llogaritur si vepër kriminogjene. Nuk ishte për t’u falur ai i cili arrinë që brenda një shoqërie e cila është e shtypur dhe e përbuzur të mbetet me moral të ngritur dhe me guxim të plotë, apo siç do të kishte thënë Buda, “të bëhet ishull në botën e liqeje”.

Ali Sheriati
Nga parathënia për Kevirin

¹ Ajn el-Kuzat Hamadani, dijetar Iranian i cili është vrarë në Bagdat në vitin h. 526/g. 1132

HYRJA

Ese bibliografik

Me ditur, me qenë me guxim të ngritur dhe bujar, me menduar... Të gjitha këto janë vetitë që ai i ka ndarë me Ajn el-Kuzatin, në të njëjtën kohë janë edhe vetitë e vërteta të njerëzve të mëdhenj. Me aftësinë e madhe për të hetuar, kishte arritur të kuptojë se fati i tij do t'i ngjajë fatit të Ajn el-Kuzatit. Nuk është për t'u habitur ajo që ai fliste pa frikë kur dihet se ai posedonte aftësi të hetuarit të hershëm që ia bënte të mundur që çdo gjë të shihet para se të ndodhte. Ai e dinte se në shoqërinë e përbuzur, të shtypur, në peirudhën e paditurisë, në shkretëtirën e indiferencës (më mirë të themi që nuk e konsiderojnë apo e mohojnë të vërtetën) nuk mund të llogaritet si me qenë "guxim" nëse dihet apo shprehet interesim për diçka. Tanimë ambicja për të qenë intelektual kishte filluar t'i ngjanë vrapimit pas karrigës apo pozitës. Ky ishte shkas i mjaftueshëm që të këtillët të jenë të shtypur dhe të përbuzur. Ai intelektualët që rrinin duke mos ditur se çfarë të bëjnë, që ishin të habitur, që nuk bënin asnjë hap nga frika e shprehjes së mendimit të lirë dhe që vetëm nga frika e këtyre gjërave nuk i preknin gjërat e këqija, i kritikonte me një buzëqeshje të hidhur. Për atë nuk dontetëthotë "hap i parë" nëse bëhej një zgjedhje; tërë jeta, të gjitha ngurrimet, habitshmëritë dhe dyshimet, janë rezultat i robërisë bashkëkohore intelektuale të epokës që e quajmë intelektualizëm. Edhe pse jetën e kishte shumë të shkurtër, por shumë frytdhënëse, arriti që me tërë forcën që e posedonte me guxim të madh të luftojë kundër armikut të moçëm dhe të njohur për njerëzimin.

Ai ishte edhe fillues i rezistencës kundër atyre që në vend se ta kërkojnë dhe ta zbatojnë idealen, kënaqen me "normalen" dhe me "të pëlqyeren" ekzistuese; që jetën e njeriut e shohin si me qenë e zbrazur dhe e paqëllimtë, ai ishte edhe kundër atyre që i takonin fesë monoteiste (tehvidit) por që nuk kishin konsideratë për asgjë. Ai çdo herë iu kundërvë të keqes që dominonte në shoqërinë dhe në periudhën tonë. Rrënjët e shoqërisë sonë që ishin tharë mund të gjallëroheshin vetëm me një shehadet i cili llogaritet si një gjë e pavlefshme.

Nuk mund të duroj të heshti dhe të mos them asgjë. Do të heshti por vetëm atëherë kur do të shkëpurthi nga dhembjet e vdekjes, kur do të jem i rraskapitur nga një mijë e një vështirësitë e jetës; do të heshti atëherë kur veten do ta ndjej si një njeri të cilit nuk i ka mbetur asgjë tjetër, por vetëm pritja.

A nuk jeni duke e parë... se si dëshmori vdes në qetësi dhe në lumturi të madhe? Çdo gjë është duke shkuar në humnerë... Vdekja për njerëzit që janë mësuar kohën ta kalojnë bosh dhe mbarimi i tmerrshëm i gjithçkaje është tragjedi tepër e madhe. Si reagim ndaj kësaj, ai i cili vendosë të emigrojë, punës ia fillon me vdekje. "Vdisni para se të vdesni." Sa njerëz të mëdhenj janë ata që kur e dëgjojnë këtë urdhër të mrekullueshëm veprojnë sipas tij.

Keviri, fq. 55

Çdo njeri që e njeh mirë dr. Sheriatin, sikur që e di vlerën e të hulumtuarit, të leximit të librave të tij, të mësimin të mendimeve të tij; në të njëjtën kohë e di shumë mirë edhe atë se çfarë jete ka pasur për shkak të besimit që e ka poseduar. Këtu do të mundohemi të bëjmë një përmbledhje të shkurtë të një njeriu i cili jetën ia ka përkushtuar besimit, që

ka pasur vetëdije, që nga fillimi deri në mbarim jetën e ka pasur të mbushur plot me dashuri, përgjegjësi, punë dhe përpjekje. Për shkak të mangësive që gjenden në këtë punim tonin, kërkohet falje nga ai dhe nga gjithë miqtë.

Jeta

Me të vërtetë jeta nuk ka qenë problemi kryesor për të. Problemi i tij ka qenë se si dhe me çfarë qëllimi të jetohet në jetë. Për këtë arsye që nga fëmijëria nuk ka mbetur vetëm me të menduarit se çfarë forme apo ngjyre t'i jep jetës, por çdo herë ka qenë i ngarkuar me barrën e rëndë që e kishte mbi supet e që e kishte marrë si amanet nga stërgjyshërit. Çdo herë është munduar që amanetin e marrë ta çon në vendin e duhur. Edhe në letërën e fundit këtë e ka potencuar me fjalët se është frikuar që edhe një çast të vetëm të jetës ta kalon bosh:

Duke e përgjyruar All-llahun, kam zgjedhur një rrugë ku nuk mundem që edhe një çast të jetës sime t'ia përkushtoj lumturisë personale. Meqë ndihma e All-llahut arrinë t'i plotëson dobësitë e mija dhe meqë një ditë kjo jetë me doemos duhet të mbarojë, a mund të ekzistojë gëzim më i madh se kushtimi i jetës për këtë qëllim?

(Nga letra e fundit e Sheriatit dërguar babait të vet)

Nuk mbeti vetëm me bartjen e barrës që e kishte marrur nga stërgjyshërit e vet; tërë jetën ishte në anën e të shtypurve, të përbuzurve dhe të depresuarve. Barrë kjo që ishte e njëjtë me barrën e luftëtarëve në rrugën e All-llahut që i ngjajnë trashëgimisë së Huseinit r.a., të marrur nga Ademi a.s., e që shihet qartë si drita, apo sikurse shkuarja e Zejnepit r.a., deri në Damask pranë Jezidit.

Në shkretëtirën që është shndërruar në lum prej gjaku do të dukej pamja e dhimbjes, vetmia, dëbimi, disfata dhe pesimizmi. Nga oqeani i dëshmisë së kuqrremtë e ngriti kokën dhe qëndroi i vetmuar dhe pa zë.

(Trashëguesi i Ademit r.a., Huseini r.a., s. 16-17)

Ai besonte se Islami në të njëjtën kohë është themel i filozofisë por edhe i besimit. Ai poashtu besonte në dëshirën për të krijuar vazhdimësi mes periudhave të ndryshme, apo mes ngjarjeve dhe ndodhive që kanë ndodhur, ndodhin apo që do të ndodhin në vende të ndryshme. Të gjitha këto ndodhi mes vete lidhen në bazë të vazhdimësisë, dalin dhe zhduken nga sheshi brenda suazave të kontureve, e përcjellin dhe ndikojnë në njëritjetrin, dhe kështu duke ia filluar nga Ademi a.s., deri sa të mbarojë sistemi i kontradiktave dhe i diskutimeve e krijojnë një hallkë të vetme të zinxhirit. Kësaj vazhdimësie logjike, këtij seriali të pashmangshëm i themi histori. Historia ishte ajo barrë që nuk e nxjerrte dot nga koka e që e kishte marrë si amanet në të kaluarën e afërt që ia ndriçonte tërë jetën. Jetës ia kishte filluar në shkretëtirë; më në fund kishte arritur në një cak historik-përmbajtësor dhe shoqëror, kishte arritur që gjeneratës së re t'i jep një mesazh dhe ta tregojë "rrugën e mesme" për të cilën ka nevojë shumë të madhe në këtë kohë. Me vetëdije dhe me dëshirë e zgjodhi rrugën e predestinuar të atyre që e kishin përjetuar më parë këtë epokë njëjtë me atë. Më në fund u bë pjesëmarrës në mesin e dëshmorëve dhe të dëshmitarëve të historisë.

Mëshira e All-llahut iu takon atyre që kanë zemër të pastër

A mund të dalin rastësisht nga guri e toka margaritarë dhe koralë?

Sikurse shumë shkencëtarë dhe dijetarë të mëdhenj fetar edhe Sheriati është me origjinë fshatare dhe kjo nuk është rastësi. Madje duke mos e pëlqyer ambientin e qyteteve të mëdha të mbushura plot me shpifje dhe kacafytje, krenohet me dijetarët e asaj kohe të cilët e kishin zgjedhur vetminë e shkretëtirës Deshti Kebir:

Para tetëdhjetë e pes vjetëve, ende pa ndodhur Revolucioni Kushtetues, gjyshi im kishte mësuar teologji, filozofi dhe juridik pranë dajës së tij Allame në Behmenabad. Me Hakim Esrarin, shpeshherë kishin bërë debate filozofike. Edhe pse gjyshi kishte jetuar në një fshat të qetë dhe periferik, reputacioni i tij kishte depërtuar në qarqet intelektuale të Teheranit, Meshhedit, Isfahanit, Buharës dhe Nexhefit. Veçanërisht në Teheran ku ishte njohur si me qenë gjenij. Mu për këtë arsye Shahu Nasredin e kishte ftuar në Teheran ku kishte filluar të ligjëron lëndën e filozofisë në medresen e këtij qyteti. Mirëpo për shkak të ndjenjës së vetmisë që ia kishte kapluar shpirtin, përsëri tërhiqet në Behmenabad. Këtë e bën në moshë të pjekurisë, kur ka mundësi të merr pozitën dhe karrigën. Të gjitha këtyre gjërave me vetëdije dhe me vetëdëshirë ua kthan shpinën.

Sheriati ka përfituar shumë nga përjetimet e stërgjyshërve të vet. Posaçërisht tani “kur jetën e ka kapluar ndyrësia, kur është bërë e pamundur që njeriu të mbetet njeri, kur është bërë i patjetërsueshme xhihadi për çdo ditë, kur nuk mund të mbrohet njerëzia pa bërë xhihad”

Mësuesi Hakim ka qenë babai i babait tim. Sa tregime të bukura më tregonte lidhur me të. Burimin e shumë ndjenjave të fshehura që i kam në shpirtë, ua ndërlidhi atyre tregimeve. Pothuajse veten e shoh si me qenë me fatin e tij para pesëdhjetë apo tetëdhjetë vjetëve. Për shkak sjelljeve që i ka poseduar, ndaj tij ndjej një respekt të veçantë.

Keviri, fq. 9

Edhe xhaxhai i Sheriatit, ka qenë njëri ndër nxënësit më të mirë të shkencëtarit të njohur Edip Nishaburi. Mirëpo edhe ai, duke vepruar sipas traditës së gjyshërve, pasi që e kishte plotësuar mësimin e juridikut, filozofisë dhe të letërsisë ishte kthyer në Mezinan. Kishte arritur që nga stërgjyshërit ta mëvetëson tërë trashëgiminë njerëzore dhe shkencore. Kishte ndier se hyjnia e tyre kishte vazhduar të jetojë në të. Atë hyjni e kishte përdorur si ndriçues të rrugës së vet.

Rolin më të madh në edukimin e tij shpirtëror e ka pasur babai i tij.

Babai im nuk veproi sipas traditës. Përsërisht të ndyrësisë që dominonte në qytet ai nuk u kthye në fshat pasi që e kreu shkollimin. Ai vazhdoi të jetojë atje që të mund ta vazhdojë shkencën, dashurinë dhe xhihadin. Ja pra unë jam rezultat i këtij vendimi për të qëndruar në qytet, në të njëjtën kohë jam edhe trashëguesi i vetëm... Edhe pse nuk e meritoj, po orvatem që ta mbajë këtë amanet tepër të rëndë e të shenjtë.

Keviri, fq. 19

Edukatori i madh, muxhahidi Muhammed Taki Sheriati i cili është njëri ndër themeluesit e “Qendrës së Prezentimit të Vërtetës Islame” dyzet vjet është orvatur që me metoda logjike dhe shkencore ta bën prezentimin e të vërtetës fetare. Në rend të parë kanë zënë

vend tentativat që gjeneratat e reja të cilat janë edukuar në institucionet moderne edukative t'i largojë nga robëria materialiste, nga robëria e Perëndimit dhe t'i shpëtojë nga ndjenjat armiqësorë ndaj fesë që të munden përsëri t'i rikthehen besimit islam. "Prezentimi i mësimi islam, idea për ta marrë Kur'anin si bazë të shpjegimit dhe të hulumtimit dhe përhapja e madhe e interpretimit, në një masë të madhe janë vepër e tij." (Sheriati, Përgjigje disa pyetjeve, fq. 162)

Me qëllim prekëm në ndikimin e babait të tij; sepse çdo njëri që e njej këtë njeri të ngritur, të denjë dhe shkencëtar, do të dakordohet se këto gjëra që u thanë për babain e tij, e lehtësojnë mundësinë për t'i kuptuar dimensionet e ndryshme të jetës së tij. Përveç kësaj, ky rast paraqet edhe një shembull i mirë i cili flet se nëse një njeri me intelegjencë tejet të madhe, edukohet nga një edukator me aftësi të mëdha dhe në kushte të volitshme, do të mund t'i tejkalon të gjitha peripetitë që e pengojnë që të dilet përpara epokës. Pra ky është një shembull i cili na tregon se njeriu mund të bëhet aktiv dhe prodhues, e kurrësi pasiv dhe konsumator. Ata që e dijnë mirë jetën e babait të Ali Sheriatit dhe anët e ndryshme të jetës së tij (shkencore, fetare, politike dhe njerëzore) do të mund ta vlerësojnë devotshmërinë, durimin, mundimin dhe diturinë e tij të gjërë. Ata që e njohin i dijnë veprat e tij; "Kalifati dhe tutoria në Kur'an dhe sunnet", "Shpallja dhe mesazhet", "Aliu r.a.", "Dëshmimi i kumtimit", "Atë që e parlanjmërojnë fetë", "Meritat dhe domosdoshmëria e fesë", "Ekonomia islame" dhe veprën më të rëndësishme të tij "Komentimi i ri". Në fund do të themi se të gjithë e dijnë kundërvimi e tij heroik kundër elementeve destruktive që mbizotërojnë në universitetet dhe në qarqet fetare dhe qëndrimet e reja islame që kanë të bëjnë me epokën e shpifjes në të cilën jemi duke jetuar si dhe zgjedhjen e metodave të reja.

Në një epokë të këtillë ka shumë pak baballarë dhe fëmijë që janë kështu.

Spiritualizmin tim e formoi babai im i cili ma mësoi artin e të menduarit dhe të bërjes njeri. Menjëherë sa më ndau nëna nga qumështi, filloi të m'i mbjellë ndjenjat e lirisë, fisnikërisë, pastërtisë, qëndrueshmërisë, nderit dhe të besimit. Ai më njoftoi me shokun tim më të afër, pra me librin i cili prej ditës së parë kur ia fillova mësimi ka qenë shoku im më besnik. Jam rritur në bibliotekën e tij e cila për të ishte jetë dhe familje. Gjërat që kur t'u rritnja do të kisha mundur t'i mësoj me vështirësi të mëdha, m'i dhuroi nga vetvetiu. Biblioteka e babait tim për mua paraqet një botë me plot kujtime. Mund të më kujtohen të gjitha librat, madje edhe vëllimet e tyre. Shumë e dua atë dhomë simpatike e cila për mua është përplot lumturi, është e bukur, mirëpo shumë larg.

Përgjigje disa pyetjeve, fq. 89

Është edhe kjo, gjenialiteti dhe aftësia mund t'i tejkalon të gjitha peripetitë e ambientit dhe të del përpara epokës. Ata të cilët dëshirojnë t'i vëdojnë vulë epokës në të cilën jetojnë, nuk guxojnë të tolerojnë të bëhen robër të ambientit në të cilin jetojnë. Rregullat që janë në fuqi, për atë nuk paraqesin asgjë tjetër, përpos gurë që duhet kapërcyer. Edhe Sheriati ishte i vetëdijshëm për kallëpet tradicioanle që e kishin rrethekuar, mirëpo ai për të mos mbetur robër i tyre, ishte i vendosur që të njëjtat t'i përdorë për qëllime të veta. Dhe në këtë arriti sukses.

Që kur ishte nxënës kishte filluar të ligjëron. Aq shumë ishte zhvilluar në aspektin e të menduarit saqë menjëherë mund të vërehej se e ka tejkaluar rrethin dhe gjeneratën në të cilën gjendej.

Kur të bëhet bashkimi i aftësisë, ambientit adekuat dhe para së gjithave, kur të bëhet bashkimi i ndershëm i besimit të sinqertë ndaj burimeve islame të pashoqe, sjelljeve

dhe të menduarit, mund të thuhet se është bërë plotësimi i të gjitha kushteve të nevojshme për t'u arritur qëllimi. Ambientin që e rrethekon, kështu e shpjegon:

Në jetë kam hasur në shumë mirësi! Nuk mund të them se kam arritur t'i vlerësoj në plotkuptimin e fjalës. Askush nuk ka mundur që nga jeta të merr aq sa kam arritur të marr unë. Atë që në mënyrë të jashtëzakonshme përcaktimi (kaderi) më ka nxjerrur përpara për një kohë të shkurtë ka arritur që shpirtin kreativ të individuës sime ta zbukuron dhe ta mbushë me entuziazëm. Edhe tani mundem t'i ndjej në brendi dhe të jetoj bashkë me to.

Keviri, fq. 88 (1)

Nga njerëzit e mëdhenj të cilët ia rrëfyan rrugën, arriti t'i mësojë të menduarit, mënyrën e bërjes së xhihadit, dimensionet e ndryshme të Islamit dhe dashurinë e vërtetë; u xhuajt në botën e mendimeve dhe të konfrontimit, e mëvetësoi konfrontimin për pjekuri dhe pafundshmëri. Mirëpo të gjitha këto nuk e shkëputën asnjëherë nga ambienti i parë, asnjëherë nuk i shkëputi lidhjet me familjen e vet; asnjëherë nuk e harroi Deshti Kevirin. Çdo herë kur fillonte të tregonte diç lidhur me Mezinanin, në fytyrën e tij vërehej gëzimi.

Në fëmijëri dhe në vitet e para të rinisë, nuk dallohej shumë nga nxënësit e tjerë. Edhe ai sikurse fëmijët e tjerë shkoi në shkollë, u fut në provime, kaloi klasët, në fillim filloren, pastaj e mbaroi shkollën e mesme. Në të njëjtën kohë e mësonte arabishten dhe shkencat tjera fetare. Pasi që e mbaroi shkollën e mesme, për shkak se kishte dëshirë të flaktë të bëhet mësues, u regjistrua në Shkollën e Lartë Pedagogjike. Atë kohë Shkolla e Lartë Pedagogjike ishte një institucion i cili e bënte përgatitjen e të gjithë të rinjve për profesion të ndershëm të cilët për arsye të ndryshme nuk kishin arritur të regjistrohen në ndonjë universitet. Në të njëjtën kohë me veprat që i shkruajti mbi historinë e filozofisë, ia filloi edhe shkrimtarisë. Në anën tjetër në Qendrën e Prezentimit të Vërtetës Islame mbante konferenca të ndryshme.

Ajo që e ka orientuar Sheriatin dhe i ka dhënë formë individuës së tij, përkaj arsimimit zyrtar që e ka ndjekur brenda vendit dhe jasht, mund të thuhet se më shumë ka qenë si rezultat i besimit të sinqertë ndaj Islamit i cili për të ka qenë udhërrëfyes që nuk e ndryshon kahjen dhe i dëshirës për të menduar që e ka përfituar në fëmijëri nga ambienti ku ka jetuar. Edhe funksionimi tridhjetë vjeçar i Qendrës së Prezentimit të Vërtetës Islame e cila në Meshhed ka shërbyer si vend i lëvizjes ku janë mbledhur intelektualët musliman, ka luajtur rol të madh në formimin e individuës së tij. Si përgjigje ndaj kësaj, edhe ai duke mbajtur konferenca të ndryshme, duke u përgjigjur në pyetjet e partashtruara, duke udhëhequr seminare të ndryshme, ka luajtur rol të madh në veprimtarinë e kësaj qendreje. Që në fillim i kishte dhënë rëndësi të shkruajturit dhe të folurit me të cilat arrihet të rrënjoset zhvillimi intelektual dhe besimi i plotë. Ndërsa njerëzit që janë gjendur përreth tij, duke e vërejtur lapsin e tij të prerë dhe të fortë, çdo herë kanë insistuar në vazhdimin e mëtutjeshëm të veprimtarisë së tij. Ende pa u futur në universitet kishte arritur ta mësojë arabishten dhe frëngjishtën. I kishte mësuar aq mirë sa që mundej të përkthente libra. Me përkthimin e Ebu Zerrit nga arabishtja dhe të duave nga frëngjishtja, tregoi se sa shumë mund të përhapet horizonti i të menduarit dhe i të shikuarit. Përveç kësaj, parathëniet që i kishte shkruajtur për këto dy libra mund të shërbejnë si një udhërrëfim i mirë për kahjen dhe sqarimin e mendimit islam të asaj kohe. Sipas atij, Islami është një "rrugë e mesme" e cila në vete i ngërthen vetitë pozitive të rrymave të ndryshme filozofike, të kapitalizmit dhe socializmit (mirëpo jasht

të dy sistemeve), ndërsa vetitë negative i len jashtë kësaj rruge. Po në atë kohë ekzistonte një lëvizje idelogjike që e kishte kapluar Botën Islame duke filluar nga Afrika Veriore deri në Indonezi, lëvizje kjo e fortë, e përhapur dhe me karakter anti-imperialist. Edhe libri për Ebu Zerrin i përkthyer nga arabishtja edhe libri i vogël me mesazhe lutjesh i përkthyer nga frëngjishtja, e kishin tërhequr vëmendjen e tij kah Islami i pastër pa asnjë njollë. Komentimi i jetës së Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve selem], dhe i dijetarëve tjerë fetar në dritën e problemeve shoqërore është rezultat i këtyre punimeve. Të gjitha këto kanë ndikuar tepër shumë në mesin e të rinjve.

Në vitin 1956 në Meshhed ishte hapur Fakulteti i Letërsisë në të cilin Sheriati në njërin anë ishte regjistruar si student, kurse në anën tjetër ishte marrur me veprimtari tjera. Në këtë fakultet të ri, ai bëhet njëri ndër studentët e parë të regjistruar. Nga diskutimet që i zhvillon këtu me profesorët, arrinë që edhe më shumë ta zhvillojë aftësinë e të menduarit. Në ligjëratat çdo herë është aktiv, e jo pasiv siç bëjnë pjesa dërmuese e studentëve. Duke e shfrytëzuar këtë mundësi të të menduarit, hulumtimit dhe të diskutimit, orientohet kah historia e feve, kah historia islame e posaçërisht kah historia e filozofisë. Historinë e filozofisë të Tojbeeut e shikon me skepticizëm, andaj edhe e kritikon nga disa kënde.

Para së gjithave, vendosmëria e tij që është vërtetuar në mbrojtjen e të vërtetës dhe të drejtës dhe interesimi i tij në ndikimin e çështjeve fetare, shoqërore dhe politike në jetën e njerëzve, ka bërë që të tregohet pavarësia e tij në të menduarit dhe në besim. Në atë kohë², kur çdo gjë e patë kapluar heshtja e vdekjes, ai aspak nuk kishte qëndruar larg lëvizjes dhe konfrontimit dhe po ashtu asnjëherë nuk iu kishte larguar luftës mes të vërtetës dhe jo të vërtetës. Për shkak të fjalimeve, shkrimeve dhe aktiviteteve që i bën në atë kohë, autoritetet kishin përgatitur dosje për të. Asnjëherë nuk u orvat ta pranojë heshtjen dhe barazpeshën negative të krijuar në popull. Në të njëjtën kohë luftoi në dy beteja. Në njërin luftoi kundër tradicionalistëve të cilët si marimangë e bënë përgatitjen e pëlhurës duke u tërhequr në një skaj të xhamisë apo të medresesë. Këta ishin kundër çdo zhvillimi intelektual, prandaj të vërtetën e ndritur të Islamit e fshehnin pas një perde të zezë. Në anën tjetër fyta-fyt luftoi kundër të ashtuquajturit “skolastizëm i ri” pas të cilit fsheheshin intelektualët e pabazë dhe imitues. Të dy grupet i kishin shkëputur lidhjet me shoqërinë dhe me masën dërmuese të njerëzve dhe përsëri ata ishin që e përlunin kokën pranë çdo gjëje të prishur dhe të kalbur të asaj kohe.

Në Universitetin e Parisit

Pes vjetët që i kaloi në Universitetin e Parisit ia bënë të mundur që ta vazhdojë veprimtarinë dhe në të njëjtën kohë të njoftohet me librat që nuk mundeshin të gjinden në Iran. Në Paris iu mundësua që drejtpërsëdrejti t'i mësojë mendimet e rrymave të ndryshme filozofike edhe atë pa kurrfarë censure. Lexoi veprat e mendimtarëve dhe shkrimtarëve të ndryshëm të kalibrit të Bergsonit, Camus, Sartre, Schwarc, Barque apo të sociologovë si Gurtwitsch, Berque ose të islamologut Massignon. Interesim të veçantë shprehu ndaj hulumtimeve mbi Islamin dhe sociologjisë, të cilat i zgjodhi si sferë të hulumtimeve. Sociologjia franceze e cila ishte analitike dhe kritike i kishte lënë mbresa të mëdha. Mirëpo përsikaj ndikimit të madh që e kishte nga kjo sociologji edhe më tej vazhdoi me të njëjtin qëndrim ndaj shoqërisë, duke i pranuar “sjelljet” dhe “të menduarit” si me qenë një. Nuk i erdh i kapshëm as qëndrimi pozitivist i cili

² Vitet që kanë pasuar pas rëzimit të Musaddikut në vitin 1953

sociologjinë absolutisht e pranon si shkencë, e as qëndrimi i pashtojcë marksist. Sepse që të dy qëndrimet ishin të pamjaftueshëm në zgjidhjen dhe konceptimin e problemeve të vendeve të painedustrializuara, apo më mirë të themi “Shteteve të Botës së Tretë”. Sheriati vazhdimisht u orvat të zbulojë një sociologji e cila do të kishte mundur të gjejë zgjidhje për të vërtetën esenciale të njerëzve të cilët duke mos e marrë parasyshë ngritjen ekonomike, tentojnë ta fitojnë pavarësinë në shoqërinë kapitaliste dhe në atë komuniste.

Vitet kur Sheriati qëndroi në Francë ishin vitet më me zhurmë të Revolucionit Algjerian. Kjo periudhë paraqet një periudhë në të cilën populli musliman i shtypur afro një shekulli nga imperializmi, kishte filluar një luftë, një xhihad të ekzistimit, luftë kjo që kishte arritur të depërtojë deri në brendinë e Francës. Kurse në Evropë, partitë politike, grupacionet e ndryshme, madje edhe shkencëtarët dhe sociologët kishin marrur qëndrime pozitive apo negative ndaj kësaj çështjeje. Qëndrimi i Partisë Komuniste të Algjerisë dhe i Partisë Komuniste të Francës për të ngelur Algjeria e lidhur për Francën është tejet qëllimkeq. Sheriati për shkak se luftën anti-imperialiste për pavarësi të popullit musliman që zhvillohej në Algjeri nuk e shihte ndaras nga vetvetja, ngjarjet që ndodhnin atje i përcjellte për së afërmi dhe kaderin e tyre e shihte si të ishte i veti. Revolucioni Algjerian ishte një luftë e përgjakur e cila për nga karakteri nuk i ngjante asnjë lufte tjetër. Pa marrë parasysh se a është mik apo armik, këtë fakt nuk mund ta mohon askush. Deri në atë kohë një luftë e atillë nuk ishte parë asnjëherë. Luftë në të cilën fshatari, malësori dhe të gjithë të tjerët afro dhjetë milion algjerian bëjnë xhihad kundër oktopusit francez i cili numëronte 500 mijë ushtarë. Mbarimi i kësaj lufte; ulja në dy gjunjë e francezëve, algjerianëve iu kushton një milion dëshmorë. Përkrahja që iu është dhënë lëvizjes në Algjeri nga ana e të gjitha forcave muslimanëve pa marrë parasyshë se a kanë qenë arabe apo joarabe, ndierja e asaj lufte në shpirtë dhe llogaritja e saj si me qenë e vetja, paraqet një të vërtetë me kuptim të madh.

Është e vërtetë se si përgjigje ndaj thirrjes që e bëri Fronti Nacional Çlirimtar i Algjerisë shumë studentë musliman i ndërprejnë studiimet (në mesin e të cilëve kishte edhe studentë absolvent të Fakultetit Politeknit të Mjekësisë) për t’iu bashkangjitur luftës që e zhvillonin muxhahidët në Algjeri. Ana tjetër e kësaj lufte është thellimi në thellësinë e kësaj çështjeje ku mund të mësohen zgjedhjet filozofike, sociologjike dhe psikologjike, produkt i së cilave janë mendimet dhe teoritë e vetë luftës. Teoritë e përmendura që janë zhvilluar brenda dhe jashtë Algjerisë, janë shkruajtur në formë librash dhe artikujsh të ndryshëm të cilët janë botuar në disa gjuhë të huaja. Posaçërisht mund të përmendet gazeta “El-Muxhahid” e cila ka vepruar si me qenë zëdhënëse e Frontit Çlirimtar Algjerian duke bërë agjitacion ideologjik për luftën dhe duke marrë për sipër obligimin dhe zgjidhjen e shumë detyrave. Disa intelektualë francez iu kishin bashkangjitur kësaj lëvizjeje. Njëra nga ta është edhe Franz Fanon i cili me librat dhe esetë e botuara ia tërheqë vëmendjen opinionit. Ky psikolog i cili kalon në nënshtetësinë e Algjerisë, që në ditët e para të revolucionit iu kishte bashkangjitur rradhëve të algjerianëve. Ka shkruajtur veprat “Të mallkuarit e këtij shekulli”, “Viti i pestë i revolucionit Algjerian” dhe shumë të tjera. I pari që e njoftoi Fanonin dhe ua prezantoi evropianëve është Jean-Paul Sartre. Analiza e parë në plotëkuptimin e fjalës dhe në të njëjtën kohë që ishte e para është ajo e dr. Sheriatit e botuar në vitin 1962, në revistën e studentëve iranian që studionin në Evropë. Libri “Të mallkuarit e shekullit” për shkak të zgjidhjeve sociologjike dhe psikologjike që ia solli Revolucionit Algjerian, vlerësohet si një dhuratë e mirë për ndryshimin e sistemit në Iran. Sheriati duke i përsosur disa teori të Fanonit që deri atëherë pothuajse ishin të panjohura, arriti që me përkthimin e veprave

të tij në gjuhën persishte dhe me teoritë që i zhvilloi vet, ta reflektojë revolucionin te iranianët. Me kalimin e kohës nga shprehjet që i përdorte në fjalimet dhe dorëshkrimet, mund të vërehej ndikimi i Fanonit:

Ejani miq ta ikim nga Evropa; t'i japim fund imitimit si me qenë majmunë. Ta lëmë le të merret me vetveten Evropën e cila pa ndërpre flet për drejtësi, Evropa e cila njerëzit ku t'i gjejë mundohet t'ua thanë rrënjët.

Sheriati për shkak të dashurisë së madhe që e kishte ndaj Fanonit, përshkak se në thellësinë e shpirtit e ndiente vërtetësinë që ai e thoshte, bëri që Fanoni të jetë i njohur dhe i dashur në Iran, si përfundim i së cilës ishte përkthimi dhe analizimi i hollësishëm i disa veprave të tij nga ana e disa shkrimtarëve të njohur.

Sheriati në të njëjtën mënyrë, luajti rol të madh edhe në popularizimin e shkrimtarëve të tjerë revolucionar nga Afrika në mesin e të cilëve, përsëri muslimanëve kishte edhe jomuslimanë. Njëri ndër më të njohurit nga këta shkrimtarë ishte edhe autori i librit “Më i bukuri nga xhihadët” (Efdal el xhihad), Omer Uzgan. Sipas Sheriatit mendimet të cilat i dhanë formë lëvizjes popullore islame në Afrikë, mund të shërbenin në gjallërinë intelektuale të luftës shoqërore dhe politike të muslimanëve në Iran. Në këtë mënyrë arriti që miqëve dhe shokëve të vet vazhdimisht t'ua rikujtojë lëvizjet islame të epokës sonë.

Marrëdhëniet që i kishte me mendimtarët apo shkrimtarët me të cilët ishte njoftuar apo ua kishte lexuar veprat deri sa ishte në Evropë, nuk ishin marrëdhënie pasive (pjesa më e madhe e intelektualëve krijojnë marrëdhënie pasive). Me kusht që ta ruajë orgjinalitetin dhe krijimtarinë, këto marrëdhënie i kanë shërbyer në zhvillimin e mendimeve të reja. Hulumtimet për kuptimet e fenomeneve të ndryshme shoqërore, asnjëherë nuk i ka bazuar në supozimet “formale” dhe “zyrtare” sociologjike, por në mbikëqyrjen e shoqërisë dhe në sjelljet e momentit. Që nuk do të thotë se veprat e tij nuk mund të kritikohen. Përderisa në Paris e përgatiste tezën e doktoraturës në shkencat shoqërore, kohën nuk e kaloi sikurse shumica e studentëve tjerë që tërë kohën e kalojnë duke u mësuar dhe duke u futur në provime; ai harxhoi shumë mund që të bëhet muxhahid i vetëdijshëm dhe i zgjedhur.

Lëvizja e kishte bërë të dallohej në tre aspekte nga të tjerët, e ato janë: lufta ideologjike, lufta politike dhe lufta për zhvillimin e sistemit edukativ. Që të tre aspektet ishin në dobi të popullit, apo më mirë të themi në dobi të ummetit. Nuk dëshironte që të jetë pjesëmarrës në lëvizjet zhurmëbërëse të studentëve ku do të shkrihej pa bërë asgjë, prandaj edhe dëshironte të bëjë diçka që do të ishte e vlefshme dhe permanente... Para së gjithave e shihte se vendi i vetëm i tij i cili nuk mund të plotësohej nga askush, është në masat e gjëra.

Vitet kur Sheriati qëndronte në Paris, lëvizja fetare në Iran kishte kaluar në duart e rrymës përparimtare dhe kishte hyrë në fazë të re. Pas një periudhe të shkurtër të lirisë e cila fillon të lulëzojë, përsëri tirania dhe presioni fillon të dominojë në jetën e përditshme. Burgosjet, gjykimet, dënimet e rrepta, torturat jonjerëzore bëhen pjesë e jetës së përditshme në Iran. Tirania më së shumti manifestohej ndaj fetarëve, veçanërisht ndaj atyre që iu kishin bashkangjitur Lëvizjes Çlirimtare (Nehzati Azadi) e cila kishte një ideologji të qartë me program koherent. Kryengritja madhështore e 12 muharremit të vitit 1383 (5 qershor 1963) lëvizjes islame në Iran i dha një kahje të re,

sepse u ndanë muxhahidët e vërtetë nga ata që ishin “periodikisht”. Edhe Sheriati ishte pjesëmarrës në këtë kryengritje, madje atë e shihte si me qenë e tij. Po në këtë kohë nuk ngeci në publikimin dhe shkruarjen e librave dhe në bërjen e analizave të ndryshme mbi lëvizjen islame e cila udhëheqej nga udhëheqësi i fortë i saj, Humejini. Nga ana tjetër edhe pse lëvizja në Iran kishte karakter fetar, pjesa dërmuese e shtypit persian që shtypej jashtë kufijve të Iranit ishte me përmbajtje jofetare, mund të thuhet antifetare. Ndërsa intelektualët që jetonin jashtë vendit, nga qëllimet e këqija apo nga injoranca, bëheshin sikur nuk ishin duke e parë të vërtetën shoqërore dhe karakterin e lëvizjes.

Mirëpo, Sheriati së bashku me disa bashkëmendimtarë arriti ta botojë gazetën persiane e cila më së shumti lexohet në Evropë. Sheriati me lapsin e fortë dhe me intelgjencën e lartë, arriti që gazetën në fjalë ta shndërron në medium më serioz dhe më realist të lëvizjes. Kjo gazetë bërë që midis intelektualëve jashtë vendit dhe të lëvizjes brenda në Iran të krijojë një integrim të përsosur.

Shkurt thënë, Sheriati tërë periudhën e studimeve në Francë e kaloi duke menduar dhe duke bërë aksione të ndryshme, njëkohësisht arriti ta fillojë veprimtarinë ideologjike të iranianët që jetonin jashtë vendit. Përkaj të rëndësisë së madhe të veprimtarisë së tij, nuk do të futemi shumë në detaje lidhur me të, domethënë se jemi të detyruar të kënaqemi me kaq të dhëna për veprimet e këtij idelogu militant.

Kthimi në Iran

Pas vdekjes së Sheriatit, në gazetën gjysmëzyrtare, “Kajhan” u botua ky shkrim:

Në vitin 1964, si asnjë vit më parë Sheriati e kishte parë veten të gatshëm për t’u kthyer në vendlindje, për t’i ndihmuar popullit dhe për të dhënë kontributin për idealin Islam, prandaj i merr të dy fëmijët dhe bahkëshorten dhe vendosë të kthehet në Iran. Me vete e kishte marrë një dhuratë shumë të vlefshme. Dhuratë kjo e cila ndaj fesë kishte një qëndrim tërësisht ndryshe nga ai i mëparmi. Për të ringjallur Islamin brenda korrnizave të caktuara, nga zemra ishte i bindur dhe i vendosur ta luftojë besimin jotëvërtetë që e dëmtonte popullin dhe fenë, fanatizmin medh’hebik dhe dyfityrësinë... Pas kthimit në Iran u emërua si profesor në Universitetin e Meshhedit.

Nëse dy fjalitë e para të këtij theksi i pranojmë si të drejta, fjalia e fundit “u emërua si profesor në Universitetin e Meshhedit” aspak nuk na befason. E vërteta aspak nuk është ashtu siç mendohet se është: Pas pesë vjetëve; kur kthehet në Iran, duke qenë ende në kufi, arrestohet pranë bashkëshortes dhe fëmijëve dhe dërgohet direkt në burg ku një periudhë të gjatë nuk e lejojnë të shihet me të atin. Pasi lirimit nga burgu, edhe pse me vete kishte sjellur “një dhuratë të madhe për shoqërinë iraniane” dhe kishte mbaruar doktoraturën, u detyrua të punojë me kuadron me të cilën kishte punuar para se të shkojë në Francë, gjegjësisht si mësues në Shkollën e Lartë të Bujqësisë. Ja kështu Irani e ka pritur atë. Paj edhe ashtu gjatë tërë jetës mëmëdheu për të ka qenë vetëmse burg. Mirëpo pikërisht kjo ka bërë që edhe më shumë ta nxisë në arritjen e qëllimit të përcaktuar. Pas disa viteve, edhe pse personalisht nuk bën ndonjë kërkesë për një gjë të tillë, emërohet si profesor në Universitetin e Meshhedit. Ky ka qenë një akt i cili nuk dihet se a ka qenë gabim apo aksident. Fillimi i punës në universitet i jep mundësi “dejtperdrejtë” t’ua rrëfen rrugën e vërtetë studentëve. Studentë të fakulteteve të ndryshme krenoheshin se ishin studentë të Sheriatit, kurse në ligjëratat e tij numri i studentëve ishte marramendës. Kjo gjendje ishte tepër shqetësuese për universitetin.

Prandaj edhe bashkohen forcat me horizont të ngushtë, xheloz, të këqij dhe me kompleks të vegjëlisë për ta penguar veprimin e tij të mëtutjshëm. Udhëheqësit e universitetit më nuk mundeshin ta tolerojnë ligjërimin e Sheriatit, ngase ai më shumë e preferonte mënyrën e lirë të ligjërimin, për dallim nga të tjerët të cilët ishin preferues të mënyrës tradicionale dhe që nuk dinin të bënin dallim mes lirisë dhe ditorisë. Më në fund detyrohet të jep dorëheqje.

Pas ndarjes nga Universiteti i Meshhedit i jepet rasti të fillojë një aktivitet shumë të madh. Me konferencat dhe ligjëratat e mbajtura, me analizat e shkruajtura lidhur me fenë dhe shoqërinë, te gjeneratat e reja dhe përgjithësi në shoqëri arriti të krijojë një rrymë të re. Kurse si kundërvlerë për këtë, pa dalur fare në gjyq, dënohet me pesëqind ditë burgimi në qeli, në fund të së cilit pason shijimi i internimit.

Dr. Sheriati ka qenë një mumin i cili në kuptim të potë ka besuar fjalën tevid dhe poashtu në të njëjtën kohë ka qenë një intelektual i cili aspak nuk ka tentuar t'iu ikë probleme me të cilat është ballafaquar shoqëria. Ai bashkë me disa shokë tjerë, argumanetuan se ende është e mundur që gjithçka që posedohet në jetë (punën, profesionin, veprimtarinë, madje edhe familjen) të sakrifkohet për t'u zbatuar kumtimi ashtu siç duhet. Me shpresë të rrikthimit të vetëbesimit dhe të shpëtimit të gjeneratës së re e cila ka ngelur injorante dhe e humbur në errësirë, tërë jetën ia kushtoi lëvizjes dhe luftës në rrugën e All-llahut për t'ua sqaruar Islamit e vërtetë. Edhe pse çdoherë elementi i qelbur fetar i fshehur në petkun fetar çdo herë tentonte ta pengojë dhe ta sabotojë, arriti të ndikojë thellë në shoqërinë iraniane. Kështu iu mshoj një grusht të fortë imperialistëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre vendas. Veprat e tij edhe më tej do të vazhdojnë t'ua ndriçojnë rrugën gjeneratave të reja.

Veprat dhe mendimet e tij

Veprat e Sheriatit në të cilat bëjnë pjesë; konferencat, shënimet, librat, artikujt, (të gjitha këto janë shtypur me mijëra herë apo janë kopjuar) kanë më shumë rëndësi se lëvizjet dhe individualiteti i tij. Nuk mund të besohet se gjenerata e re do të mund t'iu harrojë shumë lehtë veprat ndaj të cilave shfaqti aq shumë interes. Të gjitha veprat e Sheriatit janë rezultat i besimit të përparuar, të sigurtë dhe të devotshëm. Andaj në të gjitha veprat mund të vërehen shenjat e një aftësie shumë të ngritur. Nëse i marrim dhe i analizojmë veprat e tij origjinale dhe produktive, do të shohim se ato nuk janë të thjeshta dhe të kota. Me lapsin e fortë dhe me stilin e prerë që e posedonte, arrinte t'iu bënte të kapshme për masat e gjëra edhe mendimet më të thella filozofike, temat e shkencore dhe sociologjike. Si përgjigje ndaj kësaj, disa vepra të tij, janë pak si të vështira për t'u kuptuar: Ata që janë mësuar të lexojnë gjëra të pakomplikuara, e kishin vështirë ta kuptonin stilin e tij simbolik, imitimin dhe kuptimet e thella të disa fjalëve që i përdorte. Për arsye se veprat e tij janë të mbështetura në hulumtime, kur të krahasohen me mendimet dinamike, për të gjithë ata që e kanë shprehur të bëjnë kritika të vogla, pra për ata që i ka kapluar përtacia e të menduarit dhe që një kohë të gjatë e kanë harruar parimin ... *thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë...* (En Nahl: 126), veprat e tij paraqesin një shansë e mirë e interrogacionit. Edhe pse teoria e Sheriatit kryesisht bazohet në teologjinë, ajo në të njëjtën kohë bazohet edhe në epistemologjinë e vërtetë, filozofinë, historinë dhe sociologjinë. Pra teoria e tij zhvillohet nga dialektika e përcaktuar e jetës dhe e të menduarit. Sipas Sheriatit, pa pasur mendim të drejtë nuk mund të ketë dituri të drejtë dhe pa pasur dituri të drejtë nuk mund të ketë besim. Që të tre gjërat janë të patjetërsueshme nëse dëshirohet që në

praktikë të kihet lëvizje të mrekullueshme me vetëdije dhe teori të shëndoshë. Besimet përfaqësore janë të kota, andaj për një kohë shumë të shkurtë shndërrohen në fanatizëm dhe në besim të devijuar që bëhet shkaktar i negativiteteve të ndryshme në shoqëri. Pa e arritur transformimin ideologjik, nuk mund të paramendohet asnjë transformim rrënjësor në shoqëri. Ja pra ky është ai transformim ideologjik dhe mendimtar që na nevojitet më së shumti në këtë epokë të botës së civilizuar të ndryshimit të shpejtë. Ky lloj transformimi, para se të përhapet në masat e gjëra duhet të rrënjoset thellë në jetën dhe vetëdijen e secilit individ. Vetëm nëse veprohet në këtë rrugë, mund që institucionet “e shenjta” të cilat një kohë të gjatë kanë mbetur të ngrira dhe të palëvizshme, të përfitojnë rol të rëndësishëm në lëvizjet jetike të shoqërisë, pra të bëhen element i lëvizshëm dhe i gjallë.

Për të pasur njohuri të vërteta për Islamin është e nevojshme të ketë histori të filozofisë monoteiste (muvahhid) dhe një “sociologji të shirkut” e cila do t’i sqarojë problemet e vërteta të shoqërisë. Në librin “Trashëguesi i Ademit, Huseini” Sheriati tregon se Islami nuk është ideologji që buron nga natyra e njeriut dhe që i takon një kohe dhe ambienti të caktuar, por se Islami është sikurse lumi i madh që gufon nga burimet e larta malësore e që kalon mbi të gjithë shkrepat deri sa të arrijë në det. Domethënë se Islami është kaplues i tërë historisë njerëzore që sjellë zgjidhje simbolike dhe historike. Lumi i përmendur rrjedhë pa u ndalur duke i dërguar ngandonjëherë ndonjë pejgamber dhe përcjellës të tyre në kohë të caktuar për ta shpejtuar rrjedhjen e tij. E tërë historia përbëhet nga konfrontimi mes të vërtetës dhe të jovërtetës, monoteizmit dhe politeizmit, tiranëve dhe të shtypurve dhe mes të varfërve dhe rebelave. Ky konfrontim dhe kundërvim në mënyrë simbolike na u është prezentuar në tregimin për Habilin dhe Kabilin. Klasa klerike dhe aristokrate çdoherë e kanë përbërë klasën kolonialiste e cila është orvatur t’i kundërvihet pejgamberëve. Ndërsa anën tjetër e kanë përbërë të varfërit, të shtypurit dhe ata që iu janë shmangur mëkateve. Të gjithë këta kanë qenë në anën e pejgamberëve dhe të dëshmorëve. Besimi monoteist nuk mund të paramendohet ndryshe nga kjo. Dhe mu për këtë arsye populli me besim monoteist obligohet të bëjë xhihad. Kjo luftë e përjetshme ka filluar me historinë shoqërore-njerëzore, pra qysh prej kohës së Ademit a.s., dhe këtë luftë çdoherë e kanë bërë njerëzit që kanë qenë besnik ndaj pejgamberëve. Kështu njeriu të gjitha lëvizjet shoqërore i ka bashkuar në besimin monoteist që është zhvilluar në harmoni me të.

Ana e rëndësishme e mendimeve të Sheriatit paraqet e ashtuquajtura “sociologji e shirkut” e cila bën analiza të vërteta dhe kritikike për gjendjen e shoqërisë. Ai shtresat dhe kategoritë e ndryshme të shoqërisë, posaçërisht rolin e intelektualëve; ideologjitë dhe mendimet e konfrontuara mbi sipërfaqen e tokës dhe rolet e civilizimeve dhe kulturave të ndryshme (te të gjitha mungon elementi i besimit monotesit) i mbledhë nën të vetmin titull, “sociologji të shirkut”. Sipas tij, mungesa e besimit monoteist, te njeriu bashkëkohor bën që ai të bëhet krijesë e alicionuar, ndërsa shkenca e pavetëdijshme të kalon në skolasticizëm të ri. Në një gjendje të këtillë vendin e intelektualëve të vërtetë e kanë zënë intelektualët e gënjeshtëm (Shiko: “Skolasticizmi i ri”, “Qytetërimi dhe ripërtrimi”, “Njeriu i alicionuar”, “Sociologjia e shirkut”, “Intelektuali dhe përgjegjësia”, “Ekzistencializmi dhe nihilizmi” etj.)

Nëse shikojmë nga prizmi sociologjik, do të shohim se shumë pak dijetarë iranian kanë mundur ta vlerësojnë shoqërinë islame në epokën tonë, ashtu siç e ka vlerësuar Sheriati. Nocionet abstrakte nuk kanë kurrfarë vlere për të, por vetëm të vërtetat që janë valide për shoqërinë islame të cilat janë të përbëra nga normat e të gjykuarit, dimensionet e marrëdhënieve dhe nga format e të menduarit dhe të besuarit. Sheriati e shihte se nuk

është e mjaftueshme për një zgjidhje të këtillë të problemit nëse intelektualët i mësojnë rrymat ideologjike të Evropës dhe të vërtetat shoqërore të shoqërisë. Sepse me këto njohuri të kufizuara ekzistonte një mundësi shumë e madhe për të devijuar dhe për të dhënë konkludime të gabuara. Zgjidhja e problemeve që ishin prezente, e shihte se ngadonjëherë mund të arrihet vetëm me rikthimin në filozofinë personale e cila është tejet e pasur dhe me kuptim të madh në interpretimin e nocioneve tona kulturore, fetare dhe letrare. Domethënë se çdo herë nuk duhet shikuar në veprat e përkthyer nga gjuhët e huaja. Nuk do të përfitojmë asgjë nëse e bëjmë përkthimin e nocioneve të sociologjisë perëndimore ashtu siç janë (nocionet që kanë dalur si rezultat i zgjidhjes së problemeve që kanë të bëjnë me shoqërinë e shekullit 19 të Evropës së industrializuar dhe me nocionet e gjysmës së parë të shekullit 20 që kanë të bëjnë me shoqërinë agresive dhe imperialiste). Nocionet e përmendura nuk kanë kurrfarë lidhje me jetën në shoqërinë tonë bashkëkohore. Vlerat, marrëdhëniet dhe reagimet psikike që janë në përputhshmëri me përcaktimet e shoqërisë sonë, me strukturën shpirtërore, me normat e sjelljeve tona duhet analizuar sipas normave të shoqërisë sonë. Për këtë arsye jemi të detyruar që si bazament për zgjidhje të merret sistemi i zhvilluar i marrëdhënieve të nocioneve sociologjike që janë krijuar dhe zhvilluar gjatë historisë në shoqërinë islame në Iran. Kur të shikohet nga ky kënd do të shihet se nocionet ummet, imamet, drejtësi, dëshmi, takije, imitim, durim, fsheshtësi, mëshirë, emigrim, ateizëm, shirk, monoteizëm, nëse barazohen apo krahasohen me nocionet e Evropës do të vërehet se janë shumë më kuptimplotë se sa ato.

Sheriati duke u larguar nga mendimet abstrakte, çdoherë është mbështetur në gjërat konkrete. Gjatë analizimit të shoqërisë iraniane të cilës edhe vet i ka takuar, për shkak se ka pasur qëndrime dhe mendime të mëdha islame, aspak nuk ka shfaqur konsideratë ndaj sociologjisë pozitiviste dhe marksiste; por duke aplikuar metoda të rrënjësura historike dhe fetare ka arritur që sociologjisë bashkëkohore islame t'i jep dimension tjetër. Gjatë studimit të vetisë "statike" të shoqërisë (raportet mes qarqeve fetare dhe të atyre jofetare, vlerat dhe sistemi i besimeve) apo të vetisë "dinamike" (ndryshimet që i ka pësuar ummeti islam dhe shoqëria iraniane gjatë periudhave të ndryshme) e ka përdorur metodën e analizës reale dhe të kiritikës sociologjike. Mirëpo, Sheriati asnjëherë nuk e ka pranuar idenë se në një shkencë siç është sociologjia mund të ekzistojë "neutraliteti." Sipas atij sot kur nocioni neutralitet shkencor bukur mirë e ka humbur kuptimin, kur vendin e "mbikëqyrjes" dhe të "definimit" e ka marrë "besimi" dhe "participimi", nuk mund që sociologu të mbetet vetëm si "mbikëqyrës i shoqërisë." Për këtë arsye është mirë që të gjitha veprat dhe mendimet e Sheriatit të vlerësohen nga prizmi sociologjik. Ai ka qenë themelues i sociologjisë islame së gjithanshme dhe njeri i cili mbi vete e ka marrë detyrën e inovatorit në këtë sferë.

Me rëndësi për ne është ajo se historinë, historinë e filozofisë, fenë, sheriatin dhe sociologjinë çdoherë e ka analizuar nga këndi i qëndrimit monoteist. Kështu është arritur që monoteizmi të jetë baza e historisë së filozofisë që e ndriçon historinë e njerëzimit dhe bazë e qëndrimit mendimtar dhe ideologjik që e ndriçon arrdhmërinë e asaj historie.

Pra nëse është kështu, të gjitha analizat e tij filozofike, historike dhe sociologjike, ashtu siç edhe tregojnë vet, mund të bashkohen në besimin monoteist:

Tani më mund të thuhet se monoteizmi (tevhidi) i ka tejkaluar qarqet filozofike, teologjike, shkencore dhe komentuese, pra ai më është duke prekur në tokë; që dotëthotë se ka filluar të merret me funksionimin e shoqërisë. Monoteizmi është duke parashtruar

shumë pyetje që kanë të bëjnë me raportet mes klasave, gjendjen e individit, raportet individ-shoqëri, anët e ndryshme të shoqërisë, shtresën e lartë të shoqërisë, institucionet shoqërore, familjen, politikën, kulturën, ekonominë, pronën, moralin shoqëror, përgjegjësitë e shoqërisë dhe të individit dhe për shumë gjëra tjera që janë të ndërlidhura me marrëdhëniet shoqërore. Kështu monoteizmi arrinë të siguron themelet ideore që kanë të bëjnë me çështjet e shoqërisë. Mund të thuhet se ky aspekt i monoteizmit i krijon themelet e nevojshme ideologjike dhe mendimore mbi besimin monoteist që nevojitet për një shoqëri me pasuri, ekonomik, besim dhe ide jokontradiktore. Domethënë se çështjet e monoteizmit dhe të shirkut janë të ndërlidhura me me filozofinë sociologjike universale, me konstruktin moral të shoqërisë dhe me rendin ligjor dhe tradicional të shoqërisë.

Ky qëndrimi i ri që mendimin monoteist e vëndon në rrafshin shoqëror dhe që kuptimin për shoqërinë e lidhë për nocionin monoteist, dëshiron ta bëjë ringjalljen për një shkallë para konfliktit dhe kontradiktës. Sociologjia e Sheriatit është reflektim i qëndrimit botëror... qëndrim i cili jep rezultate të kapshme, konkrete brenda shoqërisë... Ai arrinë të shohë se në jetën shoqërore ekziston një luftë mes monoteizmit shoqëror dhe shirkut gjatë tërë historisë:

Qëndrimi monoteist është i njëjtë si për krijimin e botës ashtu edhe për komentin mbi shoqërinë njerëzore. Monoteizmi në rrafshin universal të krijesave ashtu siç është kundër forcave të ndryshme dhe të konfrontuara, kundër idhujve të adhuruesve të tyre dhe kundër krijesave të paramenduara mbinatyrore që mendohet se ndikojnë në përcaktimin dhe në ngjarjet natyrore; është edhe kundër shirkut i cili në shoqëritë njerëzore e bën të mundur që njeriut t'i hypet mbi shpinë, të uzurpohet forca e tij dhe të bëhet përcaktimi i marrëdhënieve brenda shoqërisë mes klasave nga idhujt e ndryshëm.

Sipas Sheriatit vetëm njerëzit e “vetëdijshëm dhe të zgjuar” kanë vlerë në Islam. Moton e Sheriatit “Jeta është xhihad dhe besim” duhet kuptuar brenda kufijve të kësaj që u tha. Ky është mesazhi urgjent i tij i cili duhet përcjellur muslimanëve të vetëdijshëm të epokës sonë, sidomos rinisë të sinqertë dhe intelektuale. “Nëse rinia një herë beson, ajo lidhet në tërësi për atë që beson dhe për një kohë shumë të shkurtër bëhet element me ndikim të madh në arrijtjen e qëllimeve të Islamit.”

Askush nuk mund ta mohon kontributin e Sheriatit në këtë sferë.

Bibliografia

I ndjeri Sheriati ka qenë një shkrimtar dhe intelektual i vyeshëm që ka bërë përpjekje të mëdha që mesazhi i tij të arrijë në vendin e duhur. Çdoherë kishte ndonjë fjalë të re për të thënë apo për të shkruajtur. Dhe kjo është arsyeja që nuk mundemi këtu t'i numërojmë të gjitha veprat dhe mendimet e tij. E vetmja mënyrë që të kuptohet ai, mund të arrihet vetëm nëse drejtpërdrejtë lexohen veprat e tij të shkruajtur në një jetë shumë të shkurtër, por shumë dinamike. Konferencat, diskutimet, hulumtimet sociologjike dhe historike, publikimet e ndryshme janë afro një qind. Shumica e veprave të tij janë shtypur me mijëra herë brenda vendit dhe të përkthyer jashtë vendit. Nëse bëhet përmbledhja e të gjitha veprave të tij, do ta kishin përbërë një lloj “Enciklopedie Islame.” Nëse i marrim dhe i shikojmë titujt e veprave dhe të konferencave të mabjtur do të vërejmë se të gjitha shtjellojnë tema të ndryshme. Udhërrëfyes i tij çdo herë ka

qenë Kur'ani dhe Islami pa asnjë shtojcë i muslimanëve të parë. Edhe pse ka shkruajtur shumë vepra, rrallë mund të ndodhë e njëjta temë të jetë e përsëritur dy herë. Ky është shkaku që nëse dëshirohet të konceptohet mendimi i tij, në tërësi duhet hulumtuar të gjitha veprat e tij. Jetën e shkurtër arriti ta mbushë me besim të sinqertë i cili ia mundësoi të krijojë një rrymë të re në mesin e të rinjve të qarqeve tradicionale dhe të atyre universitare.

All-llahu e mëshiroftë.

Gulam Abbas Tavassuli
Rektor i Universitetit të Isfahanit

QËNDRIMET

Para se të futemi në temën kryesore, është mirë nëse i përkujtojmë disa pika kryesore të cilat edhe pse nuk janë të ndërlidhura drejtpërdrejtë me temën tonë, kanë tepër rëndësi të madhe. Kur të kihet parasysh fakti se pikat që do të përmenden kanë të bëjnë me çështje të jetës, marrja e tyre parasysh bëhet obligative.

Viteve të fundit, shumica e intelektualëve kanë filluar të mendojnë se nuk ka kurrfarë dobie nga përmendja e halleve dhe nga diskutimi. Deri më tani pa bërë asgjë, pa ndërmarrë asnjë aksion, vazhdimisht kemi folur dhe diskutuar për hallet dhe brengat tona. Për këtë arsye duhet ta lëmë më të folurit. Gjithsecili duhet t'ia fillojë punën për të përmirësuar familjen, ambientin dhe vendin ku jeton.

Qëndrimi im është se këto mendime bazohen në supozime të gabuara. Sepse me të vërtetë deri më tani nuk kemi folur shumë, nuk kemi diskutuar për hallet tona dhe asnjëherë nuk i kemi shikuar nga aspekti shkencor. E tërë ajo që e kemi bërë deri më tani nuk ka qenë asgjë tjetër përpos ankimi dhe rënkim dhe qartë dihej se askush nuk do të ketë dobi nga një gjë e tillë.

Problemet sociale dhe psikologjike nuk i kemi diskutuar deri më tani ashtu si duhet. Ngandongjëhere duke menduar se e kemi bërë diagnostifikimin e sëmundjes, fillojmë me mjekimin e saj, mirëpo duhet ditur se në atë çast gabojmë sepse mendojmë se kemi bërë diagnostifikim të saktë të sëmundjes.

Pasi që të fillohet me punë, do të vërehet se sa pak deri më tani kemi folur për vështirësitë me të cilat ballafaqohet njeriu, për devijimet dhe për fatkeqësitë që i përjeton ai, për problemet e tij, për prishjet e përjetuara dhe për atë se sa jemi joserioz në zgjidhjen e të njëjtëve.

Deri më tani përveç se nuk i kemi diskutuar besimin dhe qëndrimet tona, nuk kemi diskutuar fare edhe për ndonjë temë tjetër.

Si mund të themi se e kemi diagnostifikuar sëmundjen dhe se mund t'ia fillojmë aksionit? Ne jemi popull fetar?.. Prandaj edhe veprat tona duhet bazuar në parimet fetare...Mirëpo fenë tonë ende nuk e njohim. Profesionimi është mësues... Kur më pyesin studentët se a mundem t'iu propozoj ndonjë libër për temën e caktuar; nuk mundem t'iu kthej përgjigje, ngase lidhur me ato tema nuk ekziston asnjë libër i shkruajtur persisht. Kjo është një gjendje e marrshme.

Popujt musliman disa shekuj me rradhë lavdërohen se janë pasues të librit të drejtë (Ehl-i Bejt). Nga shekulli i parë kur Irani iu shmang "fesë" së vjetër dhe për një peirudhë shumë të shkurtë kaloi në Islam, e deri në ditët e sotme, edhe zyrtarish por edhe me ndjenja dhe besim, çdo herë është biseduar për katër kalifët të cilët çdo herë janë marrur si udhërrëfyes. Mirëpo, nëse një student për shkak të simpatisë së madhe që e posedon ndaj Aliut r.a., apo ndaj ndonjë kalifi tjetër, ngritet dhe nga unë kërkon ndonjë libër në të cilin shtjellohet shekulli i parë, raportet e kalifëve dhe pasuesve të tyre, nuk mund të gjej asnjë përgjigje për t'i dhënë.

... Këtyre njerëzve ua di vetëm emrat. Turp është për një popull i cili i përket fesë së Aliut r.a., të mos ketë asnjë libër që i është dedikuar Aliut r.a., dhe shokëve të tij. Është turp i madh që pas katërmëdhjetë shekujve një kristian (Georges Jourdag) të na i prezentojë Aliun r.a., poashtu është turp që Ebu Zerrin të na i prezentojë një vëlla i yni sunni (Xhevdet Es-Seher).

Selman Farisiu është muslimani i parë iranian që u nderua me Islam. Ai është burim mburrjeje për kombin tonë dhe për muslimanët tonë. Pas fillimit të kumtimit të Islamit, Selman Farisiu bëhet ndër të parët që e pranoi Islamin. Ai ishte një gjenij, një pasues i librit të drejtë. Edhe pse për muslimanët është burim mburrjeje si nga aspekti shkencor njëashtu edhe nga aspekti fetar, deri më sot është shkruajtur vetëm një libër për të, edhe atë prej një francezi.³ Ndërsa në persisht nuk janë shkruajtur edhe katër faqe për të.

Nuk e di se si mund të themi se ka mbaruar faza e analizimit dhe e diskutimit dhe se ka ardhur koha e kalimit në aksion! Nuk dua të them se tani nuk është koha e veprimit dhe e aksionit. Sepse të folurit dhe veprimi; analizimi dhe aplikimi çdo herë shkojnë së bashku. Sunneti i Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve selem], është ky: Ai jetën e kishte ndarë në dy pjesë (në njëren pjesë vetëm fliste, kurse në pjesën tjetër kalonte në aksion): “Mjaft kemi folur, ejani të kalojmë në aksion” është një fjali tejet e marrë. Të vetmën gjë që e kemi bërë deri më tani është ankimi dhe rënkimi. Dhe besoj se ka ardhur koha ta braktisim më atë gjë, prandaj duhet të fillojmë të flasim për hallet. Mirëpo kur të flasim, të flasim nga këndi shkencor. Mendimi në të cilin besojmë le të jetë bazamenti i veprës sonë, aksionit tonë dhe i mendimit tonë. Të mësojmë se çfarë njeriu ka qenë Aliu r.a.,... T’i njohim ata që në mënyrë perfekte na i prezentojmë Pejgamberin [sal-lall-llahu alejhi ve selem], Ebu Zerrin, Selmanin dhe Aliun r.a.

Nëse i lëmë anash librat me karakter fetar dhe fillojmë ta vështrojmë situatën nga këndi njerëzor, do të vërejmë se nuk ka asnjë libër të shkruajtur në persisht që ka të bëjë me njerëzit e që ka vlerë të lexohet. Gjashtë librat e botuara kohëve të fundit, janë libra të përkthyer, e ne ende nuk e kemi marrë lapsin në dorë dhe të fillojmë të shkruajmë.

Në këtë vend njerëzit që e njohin mirë Kur’anin nuk i quajnë “dijetarë” por “të virtytshëm”. Ata që e njohin Kur’anin, historinë islame, jetën e Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve selem], dhe të shokëve të tij; ata që kanë aftësi në këtë lëmi; domethënë dijetarët, janë para të virtytshmëve, pra nuk janë dijetarë të rangut të dytë. Sepse sikur të ishte ashtu Pejgamberin [sal-lall-llahu alejhi ve selem], Aliun r.a., dhe Ebu Zerrin nuk do të kishim mundur t’i pranojmë si dijetarë por si të virtytshëm. Ja pra mu për këtë arsye detyra ynë më e madhe është të flasim me gjuhë të prerë dhe shkencore, pa qarë për hallet tona dhe pa rënkuar fare. Ngase qoftë në vendin tonë apo në ndonjë skaj tjetër të Botës Islame, ata që fillojmë me shpresë të bëjnë diçka, ose nuk mund të arrijnë asgjë, ose arrijnë të bëjnë shumë pak. Shkaku i një gjëje të tillë është mospasja e vizionit se çfarë duhet bërë kur të fillohet me punë. Pa dyshim se nëse fillojmë një punë pa e ditur paraprakisht se çfarë dëshirojmë, do të habitemi shumë. Duke i ditur këto, nënkuptojmë se detyra ynë kryesore është mësimi i fesë sonë. Po pra, kështu është, sepse edhe pse kanë kaluar disa shekuj nga pranimi i Islamit si fe tonën, mësimi i Islamit ende është një punë për të cilën duhet përvjeshur mangat.

Siç kam thënë edhe më herët, ekzistojnë shumë mënyra për ta mësuar Islamin. Njëra ndër ato është njohja e All-llahut dhe krahasimi i tij me idolet e feve tjera. Tjetra është njohja e Kur’anit dhe krahasimi i tij me librat e tjera të shenjta (që u thonë “të shenjta”). Mënyra tjetër është njohja e personalitetit të Pejgamberit dhe krahasimi i tij me reformistët që i kemi hasur në historinë njerëzore. Dhe mënyra e fundit është njohja e gjeneratës së të parëve të Islamit dhe krahasimi i tyre me gjeneratat e para të feve tjera. Obligimi i intelektualëve të periudhës sonë është t’ua ngilitin në kokë njerëzve mendimin se Islami i jep gjallëri njeriut dhe shoqërisë dhe se edhe në të ardhmen do të jetë udhërrëfytes. Intelektuali i sotëm duke e pranuar këtë obligim si obligim personal

³ Louis Massignon, Salman Pak et les premisses Spirituelles de l’Islam iranian, Paris, 1934

dhe individual, pa marrë parasysh fushën e veprimit të tij, është i detyruar që fenë islame dhe personalitetet e para të tij, t'i vështrojë nga një kënd i ri (nga këndi i veprimit të tij). Ngase ekzistojnë aq shumë dimensione dhe drejtime të ndryshme, saqë gjithsecili në fushën e veprimit të tij mund të gjejë kënd të ri për të vështuar.

Për shkak se fusha ime e veprimit është sociologjia fetare, duke e përdorur terminologjinë e literaturës islame dhe të Kur'anit jamë munduar të zhvilloj një sociologji fetare e cila do të mbështetet në Islam. Gjatë punimeve dhe hulumtimeve që i kam bërë deri më tani kam vërejtur se ekzistojnë disa tema për ekzistimin e të cilave as që jemi të informuar. Gjatë analizimit të Islamit dhe të Kur'anit një nga faktet në të cilin kam hasur, ka qenë ekzistimi i historisë shkencore dhe i teorisë sociologjike në përputhje me sunnetin e Pejgamberit. Mirëpo kur e them këtë nuk mendoj të merren Kur'ani, apo disa ajete të Kur'anit ose sunneti i Pejgamberit dhe stili i jetës së tij politike, shoqërore, psikologjike apo morale dhe të zgjidhën me shkencat bashkëkohore. Atë që e përmenda lart është krejtësisht diçka tjetër, ngase në Kur'an kam hasur në disa tema që kanë të bëjnë me historinë sociologjike dhe me shkencat shoqërore. Domethënë se burimi i të menduarit tim janë Kur'ani dhe Islami.

Duke u bazuar në Kur'anin, kam arritur të zbuloj gjëra që kanë rëndësi të madhe në shkencat shoqërore, por ato asnjëherë nuk kanë qenë temë hulumtimi nga të njëjtat. Njëra ndër ato tema është edhe Hixhri (emigrimi). Në librin "Pejgamberi i fundit: Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve selem]" është analizuar vetëm dimensionin historik i kësaj çështjeje. Kurse në Kur'an kur flitet për Hixhrin dhe për muhaxhirët (emigrantët), nga shprehjet që përdoren dhe duke u nisur nga jeta e Pejgamberit dhe në përgjithësi nga jeta islame në vitet e para dhe nga nocioni Hixhret, kam kuptuar se Hixhri nuk është vetëm se një ndodhi historike.

Një pjesë e madhe e muslimanëve kur e përdorin fjalën "Hixhret" nënkuptojnë emigrimin e disa shokëve të Pejgamberit me urdhërin e tij nga Mekka në Abisini (Etiopi) e pastaj në Medine. Një pjesë tjetër Hixhrin e shikon si emigrim i disa njerëzve për shkaqe gjeografike ose politike që kanë qenë primitiv apo gjysmë të civilizuar. Sa i përket muslimanëve ata këtë ndodhi e shikojnë si një rast që ka ndodhur gjatë jetës së Pejgamberit dhe të muslimanëve të asaj kohe. Kurse nga shprehjet që përdoren në Kur'an për shpjegimin e Hixhrit, ndjeva se Hixhri është një nocion me domethënie të thellë nga aspekti filozofik dhe ai social. Më pastaj kur shikova në historinë në të cilën është shkruajtur për këtë rast, kuptova se Hixhri aspak nuk është një ndodhi e thjeshtë siç mundohen ta përshkruajnë historianët, por se ai është një parim tejet madhështor i cili deri më sot nga askush nuk është hulumtuar. Edhe pse çdo herë në histori emigrimi ka qenë faktori kryesor i lindjes së civilizimeve të reja, as ata që merren me historinë e filozofisë nuk kanë shfaqur interesim për këtë çështje.

Të gjithë njëzet e shtatë civilizimet që i dijmë nga historia, pa asnjë përjashtim kanë lindur pas ndonjë emigrimi. Me fjalë tjera nuk ekziston asnjë shoqëri primitive e cila pa emigruar nga vendi ku jeton të ketë arritur të civilizohet.

Këtë temë që ka rëndësi të madhe nga aspekti historik dhe sociologjik, kam arritur ta nxjerri nga Islami dhe nga stili i ajeteve kur'anore ku emigrimi urdhërohet të jetë i pjesërishëm apo i tërësishëm.

Të gjithë civilizimet që i dijmë, duke ia nisur nga i fundit (Amerika) e deri te ai i pari (Sumer) kanë lindur pasi që është bërë emigrim. Çdo herë kur shoqëritë primitive të cilat nuk janë larguar nga mëmëdheu kanë ngelur primitive, që nuk vlenë për ata që kanë vepruar në të kundërtën, ngase ata çdo herë kanë arritur të civilizohen. Domethënë se të gjithë civilizimet kanë lindur nga emigrimi i shoqërive primitive.

Në këtë drejtim kam arritur të kuptoj shumë tema dhe fusha të veprimit. Gjithashtu kam kuptuar se Islami dhe Kur'ani më kanë ndihmuar që më mirë, më ndryshe dhe më qartë t'i kuptoj çështjet që kanë të bëjnë me historinë dhe me sociologjinë. Duke i përdorur disa idiome të Kur'anit arrita të kuptoj se mund të gjinden shumë tema të reja të cilat nuk mund të gjinden as në shkencat shoqërore.

Temën që tani dëshiroj ta debatoj sipas sociologjisë islame është një temë e cila deri më tani nuk ka mundur të zgjidhet sipas sociologjisë dhe historisë, e ajo është: Cili është faktori kryesor në ngritjen dhe ndryshimin e një shoqërie? Dhe cili është faktori kryesor i ndryshimit dhe ngritjes së papritur të një shoqërie apo i fillimit të papritur të shkatërrimit dhe prishjes, ose i ndryshimit i të gjitha vlerave shoqërore, shpirtit, qëllimit dhe i formës së marrëdhënieve individuale dhe shoqërore?

Me shekuj me rradhë është duke u kërkuar përgjigje për këtë pyetje, e sidomos në një qind e dhjetë vjetët e fundit kur të gjitha rrymat sociologjike dhe historike me tërë forcën poseduse janë muduar t'i gjejnë përgjigje kësaj çështjeje e cila çdo herë përpara iu ka dalur në formë pyetjeje se cili ishte faktori kryesor i ndryshimit dhe i zhvillimit dhe se cila ishte ajo energji e motorit historik?

Pika ku janë ndarë të gjitha rrymat sociologjike duke i dhënë rëndësi një faktori të përcaktuar është kjo.

Disa rryma nuk i besojnë historisë dhe thonë se ajo nuk është asgjë tjetër përpos një grumbullim i tregimeve për të kaluarën që nuk kanë aspak vlerë. Gjithashtu këto rryma nuk pranojnë se mund të ekzistojnë rregulla, parime dhe vlera të pandryshueshme të sociologjisë.

Ekziston një anarki shkencore në botë e cila është tejet pesimiste në sferën e filozofisë sociologjike dhe të asaj të shkencave shoqërore. Sipas asaj (anarkisë shkencore) faktori kryesor që i jep kahje historisë është rastësia; sipas së cilës ndryshimet në jetën e popujve, regresionet dhe revolucionet janë rezultat i rastësive. Për shembull, arabët përnjëherë i sulmuan iranianët të cilët rastësisht pësojnë disfatë, e më pastaj e pranojnë Islamit. Në një periudhë kur udhëheqësia iraniane është tejet e dobët, Xhengiz Hani e sulmon Iranin dhe Irani pëson disfatë. Mongolët futen në Iran bashkë me to edhe kultura dhe stili i jetës mongoliane e cila kombinohet me atë islame dhe krijohet një ndryshim i caktuar. Poashtu edhe Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore rastësisht ndodhin, domethënë se kanë mundur edhe të mos ndodhin. Shkurt thënë, e tërë kjo rrjedhë historike që ka ndodhur është vetëm se rastësi.

Grupi tjetër është i përbërë nga materialistët dhe nga ata që besojnë në determinizmin historik. Sipas këtyre historia dhe shoqëria që nga fillimi janë zhvilluar sikurse me qenë dy lisa që zhvillohen pa kurrfarë determinizmi. Lisi në fillim është farë. Pastaj lëshon filizë, del mbi sipërfaqen e tokës, lëshon rrënjët në tokë, rritet, degëzohet, bëhet lis i madh, jep fryte, dimrit i biejnë gjethet, në pranverë përsëri lulëzon, piqet dhe në fund vdes. Të gjitha këto ndodhin deshi apo nuk deshi lisi. Ky grup mendon se shoqëria gjatë historisë iu përshtatet ligjeve natyrore dhe vepron sipas atyre, domethënë se është e detyruar të veprojë sipas faktorëve dhe ligjeve të caktuara që ekzistojnë në shoqërinë njerëzore.

Sipas këtij mendimi, individët nuk mund të kenë kurrfarë ndikimi në kaderin (përcaktimin) e shoqërisë e cila është një rast i natyrshëm që zhvillohet sipas faktorëve dhe ligjeve të natyrës.

Grupi i tretë përbëhet nga adhuruesit e heronjve dhe personave të ndryshëm. Këtu mund të numërohen adhuruesit e fashistëve, nazistëve, apo siç është Carlyle, Emersoni të cilët kanë shkruajtur vepra mbi jetën e Pejgamberit, dhe intelektualët siç janë këta. Sipas

mendimit të këtyre që i takojnë këtij grupi, ligjet e sipërpërmendur nuk kanë kurrfarë force për të ndryshuar diçka në shoqëri dhe se shoqëria nuk është asgjë tjetër përpos një vegje në duart e personave të fortë. Po ashtu edhe njerëzit mesatar apo ata që janë një gradë më poshtë se mesatarët nuk mund të bëjnë kurrfarë ndryshimi në shoqëri, sepse edhe ata një të tjerët janë vetëm se vegël e personave të fortë. Faktori kryesor në përmirësimin, ngritjen dhe në shkatërrimin e shoqërisë është personi i fortë.

Emersoni thotë: “M’i tregoni dhjetë emrat e personave më të fortë të historisë, sy mbyllur do t’ua tregoj historinë e tërë njerëzimit. Ma shpjegoni Pejgamberin e Islamit, t’ua tregoj tërë historinë islame; ma shpjegoni Napoleonin që t’ua nxjerr përpara tërë historinë e Evropës moderne.”

Sipas qëndrimit të këtij grupi, ardhmëria e shoqërisë dhe e njerëzisë është në duart e parisë së shoqërisë, respektivisht në duart e personave “të fortë”. Që dontëthotë se lumturia e shoqërisë nuk varet as nga kushtet e shoqërisë e as nga rastësia, por nga personat e fortë që kohë pas kohe dalin dhe veprojnë në mënyrë që ardhmëria e tërë shoqërisë, madje edhe e tërë njerëzimit të pësojë ndryshime. Me fjalë tjera, personat “e fortë” janë ata që vendosin se a do të ketë lumturi apo dëshpërim.

Në veprën e Caryle në të cilën bëhet fjalë për jetën e Pejgamberit të Islamit kështu thuhet: “Pejgamberi i Islamit, në fillim kur ua bëri kumtimin e parë të afërmëve të vet, askush nuk e pranoi një gjë të tillë, me përjashtim të Aliut i cili iu përgjigj thirrjes së tij dhe e nderoi Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve selem], mirëpo atë kohë Aliu ishte një fëmi dhjetë vjeç”. Caryle këtë çështje sipas mendimit të vet kështu e përfundon: “Kjo dorë e vogël e kapi dorën e madhe dhe ndryshoi rrjedha historike.”

Ekzistojnë rryma të cilat thonë se shumica e shoqërisë mund ta përcaktojë ardhmërinë e shoqërisë, gjegjësisht të popullit. Mirëpo as demokracia antike, as ajo bashkëkohore e as ndonjë rrymë tjetër nuk pranon se masat mund të jenë faktori kryesor në ndryshimin dhe zhvillimin e shoqërisë. Rrymat me mendime demokratike thonë se udhëheqja më e mirë është ajo në të cilën merr pjesë vetë populli; mirëpo duke ia filluar nga demokracia e Athinës e deri te ajo e ditës së sotme, asnjëherë këto rryma nuk kanë pranuar se masat popullore kanë arritur të jenë përcaktuese të ndryshimeve dhe të zhvillimeve shoqërore. Madje edhe sociologët më demokrat të cilët thonë se shteti më i mirë është ai në të cilin i jipet e drejta popullit që nëpërmjet zgjedhjeve të jetë pjesëmarrës në udhëheqjen e shtetit, nuk pranojnë se “populli” është faktori kryesor në ndryshimin dhe zhvillimin e shoqërisë. Edhe ata si faktor përcaktues e shohin determinizmin, njerëzit e mëdhenj, të zgjedhurit, rastësinë apo vullnetin e shenjtë.

Përkulësit e njerëzve ndahen në dy grupe:

Grupin e parë e përbëjnë ata që mendojnë se njerëzit e mëdhenj sikurse Buda, Musa apo Isa e kanë ndryshuar shoqërinë njerëzore. Këta janë “përkulës të heronjve” të pacenushëm.

Grupin e dytë e përbëjnë ata të cilët mendojnë se në fillim është paraqitur një njeri i madh, e pastaj njerëzit e zgjedhur të shoqërisë iu kanë përgjigjur thirrjes së tij dhe kështu është krijuar “ekip” i cili ka qenë udhërrëfyes i shoqërisë dhe që sipas mendimit të tij ka bërë përcaktimin i një qëllimi. Mendoj se nuk gabohet nëse ky grup quhet “përkulës të të zgjedhurve”.

Teoritë e sipërpërmendura nuk mund të gjinden as në Islam e as në Kur'an. Sipas Islamit njeriu më i madh është Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem]. Sikur Islami rolin e Pejgamberit ta kishte parë si faktor kryesor të ndryshimit dhe të zhvillimit të shoqërisë, të gjithë pejgamberët tjerë dhe Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve selem], do të ishin faktorë kryesorë të ndryshimeve të përmendura. Por shohim se gjendja aspak nuk është

ashtu. Në Kur'an shumë qartë mund të shihet detyra dhe personaliteti i Pejgamberit. Ai është përgjegjës për përcjelljen e lajmit, është tërheqës i vërejtjes, është sihariqtar. Kur Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem], mërzhitet për gjendjen e njerëzve All-llahu ia përkujton se detyra e tij është përcjellja e lajmit, frikësimi i njerëzve, dërgimi i sihariqit dhe tregimi i rrugës së vërtetë; ndërsa përgjegjësinë për devijimet e mbajnë vetë njerëzit e jo Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem].

Në Kur'an nuk pranohet se shkak themelor i ndryshimeve dhe i zhvillimit aktiv në historinë njerëzore ka qenë “Pejgamberi”, por se ai ka qenë i obliguar për të përcjellur lajmin dhe t’ua tregojë rrugën e vërtetë njerëzve. Detyra e tij këtu mbaron, kurse njerëzit janë të lirë në zgjedhjen e të drejtës dhe të shtrembëtës.

Në Islam nuk ka vend për “rastësinë” sepse gjithçka është e ndërlidhur me vullnetin e All-llahut. Për këtë arsye as në natyrë e as në shoqëri nuk mund të paramendohet së paku një ndodhi e vetme e cila mund t’i ndërlidhet “rastësisë”. Në Kur'an përmendja e emrave të disa njerëzve që nuk kanë qenë pejgamberë, në shumicën e rasteve është bërë për shkak të mallkimit dhe të pakënaqësisë që ka ekzistuar ndaj tyre. Dhe po ashtu përmendja e emrave të disa njerëzve të cilët kanë qenë të drejtë dhe të devotshëm, asnjëherë nuk është thënë se ata me të vërtetë kanë qenë ndikues në shoqërinë në të cilën kanë jetuar. Nga kjo mund të kuptojmë, pra nga Kur'ani, se Islami nuk pranon rastësinë dhe se njerëzit janë faktori kryesor i ndryshimit dhe i zhvillimit të ligjeve të shoqërisë.

Sipas këtij qëndrimi, grupi njerëzor të cilit i drejtohet ndonjë rrymë ideologjike, fe apo ndonjë pejgamber është faktori kryesor i ndryshimit shoqëror. Për këtë arsye en-nasi (populli) është ai të cilit iu drejtohet në Kur'an. Pejgamberi iu është dërguar en nasit (popullit) të cilit edhe i drejtohet dhe i cili do të merret në përgjegjësi për veprat që do t’i bën. Shkurt thënë, e tërë përgjegjësia për atë që ndodhë në shoqëri dhe në histori, është në qafë të en-nasit (popullit). Për arsye se fjala “en-nas” ka shumë kuptime, është edhe shumë e përdorur. Kurse përkthimi më i përshtatshëm i kësaj fjale, mund të bëhet vetëm nëse përdoret fjala “masë” e cila kur përdoret në sociologji nuk bën kurrfarë dallimi klasor apo ndonjë ndasi tjetër mes njerëzve. Për këtë arsye nëse përdoret fjala “masë”, nënkuptohet populli pa asnjë ndasi klasore apo grade shoqërore. Pra kuptimi i plotë i fjalës en-nas është “masa popullore” dhe nuk ka ndonjë kuptim tjetër përpos këtij. Fjala “njeri” dhe “racë e njeriut” janë fjalë që iu përkasin bijve të Ademit a.s. Mirëpo e para rëndësi iu kushton vetive morale, kurse tjetra vetive shtazore të njeriut.

Nga kjo mund ta nxjerrim këtë përfundim: Islami është rryma e parë shoqërore e të menduarit e cila thotë se masa është përcaktuesi i vetëdijshëm themelor i historisë dhe i shoqërisë. Domethënë se nuk është ashtu siç mendon Nietzsche i cili thotë se për një gjë të tillë janë të zgjedhurit, apo siç thotë Platoni se është aristokracia, ose siç besojnë Emersoni dhe Calyle se janë njerëzit e mëdhenj, priftërinjtë dhe intelektualët.

Vlerën e vërtetë të mësimin islam mund ta kuptojmë tërësisht vetëm nëse e bëjmë krahasimin e tij me rrymat tjera ideologjike.

Kujt i drejtohen rrymat e ndryshme ideologjike? Disa prej tyre iu drejtohen klasës intelektuale, disa një grupit të zgjedhur të shoqërisë, disa racës së lartë, disa njerëzve të lartë, disa proletariatit dhe disa klasës shoqërore siç është borgjezia.

Islami nuk e pranon asnjë nga këto privilegjione apo epërsi. Nga kjo mund të kuptojmë se përcaktuesi themelor i ndryshimeve dhe i zhvillimeve shoqërore, pa asnjë privilegjion apo epërsi të mbështetur në ndonjë klasë apo racë, është populli.

Kur iu drejtohet njerëzve drejtpërdrejtë në Kur'an, shihet se këta njerëz janë boshti dhe përcaktuesi kryesor i ndryshimeve dhe i zhvillimeve shoqërore, ndërsa marrja e

çdonjërit një nga një në përgjegjësi para Zotit, nënkupton se njerëzit në masë të caktuar mund të ndikojnë në histori, traditë dhe në ardhmërinë e shoqërisë. Domethënë se sipas Islamit ekzistojnë katër faktorë themelor që e përcaktojnë ndryshimin dhe zhvillimin shoqëror, e ato janë: personat, tradita, rastësia dhe en-nasi (populli). Forma e traditës së nxjerrur nga Kur'anë dhe Islami mbështetet në atë se çdo shoqëri ka një themel të qëndrueshëm apo siç thuhet në Kur'an, një rrugë ose një veti të caktuar. Çdo shoqëri i ka rregullat e veta të pashmangshme. Dhe po ashtu çdo shoqëri është sikurse një krijesë e gjallë e cila si çdo organizëm i gjallë i ka disa ligje të cilët është e domosdoshme të sqarohen me metoda shkencore. Pra, nëse shikojmë nga një kënd i caktuar do të shohim se të gjitha ndryshimet dhe zhvillimet që ndodhin në shoqëri, bëhen brenda disa kontureve të pashmangshme dhe të disa traditave të pandryshshme.

Kështu Islami iu është afruar teorisë e cila e mbronë determinizmin në histori dhe në shoqëri. Mirëpo do të shohim se si Islami i zbutë rregullat rigjide të kësaj teorie. Në Islam flitet për shoqërinë njerëzore (en-nas) e cila do të merret në përgjegjësi për veprat e kryera, por edhe për marrjen e njerëzve një nga një në përgjegjësi. Këto ajete kur'anore flasin për përgjegjësinë shoqërore: “... *atij i takoi ajo që fitoi, e juve u takon ajo që fituat,...*” (El Bekare: 134) dhe “... *All-llahu nuk e prish gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat) përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre...*” (Er Rra'd: 11). Nga ky ajet kur'anor “*Secili njeri është pengë i veprës së vet.*” (El Muddeththir: 38) qartë vihen në pah përgjegjësia e e secilit për vetveten. Për këtë arsye edhe shoqëria edhe individit do të merren në përgjegjësi përpara Krijuesit ku do të japin llogari për veprat e kryera, pra secili me duart e veta e përgatitë terrenin e vet.

Këto dy parime janë kontradiktore në sociologji: Në njërin anë është përgjegjësia e individit në ndryshimin dhe zhvillimin e shoqërisë, në anën tjetër idea për ligjet shkencore të pavarura nga njeriu të cilat e përcaktojnë, dhe e drejtojnë kahjen e shoqërisë... Mirëpo në Kur'an këto dy pole (ekzistimi i ligjeve të pashmangshme dhe të qëndrueshëm në shoqëri / përgjegjësia e individit në ndryshimin dhe zhvillimin e shoqërisë) lëre që nuk janë kontradiktore mes vete, ata janë plotësuese të njëra tjetrës.

Edhe në natyrë mund ta shohim të njëjtën gjë. Për shembull inxhinieri i bujqësisë për të marrë fryte më të mira nga pema, e ujitë, e krasitë dhe mundohet të bëjë gjithëçka që është e nevojshme. Gjatë kryerjes së kësaj pune ai e posedon edhe mundësinë e zgjedhjes (që nënkupton përgjegjësinë). Mirëpo në anën tjetër janë ligjet e pashmangshme dhe përcaktuese të zhvillimit të pemës të cilat i dijmë nga botanika. Domethënë se përdorimi i këtyre ligjeve ekzistuese në bimët, mund të bëhet në suaza të diturisë ekzistuese për ta, sepse assesi nuk mund të bëhet ndonjë ndryshim në ligjet e botanikës apo të shtohet ndonjë ligj tjetër përpos atyre që ekzistojnë. Është domosdoshmëri për inxhinierin e bujqësisë t'i pranojë ligjet që kanë ekzistuar më parë në natyrë. Mirëpo me zbulime të reja shkencore ai mund të provojë të njëjtit t'i përdorë për qëllime të veta. Për shembull pa i tejkalluar kufijt e caktuar, mund ta shartojë një pemë të egër. Edhe përgjegjësia e njeriut brenda shoqërisë është kështu. Ngase shoqëria i ngjanë kopshtit me pemë i cili zhvillohet në përputhshmëri me vlerat dhe ligjet hyjnore. Zhvillimi dhe evoluimi mbështetet në këto ligje. Mirëpo edhe individët mbajnë përgjegjësi. Askush nuk mund të mbështet në qëndrimin kaderist (përcaktues) të Hajjemit ose në determinizmin historik, ngase shoqëria do të merret në përgjegjësi për veprat e bëra. Edhe pse në Kur'an thuhet se shoqëria mbështetet në disa ligje të pashmangshme, përsëri përgjegjësia e njeriut nuk ngelë anash. Sipas mendimit të prezentuar në Kur'an, njeriu duhet t'i mësojë mirë rregullat e shoqërisë me përdorimin e

të cilave do të mund të ndihmojë në zhvillimin e saj. Këtë mund ta arrinë vetëm nëse e përdorë dijen e vet.

Përse për sasinë e fryteve që i jep pema, më shumë se të gjithë të tjerët merret në përgjegjësi inxhinieri i bujqësisë?

Sepse ai më mirë se të gjithë të tjerët i din rregullat lidhur me pemët dhe ai është njeriu i cili mund të ndikojë në dhënien e më shumë fryteve. E njëjta gjë vlenë edhe për njeriun. Aq më shumë se t'i rrisë njohuritë lidhur me ligjet dominuese në shoqëri, aq më shumë i shtohet edhe aftësia dhe përgjegjësia për të bërë ndryshime në shoqëri. Islami duke e sjellur mendimin sociologjik shkencor, tregoi se zhvillimet dhe ndryshimet shoqërore nuk mund të bazohen në rastësi, por në atë se shoqëria është një organizëm i gjallë i cili i posedon disa rregulla të cilat mund të sqarohen me metoda shkencore. Më mirë thënë: njeriu është posedues i vullnetit të lirë me të cilin mund të ndikojë në funksionimin e shoqërisë apo të individit dhe të projektojë një ardhmëri më të mirë për të.

Kështu mund të lindë besimi se në njërën anë qëndron përgjegjësia e njeriut e në anën tjetër rregullat obligative të shoqërisë që e bëjnë atë të funksionojë si një organizëm i gjallë. Ndoshta nga aspekti sociologjik ky do të ishte kuptimi i fjalës së njohur “as kaderi e as forca... por mesi i të dyjave”⁴. Nga kjo nënkuptojmë se në njërën pjatë të peshores gjendet njeriu që korrespondon me vullnet të lirë, kurse në pjatën tjetër gjendet shoqëria që korrespondon me rrugën dhe rregullat (sunnetin); njeriu drejtpërdrejtë merret në përgjegjësi për jetën individuale dhe shoqërore. Me bashkimin e këtyre dy gjërave paraqitet “rruga e mesme”. Njeriu është i lirë në sjellje; mirëpo për ta përdorur lirinë duhet t’iu përshtatet rregullave ekzistuese në shoqëri.

Në Islam as individualiteti nuk mund të jetë nga vetvetiu faktor përcaktues. Madje as pejgamberët nuk mund të llogariten si persona të cilët në shoqëritë ekzistuese kanë krijuar rregulla të reja. Nga aspekti sociologjik, epërsia e pejgamberëve krahas liderëve tjerë lindë nga fakti se ata i kanë ditur shumë mirë rregullat hyjnore në natyrë. Dhe duke u nisur nga kjo, ata kanë arritur të jenë më të kapshëm për njerëzit. Është e vërtetë historike se pejgamberët kanë qenë më të suksesshëm se liderët tjerë jopejgamberë të shoqërive. Në veprat e liderëve të përmendur mund të haset në shumë propozime dhe parime të mira, por që asnjëherë nuk kanë arritur ta ndryshojnë shoqërinë dhe të krijojnë ndonjë civilizim të ri. Ndërsa në anën tjetër pejgamberët çdoherë kanë arritur të krijojnë shoqëri dhe civilizime të reja, e bashkë me ta edhe histori të re. Pejgamberët nuk kanë vepruar ashtu siç thonë fashistët dhe përkulësit e heronjve se kinse kanë venduar ligje që janë të kundërta nga ata hyjnorë. Por përkundrazi, ata me fuqinë e tyre pejgamberike dhe me aftësitë e mbinatyrshme kanë arritur t’i shohim rregullat hyjnore në shoqëri dhe në natyrë dhe duke e përshtatur vullnetin e vet me ato rregulla, kanë arritur ta zbatojnë urdhërin e dhënë dhe t’ia arrijnë qëllimit të përcaktuar.

Në Islam në aspektin filozofik nuk ka vend për rastësinë; ngase çdogjë vazhdimisht dhe drejtpërdrejtë është nën mbikëqyrjen e All-llahut. Madje për arsye se rastësia nuk mund të ketë ndonjë arsye logjike apo ndonjë qëllim hyjnor, nuk është e mundur të haset në shoqëri, natyrë apo në jetë. Mirëpo me një kuptim të veçantë “rastësia” ekziston në përcaktimin (kaderin) e njeriut. Për shembull, Xhengiz Hani paraqitet në Mongoli, në përputhje me rregullat e shoqërisë arrinë në pushtet dhe përreth vetes mbledh një fuqi të madhe. Mirëpo pësimi i disfatës së iranianëve nga Xhengiz Hani paraqet rastësi. Ishte e mundur që të mos e humbin luftën iranianët. Këto rastësi mund të ndikojnë bukur mirë në ardhmërinë e shoqërive. Shkurt thënë, ardhmërinë e një shoqërie e përcaktojnë katër

⁴ Këtë fjalë e ka thënë Xhafer Es-Sadiku i cili thotë se aty ku takohen përcaktimi (kaderi) absolut dhe liria absolute aty gjendet e vërteta.

faktorë: Individët, rastësitë, rregullat e mëhershme hyjnore dhe populli (en-nas). Më i rëndësishmi nga faktorë është en-nasi me rregullat që i ngërthen në vete. Ngase ai është përfaqësues i vullnetit të masave popullore dhe i rregullave ekzistuese në shoqëri të cilat mund të argumentohen me metoda shkencore.

Sipas Islamit njerëz të mëdhenj janë ata të cilët i kuptojnë mirë rregullat hyjnore dhe që së bashku me librat hyjnore dorëzohen pranë këtyre rregullave të cilat më pastaj i shndërrojnë në sukses.

Sasia e ndikimit të këtyre katër faktorëve në shoqëri, varet nga kushtet në të cilën gjendet shoqëria në momentin. Roli i personave të ngritur në shoqëritë me nivel të lartë të arsimit dhe të kulturës është i kufizuar, që nuk do të kishim mundur të themi për shoqëritë që ende nuk e kanë arritur shkallën e civilizimit (siç janë fiset apo klanet), ngase në to roli i personave të ngritur apo i liderëve është shumë i madh.

Ndikimi i katër faktorëve të lartpërmendur dallon edhe nga faza e zhvillimit të shoqërisë. Individualiteti i Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve selem], në Islam ka pasur një ndikim tejet konstruktiv i cili ka qenë bazament i themelimit të një civilizimi të ardhshëm, i ndryshimit të rrjedhës së historisë, i zhvillimit dhe i përparimit. Shkaku i kësaj është paraqitja e tij në një rajon gjeografik të caktuar siç është Gadishulli Arabik.

Gjendja e civilizimit në Gadishullin Arabik i ngjante shumë pozitës gjeografike. Ky gadishull edhe pse në tre anët ishte i rrethuar me ujëra, vuante nga mospasja e ujit. Ishte fqij i civilizime të mëdha: Në veri civilizimi grek dhe bizantin, në lindje civilizimi iranian, në juglindje civilizimi hindus, kurse në veriperëndim civilizimi aram-ibranian... Ashtu siç ishte fqij i civilizimeve ariane dhe semite, ishte fqij edhe i fesë së Musasë, Isasë dhe i asaj të Zoroasterit. Në kohën kur Pejgamberi i Islamit ia filloi kumtimit, të gjithë civilizimet ekzistuese e rrethonin Gadishullin Arabik. Mirëpo ashtu siç ndodhte me avullin e detërave që gjendeshin përreth i cili për shkak të pozitës gjeografike të gadishullit nuk arrinte dot të depërtojë në brendi, njëashtu edhe civilizimet e përmendura nuk arrinin dot të depërtojnë në brendinë e këtij gadishulli. Ja pra, Pejgamberi i Islamit në kësaj kushtesh ia ka filluar detyrës së vet. Prandaj nëse këtë fenomen e marrim dhe e analizojmë nga aspekti sociologjik, do të kishim thënë se individualiteti ka qenë faktor i madh në ndryshimin dhe zhvillimin e shoqërisë dhe të historisë. Nëse po të njëjtin fenomen (i cili ka ndodhur në shekullin e shtatë të epokës sonë) e shikojmë nga aspekti historik do të shohim se ky fenomen ka mbledhur gjithçka në vete dhe se ka qenë themelues i një civilizimi të ri dhe i një shoqërie të ngritur. Historiani i cili do ta kishte hulumtuar të kaluarën e këtij gadishulli do të kishte kuptuar se në atë kohë në gadishull ka ekzistuar një zbrastirë e madhe për nga aspekti kulturor dhe ai civilizues, më pastaj duke i parë ndryshimet, do të jetë e domosdoshme që i njëjti historian të pranojë se ndryshimet e paraqitura më vonë, paraqesin ndryshimet më të mëdha në historinë e njerëzimit e të cilat rrjedhin nga individualiteti i Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve selem]. Na kjo individualiteti i Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve selem], përfiton një rëndësi të veçantë dhe të pakrahasueshme.

Në përgjithësi ekzistojnë katër faktorë themelor në përbërjen e individualitetit: Në krye të këtyre faktorëve është se cila e mbjellë individualitetin shpirtëror. Xhizvitët⁵ thonë: “Fëmijën e juaj lëreni deri në moshën shtatë vjeçare te ne, pastaj edhe nëse veproni me të si të duani, ai përsëri deri në fund të jetës do të ngelë xhizvit.”

Nëna qysh duke e tajitur foshnjën me qumësht, me sjelljet kuptimplota, me dashurinë dhe me mëshirën që e posedon mundohet t’ia mbjellë botën shpirtërore fëmijut të vet.

⁵. Sektë kristiane e cila quhet “Grupi i Isasë”

Pas nënës në radhë vjen babai i cili luan rol të madh në krjimin e botës shpirtërore të fëmijut. Faktori i tretë është shkolla e cila e formatizon kahjen e orientimit të njeriut. Faktori i katërt është shoqëria dhe ambienti. Ndikimi i ambientin në edukimin e fëmijut është në proporcion me madhësinë e ambientit. Për shembull, njeriu që jeton në fshat është më pak i eksponuar pranë faktorëve konstruktiv nga ai i cili jeton në qytet. Faktori i pestë në krijimin e individualitetit është kultura e përgjishme e shoqërisë, apo në tërësi e botës. Ja pra këta pesë faktorë së bashku e formojnë botën shpirtërore të njeriut. Edukimi dotëthotë dhënia me vetëdije të një forme të caktuar shpirtit të njeriut për qëllime të caktuara. Nëse njeriu lihet kokë në vete, është e pamundur që t'iu përshtatet standardeve të të gjykuarit dhe të qëllimeve të jetës shoqërore. Për këtë arsye kemi zhvilluar kallëpe me të cilat njeriu zhvillohet në “përputhje me epokën” në të cilën edhe jeton.

Mirëpo të gjithë këto faktorë të numëruar nuk kanë marrë pjesë në formimin e individualitetit të Pejgamberit të Islamit i cili ka qenë faktori më i madh në ndryshimin e historisë.

All-llahu me vullnetin e vet e ka ruajtur Pejgamberin [sal-lall-llahu alejhi ve selem], nga çdo intervenim njerëzor të pranuar si rregull nga ambienti dhe koha e atëhershme e që ka mundur të luajë rol në formimin e botës shpirtërore të tij. Ky njeri i madh i cili ka ardhur për t'i shkatërruar këto kallëpe, sikur të ishte rritur sipas të njëjta standardeve, asnjëherë nuk do të kishte arritur ta plotësojë detyrën e përcaktuar. Pra ai do të kishte mundur me qenë një mjek i madh, por sipas modelit grek... Do të kishte mundur me qenë filozof i madh, por sipas modelit iranian... Do të kishte mundur me qenë matematikan ose poet, por vetëm sipas modelit të kohës së atëhershme... Pra nga e tërë kjo nënkuptojmë se është dashur që ai të rritet dhe të zhvillohet në një ambient në të cilin dominon zbrazëtira e kulturës dhe e civilizimit dhe ku nuk mund të bie nën ndikimin e pesë faktorëve të numëruar.

Për këtë arsye kur erdhi në këtë botë nuk arriti ta shohë babain. Edhe pse nënën e kishte të gjallë, dora e cila e mbante larg të gjitha kallëpeve dhe formave e dërgoi larg në shkretëtirë. Në atë kohë në mesin e arabëve ekzistonte një traditë: Fëmijën e lenin në shkretëtirë pranë ndonjë nëne qumështi. Më pastaj i kthenin në qytet pranë nënave të tyre. Për dallim nga kjo praktikë, pasi që e kthyen në Mekke, përsëri u dërgua në shkretëtirë. Atje qëndroi deri në moshën pesë vjeçare. Pas pak kohe i vdiq nëna. Këto preventiva hyjnore me finesa dhe me dituri të madhe ishin vënduar me qëllim të thyerjes së kallëpeve të grekëve, të lindjes, të perëndimit, të hebrenjve, të kristianëve dhe të mexhusëve, dhe për t'i zëvendësuar ato me kallëpe dhe forma të reja. Më vonë, në moshën e rinisë përcaktimi hyjnor përsëri e dërgoi në shkretëtirë. Kështu iu bë e pamundur që të zhvillohet në atmosferë lirie që ia mundësonin kallëpet e jetës qytetare. Për të mos ra nën kurrfarë ndikimi, Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem], u krijua në mesin e një shoqërie në të cilën mungonte kultura dhe civilizimi i përhapur. Madje ishte edhe analfabet, ngase nuk dinte shkrim-lexim. Domethënë se ishte mbajtur larg nga ndikimi i kallëpeve shkollore. Dallimi dhe epërsia më e madhe e një njeriu të cilit do t'i jepet një detyrë e këtillë është mbrotja e tij nga të gjitha kallëpet dhe procedurat formatizuese të njerëzve të asaj kohe. Nuk mundej të lihet gjithçka nën ndikimin e një njeriu të këtillë që ka qëndruar larg gjithë këtyre faktorëve e i cili do t'i shkatërrojë idhujt nga zjarri, do t'i mbyllë të gjitha akademitë në vend të së cilave do të themelojë xhamia; i cili do ta çrrënjosë formën dhe kallëpet e racës, kombit dhe të rajonit. Së pari i vdiq babai. Domethënë se standardet e të gjykuarit të babait të tij nuk kanë ndikuar në shpirtin e tij. Pastaj u larguar nga e ëma. Mirëpo mbi të gjitha këto, ishte i lindur në një

gadishull të thatë dhe që ishte larg kulturës universale. Kjo bëri që shpirti i madh i tij të mos lëndohet nga edukimi i asnjë kulture, civilizimi apo “feje” tjetër. Sepse një shpirt i cili do të arrijë të kryejë një detyrë të jashtëzakonshme, nuk mund të formohen nga veprimet që duken se janë të bukura. Kjo varfëri e dukshme me të vërtetë paraqet privilegjinë dhe epërsinë më të madhe që iu është dhënë njeriut që e ka luajtur rolin më të madh në historinë njerëzore.

Konferenca e dytë

Tema ynë është lidhur me qëndrimet tona të cilat na shërbejnë në arritjen e të kuptuarit dhe të njohurive për Islamin. Fraza “qëndrime të ndryshme” paraqet një nocion shumë të qartë dhe të rëndësishëm në aspektin shkencor. Ky nocion tregon se cilën metodë duhet aplikuar për ta kuptuar Islamin.

Çështja e përcaktimit të metodës është shumë e rëndësishme në histori, e posaçërisht në historinë shkencore. Metodatat të cilat përdoren gjatë hulumtimit të së vërtetës janë para filozofisë, shkencës dhe nevojës e të qenurit i aftë.

E dijmë se Evropa një mijë vjet ka jetuar në stagnim dhe ngathtësi të tmerrshme të mesjetës, në mbarim të së cilës stagnimi dhe ngathtësia ia lëshon vendin shkencës, artit, letërsisë dhe zgjuarjes së gjithanshme dhe revolucionare në sferat njerëzore dhe shoqërore. Ky revolucion dhe eksplodim i përnjëhershëm në të menduarit të njeriut, hapi rrugën e lindjes së civilizimit dhe të kulturës së sotme.

Tani vetes duhet t’ia parashtrojmë këtë pyetje: Çka ishte ajo që e këndelli Evropën nga jeta e mpirë mijëvjeçare? Nga buroi ndryshimi i përnjëhershëm i kahjes? Si ndodhi që të vërtetat që nuk mundi t’i gjejë për një mijë vjetë, t’i gjejë brenda tre shekujve? E tërë kjo ka rëndësi tejet të madhe, madje mund të thuhet se është çështja më me rëndësi për të cilën shkenca duhet të gjejë përgjigje.

Pa dyshim se ekzistojnë shumë shkaqe për mpierjen e mesjetës në Evropë. Me aktivimin e shumë faktorëve, Evropa shpëtoi nga kjo mpierje dhe në çdo sferë tregoi një zhvillim marramendës dhe shumë të shpejtë. Në fillim të nënvizojmë se faktori kryesor i mpierjes mijëvjeçare në sferën e të menduarit, civilizimit dhe të kulturës në Evropë, ka qenë logjika e analogjisë e Aristotelit. Me ndryshimin e shprehisë së shikuarit të problemeve dhe të objekteve nga ky kënd, ndryshoi shkenca, shoqëria, bota dhe jeta e njeriut e cila është e ndërlidhur me ta. Përshkak të studimit që ua bëjmë lëvizjeve kulturore, ideologjike dhe shkencore, këtë ndryshim të metododës e pranojmë si një ndër shkaqet kryesore të lindjes së renesansës. Në të njëjtën kohë, nëse këtë ndryshim e marrim dhe e shikojmë nga aspekti sociologjik, do të shohim se shkaku kryesor ka qenë kalimi i sistemit feudal në atë borgjez. Kurse një gjë e tillë bëri që të paraqitet çarë në murin e ngritur mes lindjes muslimane dhe perëndimit kristian pas luftërave të kryqëzatave. Domethënë se “metoda” luan rol të madhe në përparimin apo në ngecjen. Pra nuk është vetëm gjenialiteti ai i cili ka bërë të lindë stagnimi dhe mpierja apo lëvizja dhe përparimi, por metoda e të hulumtuarit. Për shembull ekzistojnë shumë gjenij të shekullit të katërt dhe të pestë të para epokës së re, të cilët nuk mund të krahasohen me ata të shekullit të katërbëdhjetë, pesëmbëdhjetë dhe të gjashtëmbëdhjetë. Padyshim se Aristoteli dhe Platoni janë gjenij më të mëdhej se Francis Baconi dhe Roger Baconi. Mirëpo si është e mundur që Baconët edhe pse nuk mund të krahasohen me një gjenij siç është Platoni të jenë kontribues në zhvillimin shkencor? Dhe përsëri si është e mundur që këta dy gjenij (Aristoteli dhe Platoni) të jenë shkaktarë të stagnimit mijëvjeçar në Evropë? Me fjalë tjera, si është e mundur që një gjenij të jetë shkaktarë i

stagnimit në botë, kurse në anën tjetër një kokë që është e zhvilluar mesatarisht, të jetë hapëse e rrugës së zhvillimit shkencor dhe e zgjuarjes shoqërore? Sipas nesh, shkaku i kësaj është zbulimi i metodave logjike nga inteligenca mesatare. Domethënë se nëse gjeniu nuk ka arritur ta gjejë metodën e drejtë në qasjen e problemeve, nuk do të mundë ta përdorë gjenialitetin e vet. Për këtë arsye shohim se në shekullin e katërt dhe të pestë të para epokës së re, në civilizimin grek janë mbledhur në një vend me duzine gjenij, nga ndikimi i të cilëve njerëzimi nuk ka arritur të shpëtojë deri në ditët e sotme. Në anën tjetër shohim se si është e mundur që në Athinën e Aristotelit të mos mund të shpiket as një rrotë e thjeshtë, kurse në anën tjetër në Evropë një teknik i thjeshtë i cili nuk kupton asgjë nga gjërat e shkruajtura nga Aristoteli dhe të nxënësve të tij, të shpikë me qindra gjëra. Shembulli më i mirë i kësaj është Edisoni i cili nuk është më i mençur se një nxënës i klasës së tretë të nxënësve të Aristotelit, mirëpo në kuptimin e natyrës dhe të zhvillimit të industrisë ka dhënë kontribut më shumë se gjenijt e vitrinës së Aristotelit të cilët një mijë e katërqind vjet i kanë shkatërruar shtyllat. Edisoni ka shpikur më shumë se një mijë gjëra të mëdha apo të vogla. Të mendosh është njëjtë si të ecësh. Në kampionatin e të ecurit, më shpejtë arrinë në cak ai i cili në rrugë të drejtë ecë me një këmbë duke kërcyre se sa ai i cili bën manovrimet nëpër dredhat e malore. Sado që të ecë shpejtë kampioni, nëse ecë nëpër dredha mund të ndodhë të mos arrijë apo të arrijë në cak.

E para gjë që duhet bërë në degët e ndryshme të diturisë (letërsi, shoqërore, artistike, psikologjike) është zgjedhja e metodës së drejtë (adekuate). Për këtë arsye, çdo hulumtues para se t'ia fillon hulumtimin duhet ta bën zgjidhjen e metodës më të mirë të hulumtuarit. Ne si njerëz që i takojmë një feje të madhe, jemi të detyruar të shërbehemi nga eksperiencia historike dhe ta kuptojmë drejt Islamin me metoda të drejta. Tanimë nuk mundemi t'iu përkulemi gjërave që nuk i njohim. Sidomos përgjegjësia e intelektualëve për t'i mësuar gjërat që i dijnë të shenjta është shumë e madhe. Ky obligim nuk është vetëmse obligim islam; por në të njëjtën kohë është edhe obligim shkencor dhe njerëzor. Individualiteti i njeriut matet sipas shkallës së besimit që e posedon. Besimi si i vetëm nuk paraqet ndonjë meritë të veçantë. Nëse besojmë në diçka që nuk e dimë në kuptimin e plotë të fjalës, do të ishte shumë pak e vlefshme. Meritë e vërtetë është vetëm atëherë kur dihen në tërësi gjërat që i besojmë. Pra nëse Islamim e besojmë si fe tonën, jemi të obliguar t'i zgjedhim metodat e drejta dhe ta mësojmë në mënyrë perfekte dhe korrekte. Kur jemi këtu, parashtrohet pyetja se cila është metoda e drejtë. Për ta mësuar Islamin nuk mund t'i aplikojmë metodat evropiane të naturalizmit, psikologjisë dhe të sociologjisë. Duhet të jemi modernistë në zgjidhjen e metodave. Natyrisht se duhet t'i mësojmë metodat e Evropës, mirëpo nuk jemi të obliguar t'iu përshtatemi. Sot në të gjitha degët shkencore kanë ndryshuar metodat shkencore të cilat janë zëvendësuar me qëndrime (metoda) të reja. Edhe në hulumtimet fetare duhet zbuluar rrugë të reja, duhet zgjedhur metoda të reja. Për arsye se Islami nuk është fe njëdimensionale, është e qartë se mësimi i tij nuk mund të arrihet vetëm me një metodë. Islami nuk është fe e kufizuar vetëm me intuitën mistike dhe me marrëdhëniet mes njeriut me Zotin. Sepse ky është vetëm një dimension i fesë islame, mësimi i të cilit arrihet duke e aplikuar metodën filozofike në suaza të mendimeve të përgjithshme metafizike. Një dimension tjetër i kësaj feje është problemi vital i njeriut mbi këtë botë. Hulumtimi i këtij problemi mund të bëhet duke u shërbyer nga metodat të cilat përdoren sot nga shkencat shoqërore. Përveç kësaj duhet ditur se Islami është një fe e cila në të njëjtën kohë ka krijuar një shoqëri dhe një civilizim. Pra për t'iu hulumtuar këto nevojiten metodat të cilat përdoren në sociologji dhe histori. Nëse Islamin e shikojmë

vetëm nga një kënd, do të mund të shohim vetëm një dimension të këtij fakti shumdimensional. Madje nëse këtë dimension e shohim drejtë, ai nuk do të ishte i mjaftueshëm për të dhënë mendime që kanë të bëjnë me “tërësinë”. Kur’ani i cili është një libër i shumanshëm dhe disa anë të së cilit gjatë historisë janë analizuar nga shkencëtarët e mëdhenj, paraqet një argument të qartë i kësaj që u tha. Për shembull, një dimension të Kur’anit e përbën ana letrare dhe linguistike; specialistët e kësaj problematike e kanë analizuar hollësisht këtë dimension. Një dimension tjetër është i përbërë nga temat që kanë të bëjnë me filozofinë dhe besimin. Filozofët dhe teologët duhet të mendojnë mbi këtë dimension të Kur’anit. Një dimension tjetër mbi të cilit nuk është menduar shumë deri më sot, janë temat që kanë të bëjnë me historinë, sociologjinë dhe me psikologjinë. Mosanalizimi i këtij dimension rrjedh nga moszhvillimi i këtyre shkencave ashtu siç janë zhvilluar shkencat natyrore. Njëashtu edhe shkenca e historisë konsiderohet si njëra ndër shkencat më të reja mbi sipërfaqen e tokës. Shkenca e historisë është krejtësisht diçka tjetër nga materiali historik dhe nga librat e vjetra historike. Fati i popujve, marrëdhëniet e tyre midis vete, shkaqet e ngritjes dhe të shkatërrimit, shpeshherë përmenden në Kur’an. Të gjitha këto, historianët i vështrojnë nga këndi historik dhe shkencor, kurse sociologët i analizojnë me metoda sociologjike. Temat kozmologjike, çështjet që kanë të bëjnë me shkencat natyrore dhe me fenomenet natyrore, duhet hulumtuar dhe analizuar me metoda të shkencave natyrore. Përshkak se fusha e veprimit tim dhe specializimi im janë historia dhe sociologjia, mendoj se duhet të potencoj se qëndrimet e mia janë studime preliminare. Do t’i prezantoj dy metoda të cilat e reflektojnë sociologjinë, historinë dhe shkencat shoqërore. Për të qenë më i qartë, do të bëj krahasim mes fesë dhe individit.

Njohja e njeriut mund të njihet në dy mënyra (informimi lidhur me njeriun).

E para mënyrë përbëhet nga njohja e mendimeve, punimeve shkencore, teorive dhe të fjalimeve dhe nga hulumtimet e veprave të personit. Për ta kuptuar një person, paraprakisht duhet ditur mendimet dhe besimet e tij. Mirëpo, edhe ato nuk mjaftojnë që të kuptohet në tërësi personi në fjalë. Sepse shumë gjëra në jetë nuk reflektohen në vepra, shkrime apo fjalë; madje edhe nëse janë të reflektuara mund të ndodhë të mos i vërejmë.

Mënyra e dytë e cila është plotësuese e të parës, duke e analizuar biografinë e personit iu jep përgjigje këtyre pyetjeve se; ku është i lindur personi; prej çfarë familjeje rrjedhë; si i ka kaluar fëmijëria; cila është gjeneza e tij; cilit vend i takon; çfarë arsimimi ka vijuar; në çfarë ambienti është zhvilluar; ku e ka mbaruar shkollimin; kush kanë qenë mësimdhënës të tij; me çfarë problemesh është ballafaquar në jetë; cilat janë sukseset e tij dhe se cilat janë mossukseset e tij.

Nga kjo nënkuptojmë se ekzistojnë dy mënyra themelore e të informuarit lidhur me individin: E para është e përbërë nga hulumtimi i mendimeve dhe i besimeve të individit, e dyta është e përbërë nga analiza e biografisë së individit nga fillimi deri në mbarim.

Edhe feja është sikurse njeriu. Medimet e një feje, mendimet që e thërrasin njeriun të besojë në atë fe, janë të mbledhura në librin e asaj feje. Ndërsa biografia e asaj feje është historia e saj. Nga kjo nënkuptojmë se ekzistojnë dy mënyra të të kuptuarit të Islamit drejtë dhe qartë me metoda bashkëkohore. E para mënyrë është analizimi në formë »përmbledhjeje« të «mendimeve» dhe të elementeve shkencore dhe letrare të Islamit në Kur’an; kurse e dyta është marrja si «shumë e përgjishme» e tërë historisë islame dhe të obligimit të Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve selem], nga dita kur ka filluar ta zbatojë urdhërin e deri në ditët e sotme. Mirëpo edhe pse gjatë hulumtimeve

mbi Islamin tema kryesore çdo herë është dashur të jenë Kur'ani dhe historia islame, këto tema vazhdimisht janë anashkaluar. Si replicim i kësaj, gëzon fakti se zgjuarja që vërehet në shoqëritë islame, ka bërë që muslimanët e sotëm të fillojnë t'i japin rëndësi mësimi të Kur'anit dhe të analizimit të historisë islame me metoda analitike. Ferhad Abbas në librin e titulluar "Terri i Imperializmit" thotë se zgjuarja në mënyrë shoqërore në vendet (siç është Maroko, Tunisi dhe Algjeria) e Afrikës Veriore, ka filluar pasi që në programet e institucioneve fetare është futur komentimi i Kur'anit i përgatitur nga Muhammed Abduh i cili në atë kohë nuk është përdorur shumë. Shohim se, (shkrimtari i cili pikënisjen e vet nuk e ka në fe) zgjuarjen fetare dhe fillin e lëvizjeve në vendet e Afrikës Veriore, e sheh në mësimin e Kur'anit dhe në lënien anash të shkencave të ndryshme fetare nga prijësit fetarë. Mësimi i historisë islame rrjedhë nga mësimi i Kur'anit i cili është burimi i mendimve islame dhe gjërave të ndryshme që ndodhin...

Kjo është rruga më e mirë e arritjes së rezultateve shkencore më të sigurt dhe më të sakta për Islamin. Nëse sot muslimanët e Iranit duke u bazuar në Kur'an dhe në historinë Islame arrijnë që xhamitë t'i shndërrojnë në qendra të aksioneve dhe nëse arrijnë t'i përgatisin planet e lëvizjes së masave popullore, do t'i hedhin themelet më të forta që mund të ekzistojnë për një zhvillim dhe një përhapje të madhe të Islamit.

Ekziston edhe një metodë tjetër të mësimi dhe të kuptimit të Islamit: Metoda e tipologjisë. Kjo metodë për të cilën shumë sociologë besojnë se është ndikuese, temat i klasifikon sipas llojit, pastaj i krahason sipas bazës së përcaktuar.

Duke u bazuar në këtë metodë e cila përdoret në sfera të ndryshme të shkencave shoqërore në Evropë, arrita të zhvilloj një metodë që mund të alpikohet për hulumtimin e çdo feje. Sipas kësaj metode çdo fe i ka pesë cilësi të veçanta të cilat krahasohen me cilësitë e feve tjera që korrespondojnë me to:

- 1) Çdo fe ka zotin apo zotërat e vet; idoli të cilit i përkulen përcjellësit e saj.
- 2) Çdo fe ka peygamber; njeriu që e përcjellë mesazhin e asaj feje.
- 3) Çdo fe ka librin; themeli i rregullave të fesë që i thërrasin njerëzit të besojnë dhe t'i përshtaten.
- 4) Mjedisi i çdo Peygamberi dhe i kategorisë së njerëzve që iu bën thirrje. Çdo peygamber shpalljen e ka përcjellur me mënyra të ndryshme. Ndonjëri i ka bërë thirrje popullit (en-nasit); ndonjë tjetër i ka thirrur të ngriturit dhe mbretërit; kurse ndonjë tjetër u ka munduar t'i thërrasë intelektualët, filozofët dhe të zgjedhurit. Nga kjo nënkuptojmë se ndonjë peygamber nuk është konfrontuar me pushtetin e asaj kohe, që nuk do të thotë se e njëjta gjë ka vlejtur edhe për ndonjë peygamber tjetër i cili është konfrontuar me pushtetin.
- 5) Çdo fe i ka njerëzit që i kultivon dhe që ia përfiton shoqërisë dhe historisë. Këta janë njerëz që e kanë rolin e përfaqësuesit. Nëse dëshirojmë të kemi ndonjë ide për ndonjë fabrikë apo për ndonjë arë, duhet të shikojmë në prodhimet që përfitohen nga ajo fabrikë apo nga ajo arë. E njëjta gjë vlenë edhe për fenë. Ajo është një fabrikë e cila i kultivon njerëzit, "prodhimet" e së cilës tregojnë se për çfarë fabrike bëhet fjalë.

Sipas kësaj metode, për ta mësuar më mirë Islamin, së pari duhet ta njohim Zotin, pra All-llahun. Përfitimi i njohurive mbi Zotin mund të arrihet duke e shikuar natyrën dhe duke menduar mbi të; mund të përdoren metoda të ndryshme siç janë metodat filozofike, metoda e të zbuluarit dhe e urtësisë. Mirëpo metodën të cilën unë e propozoj është metoda e tipologjisë. Kjo është një metodë e cila i analizon cilësitë dhe atributet e Zotit që na i mëson Islami. Për shembull bën analizë se a është Mëshirues? A është më i lartë se gjithçka? A është i përzier me njeriun? A është falës? A është më tepër se

dënues apo është e kundërta? Shkurt thënë, çfarë zoti është? Për t'i kuptuar më drejtë atributet e Zotit, duhet të shikojmë në Kur'an dhe në fjalët e Pejgamberit dhe të personave të zgjedhur që janë edukuar pranë tij. Në Kur'an dhe në fjalët e Pejgamberit dhe të shokëve të tij këto attribute hyjnore janë shumë të qarta. Pasi që t'i shikojmë këto attribute në Islam, duhet t'i shikojmë idolet e "feve" tjera siç janë Ahuramazda, Jehova, Zeusi, Baali etj.

Pasi që ta mësojmë dhe ta kuptojmë Islamin, e dyta punë që duhet bërë është mësimi i librit të tij, Kur'anin. Njeriu duhet ta dijë se çfarë libri është Kur'ani, se për çfarë flitet në të dhe se cilave çështje iu jipet rëndësi në të. Duhet kuptuar se a flet për jetën e kësaj bote, apo për jetën e botës tjetër? Duhet kuptuar se a flet për moralin individual, apo për problemet e shoqërisë? Duhet kuptuar se a merret më shumë me gjëra konkrete apo me gjëra abstrakte? Duhet kuptuar se a interesohet më shumë për njeriun apo për natyrën? Shkurt thënë, duhet kuptuar se për cilat tema sa interesohet?

Për shembull duhet shikuar se a kërkon nga njeriu të ketë shpirt të dëliruar për ta kuptuar ekzistimin e Zotit dhe për ta gjetur Atë? Apo për të arritur deri te këto njohuri, nga ne kërkon që ta analizojmë botën e brendshme dhe të jashtme? Apo vallë mos duhet të përcillen të dy rrugët për ta arritur qëllimin? Pasi që t'iu japim përgjigje këtyre pyetjeve mund të kalojmë në krahasimin e Kur'anit me librat (Tevrati, Inxhili, Lamtumirëset, Avestat) e "feve" tjera.

E treta gjë duhet bërë për ta njohur Islamin është mësimi se çfarë ka qenë individualiteti i Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve selem]. Është më rëndësi tejet të madhe njohja dhe të kuptuarit e Pejgamberit të Islamit. Madje duhet ditur se në historinë e njerëzimit nuk ka dikush tjetër që ka luajtur rol të madh ashtu siç ka luajtur Pejgamberi. Roli i Pejgamberit në ngjarjet që ka marrur pjesë, është jashtëzakonisht i madh dhe pozitiv. Kur flasim për individualitetin e Pejgamberit, mendojmë për cilësitë njerëzore të tij, për marrëdhëniet e tij me All-llahun dhe për fuqinë shpirtërore që e ka përfituar nga ato marrëdhënie. Ma fjalë tjera, interesohemi për anën njerëzore dhe pejgamberike të tij. Ana njerëzore e tij kërkon të analizohet mënyra e të folurit të tij, mënyra e të punuarit, mënyra e buzëqeshjes, mënyra e uljes, sjellja ndaj të huajve, armiqëve, miqëve dhe ndaj familjes. Duhet analizuar edhe atë se si i ka përballuar "mossukseset", fitoret dhe problemet e mëdha shoqërore. Nga kjo kuptojmë se rruga themelore e të kuptuarit të thelbit të Islamit kalon nëpër njohjen e Pejgamberit të Islamit, e më pastaj duke i mësuar pejgamberët (siç janë Musa, Isa, Zoroastri apo Buda) e "feve" tjera.

E katërta gjë që duhet bërë është analizimi i kushteve në të cilat është zhvilluar Pejgamberi i Islamit. Për shembull ardhja e tij a ka qenë joeshenjtë? A ka pasur dikush që e ka pritur atë? A ka pritur ai vet ndonjë detyrë të atillë? A e ke ditur se një ditë do t'i jipet një detyrë e atillë? Vallë kjo rrjedhë e jashtëzakonshme, kjo rrëmujë që në fillim i dukej vështirë se do të mundej ta pranojë e që ia ndryshoi stilin e të folurit dhe individualitetin, a i erdh papritmas? Si arriti ta përballojë reagimin e njerëzve kur për herë të parë ua përcolli shpalljen që i kishte ardhur? Cilët njerëz i thirri në mënyrë speciale dhe kundër kujt luftoi? Të gjitha këto janë pyetje të cilat na ndihmojnë më mirë ta kuptojmë Pejgamberin e Islamit dhe të kushteve në të cilat është zhvilluar ai. Nëse kushtet në të cilat ka jetuar Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem], i krahasojmë me kushtet e pejgamberëve tjerë të vërtetë apo të rrejshëm, siç janë; Isa, Ibrahim, Musa, Zoroastri, Konfuçio, Buda etj., do të vijmë në këto përfundime: me përjashtim të atyre që kanë qenë në vijën e Ibrahimit a.s., të gjithë të tjerët janë drejtuar kah pushtetet jofetare dhe në bashkëpunim me ta janë munduar që njerëzve t'ua përvetësojnë "fenë" dhe t'ua përcjellin mesazhin. Si replicimi i tërë kësaj, duke ia filluar nga Ibrahim a.s., e

deri te Pejagamberi i fundit, detyra e të gjithë peygamberëve që kanë qenë në vijën e Ibrahimit a.s. është manifestuar me luftë kundër pushteteve jofetare që kanë ekzistuar në atë kohë. Ibrahimit a.s., qysh në fillim të detyrës së vet e ngren sopatën mbi idhujt dhe fillon t'i shkatërrojë ato. Për të treguar se iu ka shpallur luftë të gjithë idhujve të asaj kohe, me sopatë ia mëshon idhullit që populli më së shumti i ka besuar. Shenja e parë e fillimit të detyrës së Musasë a.s., ka qenë atëherë kur ai me shkop në dorë dhe me veshëmbathje të një bariu, del para Faraonit dhe në emër të tehdit (monoteizmit) i shpallë luftë faraonizmit. Poashtu edhe Isa a.s., iu shpallë luftë prijësve fetarë hebrej të cilët bashkëpunojnë me imperializmin e Romës. Edhe Pejgamberi i Islamit që në fillim të shpalljes së mesazhit të ardhur ia fillon luftës kundër aristokracisë, pronarëve të robërve, tregtarëve kurejshit dhe kundër taifitëve pronarë të tokave. Krahasimi i të dy grupeve, i grupit të vijës së Ibrahimit dhe i grupit tjetër, na e lehtëson të kuptuarit e thelbit, të shpirtit dhe të burimit të fevë të ndryshme në fjalë.

Punën e pestë që duhet bërë për ta mësuar dhe kuptuar Islamin, është analizimi i njerëzve shembullor që kjo fe ia ka dhuruar njerëzimit. Për shembull, nëse Harunin a.s., e marrim si shembull për sheriatin e Musasë a.s., Sen Polin për sheriatin e Isasë a.s., Pejgamberin a.s., Aliun r.a., Huseinin r.a. dhe Ebu Zerrin r.a., për sheriatin islam, do të shohim se kuptimi për çdo sheriati do të fitojë peshë më të madhe.

Në këtë ligjeratë si shembull ta marrim Huseinin r.a., si njeri të kultivuar nga Islami, i cili e ka e besuar All-llahun, Kur'anin dhe Pejgamberin [sal-lall-llahu alejhi ve selem]. Jeta e Huseinit r.a., na është mirë e njohur, gjithashtu na janë të njohura edhe parimet për të cilat ka luftuar ai. Na janë të njohura edhe kujdesi i tij për çështjet e shoqërisë, fatin e popullit, idetë e tij, lidhshmërinë e tij, sakrifikimin e vetes... Përveç kësaj e dijmë se në atë çast kur iu është rrezikuar besimi dhe e vërteta, të gjitha gjërat që i ka dashur në jetë i ka sakrifiku me një lëvizje të vetme. Shkurt thënë i biri i Aliut r.a., Husieni r.a., është një shembulli mirë për qëllimin e analizës sonë. Pranë nesh gjendet edhe një metodë e cila na e lehtëson të kuptuarit e jetës të Huseinit r.a., të menduarit të tij dhe të cilësive e tij. Sipas kësaj metode na bëhet e mundur krahasimi i Huseinit r.a., me dy persona tjerë të cilët janë muslimanë, por që janë edukuar ndryshe. Njëri prej tyre është Ebu Ali Sina i cili është edukuar në frymën filozofike, kurse tjetri është Husein M. Mansur Hallaxhi i cili është edukuar në frymën sufiste. Kur të krahasohen këta tre persona, më lehtë do të mundemi t'i konceptojmë pikat e përbashkëta dhe dallimet mes filozofisë, sufizmit dhe Islamit.

Ibën Sina është një filozof, shkencëtar dhe gjenij i civilizimit islam i lavdëruar nga të gjitha shkencat dhe nga historia e filozofisë. Mirëpo, kur të shikohet nga aspekti shoqëror ky filozof i rëndësishëm dhe shkencëtar, do të shihet se e ka pëlqyer të punojë nën urdhërin e pushtetarëve dhe të udhëheqësve. Atë aspak nuk e intersonte fati i njerëzve apo ardhmëria e shoqërisë në të cilën jetonte. Sipas tij, nuk kishte kurrfarë lidhje mes fatit të tij dhe fatit të tjerëve. Mendimi i vetëm i tij ishte temat shkencore dhe hulumtimet. Jeta që ishte jashtë kësaj kornize nuk e intersonte fare. Ai që i jepte para dhe pozitë mund t'i hipte në qafë.

Kur është fjala për Hallaxhin... Edhe ai ishte një njeri që digjej. Nuk mund të kërkohet përgjegjësi prej një njeriu që digjet në zjarr. Puna e vetme e tij ishte djegija dhe britma. Vallë për çka u digjte Hallaxhi? Për shkak të dashurisë së madhe ndaj Zotit. Nëpër rrugët e Bagdatit e kapte kokën me të dy duart dhe duke vrapuar bërtiste: "Ma theni kokën... Ajo është ngritur kundër meje!.. Më shpëtoni nga zjarri i brendshëm... Unë jam një hiç... Unë jam Ene'l Hakk!" ai donte të thosë: "Unë nuk ekzistoj më, i vetmi që ekziston është Zoti." Hallaxhi vazhdimisht digjej nga dashuria ndaj Zotit dhe kjo ishte

dehja e vërtetë e tij. Mirëpo paramendoni në Iran të ketë njëzet e pesë milionë Hallaxhë. Paramendoni si do të dukej sikur të gjithë të dilnin në rrugë dhe të bërtisnin: “Ejani më vritni mua... Nuk mund më të duroj... Unë jam hiç...Nën xhyben time nuk ka askush tjetër përpos Zotit!” Këto afshe të zjarrta e tregojnë një lloj dialektike shpirtërore apo mistike. Nëse të gjithë anëtarët e shoqërisë sillen si Hallaxhi apo Ibën Sina, mesin do ta kaplojë mjerimi dhe rrënimi. Mirëpo tani paramendoni një shoqëri e cila do të ishte e përbërë nga një Husein dhe nga disa Ebu Zerrë. Një shoqëri e tillë do të kishte jetë, liri, shkencë, mendime, fuqi dhe stabilitet. Një shoqëri e tillë do ta kishte mundur armikun dhe me të vërtetë do ta kishte dashur All-llahun.

NJERIU DHE ISLAMI

Çështja njeri është çështa më me rëndësi... Themeli i civilizimit të sotëm është humanizmi: esenca e tij qëndron në origjinën e njeriut dhe në përkuljen që i bëhet atij. Besohet se në të kaluarën fetë i kanë shtypur njerëzit dhe se i kanë detyruar të sakrifikohen në emër të zotërave. Sipas asaj që thuhet, fetë i kanë detyruar njerëzit të mos e llogarisin fare vullnetin individual para vullnetit të zotit. Thuhet se njerëzit vazhdimisht është dashur të falen, të luten, të kërkojnë ndjesë apo diçka tjetër nga Zoti. Nëse është kështu, do të thonim se humanizmi është një filozofi e cila e ka luftuar filozofinë fetare e cila që nga periudha e renesansës është ndërtuar mbi të padukshmën; filozofinë e cila është ndërtuar mbi botën e mbinatyrshme. Pra, humanizmi është filozofi për të cilën thuhet se ka luftuar që përsëri të ngritet lartë origjina e njeriut.

Edhe pse humanizmi rrënjët i ka në Athinë, ai ende gjendet në civilizimin perëndimor. Është fakt se humanizmi ka lindur si reagim kundër kristianizmit të mesjetës dhe të filozofisë skolastike.

Qëllimi im në këtë ligjeratë është që nga prizmi i Islamit ta analizoj çështjen njeri, t'i jap përgjigje pyetjes "Si e sheh Islami njeriun?" Kuptohet se kjo ligjeratë do të jetë brenda mundësive të mia dhe brenda asaj se sa do të na premtojë koha. Vallë a e sheh Islami njeriun para Zotit si krijesë pa rrugëdalje? Vallë a e mohon Islami në tërësi origjinën e njeriut? Apo i jep origjinë dhe e paralajmëron për virtytet? Kjo është tema për të cilën dua të diskutoj...

Se si nocioni humanizëm dhe "njeri" qëndron në fetë e ndryshme, më së miri mund të kuptohet nëse merret dhe shikohet se çfarë thotë çdonjëra prej tyre për krijimin e njeriut. Mirëpo, tani nuk kemi kohë t'i marrim dhe t'i analizojmë të gjitha "fetë" e lindjes dhe të perëndimit. Prandaj sot do të flas vetëm për filozofinë krijuese të feve të para-Islamit që i kanë kumtuar Musa a.s., Isa a.s., dhe Ibrahim a.s. (Islami është plotësuesi i këtyre feve).

Si sqarohet krijimi i njeriut në Islam apo në fetë ibrahimiane që e kanë arritur përsosjen me Islam? A mund ta kuptojmë rëndësinë dhe vendin e njeriut nga stili i përdorur në Kur'an (pra në librin e All-llahu) dhe në hadithe (pra në fjalët e Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve selem]) kur flitet për krijimin e njeriut?

Duke e analizuar kriterin Adem (është simbol i njeriut) në Kur'an, mund të kuptojmë se si e shikon njeriun All-llahu, gjegjësisht Islami. Përderisa jemi këtu të them edhe këtë që të shërbejë si hyrje në këtë temë; gjuha që përdoret në fe është gjuhë simbolike, sidomos në fenë samiite në të cilën besojmë ne. Pra fjalën e kam për gjuhën më të përsosur dhe më të ngritur, gjuhë e cila kuptimet e ndryshme i shprehë me imazhe dhe simbole. Kjo gjuhë është shumë më letrare dhe më kuptimthellë se sa gjuhët që i shprehin gjërat drejtë dhe pa kurrfarë ndërmjetësimi. Është shumë e lehtë për t'u mësuar gjuha e cila referohet në komunikimin e drejtëpëdrejtë dhe që është e thjeshtë dhe pa simbole e imazhe, mirëpo ajo gjuhë është e paqëndrueshme. Filozofi i madh egjiptian, Abdurrahman Bedevi thotë se filozofitë dhe fetë të cilat gjatë sqarimit të mendimeve dhe të edukatës përdorin gjuhë të drejtëpëdrejtë dhe njëdimensionale, nuk mund të jetojnë gjatë. Pa marrë parasysh se a është fe apo ndonjë filozofi, të gjitha i drejtohen popullit, intelektualëve dhe njerëzve që u takojnë origjinave dhe klasave të ndryshme. Pastaj duhet ditur se thirrjes së një feje nuk i përgjigjet vetëm se një gjeneratë, por se i përgjigjen shumë gjenerata gjatë historisë. Padyshim se ka dallim mes gjeneratave në të menduarit, në nivele dhe në këndvështrime. Nga e tërë kjo nënkuptojmë se duhet

përdorur fjalë të pasura dhe të shumkahshme me qëllim që thirrjes t'i përgjigjen njerëz të klasave dhe të gjeneratave të ndryshme. Nëse thirrja është njëkahëshe, atëherë duhet ditur se thirrja i bëhet vetëm një klase dhe se e njëjta thirrje nuk ka kurrfarë domethënie për njerëzit e klasës tjetër. Në atë rast ndoshta thirrja do të përcillet deri te gjenerata e ardhshme, por nuk do të mundë të vazhdojë më tutje. Ja pra mu për këtë arsye veprat e pavdekshme letrare janë shkruajtur në gjuhë simbolike. Për shembull poezitë e Hafizit janë të pavdekshme dhe çdo herë kur i lexojmë gjejmë kuptime të reja sipas mendimit tonë, shijes sonë apo sipas këndvështrimit tonë. Mirëpo nuk mund të themi se e njëjta gjë vlenë edhe për historinë e Bejhakiut apo për "Gylistanin" e Sadiut. Kur e lexojmë "Gulistanin" mahnitemi nga bukuria e fjalëve dhe nga rradhitja e tyre; mirëpo një pjese e madhe e mendimeve të prezentuara në atë libër kanë dalur nga moda, ngase gjërat që ka dashur me i thënë Sadiu janë shumë qarta dhe të gabuara. Kur është fjala për Hafizin, shohim se stili i tij është i shumkahshëm dhe se çdokush fjalët e tij i komenton sipas kuptimit që lindë nga shija dhe mendimi i vet; kështu nga teksti në fjalë arrihet të nxirren kuptime të reja.

Për këtë arsye nevojitet përdorimi i gjuhës simbolike nga ana e feve; gjuhë me të cilën iu drejtohen grupeve dhe gjeneratave të ndryshme të njerëzve. Në fe ekzistojnë shumë nocione të cilat nuk mund të kuptohen në shikim të parë. Nëse feja në njërin anë nuk i shprehte mendimet me një gjuhë të përbashkët që dihej nga të gjithë, nuk do të kishin mundur ta kuptojnë njerëzit e asaj kohe; mirëpo nëse po të njëjtat mendime i shprehte vetëm me gjuhën e asaj kohe, më vonë nuk do të kishin kurrfarë kuptimi. Prandaj edhe ka qenë obligative për fenë të përdorë imazhe dhe simbole të ndryshme të cilat do të kishin fituar kuptime me zhvillimin e shkencës dhe të mendimeve njerëzore. Nga e tërë kjo mund të vijmë në përfundim se ka qenë e patjetërsueshme që kriteri Adem lidhur me krijimin e njeriut edhe pse ka kaluar katërmbëdhjetë shekuj, edhe pse shkenca dhe mendimet njerëzore janë zhvilluar, të jetë i kuptueshëm dhe të mund të konceptohet.

Si është krijuar njeriu sipas Islamit?

Në fillim All-llahu iu drejtohet melekëve më këto fjalë: "... **Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës!..**" (Bekare: 30). Shifni se çfarë rëndësie të madhe i kushtohet njeriut në Islam... As humanizmi i periudhës së pas renesansës nuk ka arritur ndonjëherë ta ngrisë njeriun kaq lartë. Ata që e besojnë Islamin si fe dhe e pranojnë All-llahun si Zot të Gjithësive, e djinë se Krijuesi i Ademit, All-llahu iu drejtohet melekëve dhe ua prezenton njeriun si zëvendës të vetin. Kjo na tregon se virtyti i parë dhe më i madh i njeriut është, të qenurit zëvendës i All-llahut mbi tokë. Prezentimit të njeriut melekët iu përgjigjën në këtë mënyrë para All-llahut: "... **A do të vëshë në te atë që bënë çrregullime dhe që derdh gjaqet,...**" (Bekare: 30). Ana simbolike e kriterit ia fillon këtu. Shifni se çfarë të vërtetash ka për njeriun pas këtyre simboleve...

All-llahu dëshiron të krijojë një zëvendës për vete mbi sipërfaqen e tokës. Për të bërë një punë të tillë, mund të pritët që ai t'i përdorë materiet më të shenjta dhe më të vlefshme. Mirëpo Ai e zgjedhë materien më të pavlefshme. Në tre vende në Kur'an përmendet se nga cilat materie është i krijuar njeriu. Në njërin thuhet: **Ai e krijoi njeriun nga balta e terur si (enë balte) e pjekur.** (Rahman: 14). Më pastaj thuhet: **"Ne krijuam njeriun nga balta e argjilit, të zi e të prishur (me erë të keqe)."** (Hixhr: 26). Dhe në fund përdoret shprehja **"tin"** (En'am: 2, Mu'minun: 12), që në përkthim dotëthotë baltë. Kështu All-llahu e ka krijuar nga balta zëvendësin e Tij shumë të vlefshëm, e pastaj i ka fryer nga shpirti i vet. Kështu është krijuar njeriu.

Në gjuhën e njerëzve simboli më i poshtër i të keqes dhe i banalitetit është balta. Në natyrë nuk ka ndonjë ndonjë krijesë më të poshtër se balta. Në anën tjetër po në të njëjtën gjuhë,

pra në gjuhën njerëzore, Zoti është Qenia më e ngritur dhe më e shenjtë. Kurse vetia më e shenjtë, më e ngritur dhe më origjinale e çdo qenieje është shpirti që e posedon. Kështu përfitohet njeriu si një krijesë dydimensionale e përbërë nga kombinimi i baltës dhe i shpirtit hyjnor; kjo njeriu e bën të dallohet nga krijesat njëdimensionale që dotëthotë se është krijesë me dy natyra. Njëra veti vazhdimisht i prinë lloçit, poshtërisë, kalbësisë dhe stagnimit. Pas vërshimit çdo herë vërehet të ketë ngelur grumbull i vdekur i baltës. Njëra veti, apo natyrë e njeriut prinë kah vdekshmëria e këtij grumbulli. Mirëpo vetia tjetër e tij e cila vjen nga shpirti hyjnor e bën që njeriu të prijë kah më e larta, kah maja më e lartë që mund të paramendohet, pra të prijë kah All-llahu.

Nga kjo kuptojmë se njeriu është krijuar nga elemente që janë opozitare ndaj njëra tjetrës. Balta dhe shpirti. Dominanca dhe rëndësia e tij rrjedhë nga krijimi i tij dydimensional. Largësia mes këtyre dy dimensioneve është largësia mes baltës dhe shpirtit hyjnor që i është fryer. Këto dy dimensione iu janë dhuruar të gjithë njerëzve dhe natyra e uljes poshtë kah lloçi apo e ngritjes lartë kah hyjnoreja, është punë të cilën njeriu vet mund ta dijë. Konfrontimi mes këtyre dy poleve në ekzistencën e brendisë së thellë të njeriut, vazhdon deri atëherë kur të bëhet përcaktimi i vendosur.

Pasi që u krijua njeriu, All-llahu ia mësoi emrat. Çfarë do të thotë mësimi i emrave? Kjo ende nuk dihet. Çdo kush jep ndonjë koment. Çdo komentues e mbron komentin e vet sikur me qenë i drejtë. Çdo kush bën sqarime sipas mendimit dhe qëndrimit të vet. Pa marrë parasysh se çfarë sqarimi ka mbi këtë çështje, pa dyshim se ajeti kur'anor është përqëndruar në të mësuarit... Pasi që mbaroi krijimi i njeriut, All-llahu ia mësoi emrat zëvendësit. Kështu ai arriti të i dijë emrat. Pasi që ndodhi kjo iu drejtuan All-llahut me këto fjalë: *“...më krijove mua nga zjarri, e atë e krijove nga balta!”*, *“Pse e ngritë atë më shumë se ne?”* All-llahu u përgjigj: *“Unë di atë që ju nuk dini!”*, më pastaj kështu iu urdhëroi melekëve: *“përluni (bini në sexhde) Ademit”* Ky është humanzimi i vërtetë. Shifni se në çfarë pozite gjendet njeriu dhe shifni se sa e madhe është vlera e tij. Aq është e madhe vlera e njeriut sa që melekët e krijuara nga zjarri edhe pse në fakt janë më të ngritura se njeriu i cili është krijuar nga balta, urdhërohen t'i përlulen Ademit a.s. All-llahu i teston dhe ua pyet emrat e sendeve. Emrat që ata nuk i dijnë, i din Ademit a.s. Kështu virtyti (virtyti i tij mbështetet në të diturit e emrave) i Ademit arrinë të bie në pah shumë qartë. Përlulja e melekëve para Ademit a.s., është sqarues i madh i nocionit njeri në Islam. Njeriu i din disa gjëra të caktuara që nuk i dijnë melekët. Kjo është ajo që njeriu përskaj të epërsisë më të madhe të melekëve në fillim, e bën të jetë më i ngritur se melekët. Me fjalë tjera, epërsia e njeriut nuk rrjedhë nga origjina e tij, por nga dituria e tij.

Një pikë tjetër që duhet potencuar (së paku siç përmendet në disa përkthime nga arabishtja) është çështja e krijimit të gruas nga eshtra e brinjës së shtrembërt të burrit.⁶ Përdorimi i shprehjes “eshtra e brinjës” është gabim që rrjedhë nga përkthimi. Kuptimi origjinal i kësaj shprehjeje në arabisht dhe në hebraisht është “natyrë, temperament, strukturë.” Atëherë nga kjo mund të konkludojmë se Hava, pra gruaja është me natyrë të njëjtë me burrin, domethënë se i takojnë të njëjtës esencë. Një njeri i madh siç është Nietzsche ka thënë se gruaja dhe burri janë dy krijesa që dallojnë në tërësi nga njëri-tjetri. Mirëpo, kuptohet sipas tij, përshkak se kanë jetuar bashkë, kanë lindur disa ngjashmëri mes tyre. Sipas tij, të parët e gruas dhe të burrit dallojnë nga njëri-tjetri. Pothuajse të gjithë shkencëtarët dhe filozofët edhe pse e pranojnë se gruaja dhe burri kanë të njëjtën origjinë, nuk ngecin prapa në minimizimin e natyrës së gruas, për ta

⁶ Krijimi i Havës nuk është përmendur drejtpërdrejtë në Kur'an. Ka gjasa të mëdha që shkrimtari të është bazuar në “Kisas-i Enbija” të Kisait (Kisas-i Enbija, Kairo, 1312, fq. 12).

ngritur lartë natyrën e burrit. Kundrejt kësaj, në Kur'an kështu thuhet: **“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqën) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra...”** (Nisa: 1) Një pikë tjetër e rëndësishme që ka të bëjë me krijimin e njeriut është “amaneti” të cilin All-llahu duke i tubuar të gjitha krijesat me shpirtë dhe pa shpirtë, të gjitha objektet, bimët, kafshët, ua propozoi që ta pranojnë këtë amanet, mirëpo përpos njeriut, asnjëra nga këto krijesa nuk iu afrua amanetit. Kjo bëri që njeriu të përfitojë edhe një virtyt: Njeriu pati guximin ta merr mbi vete amanetin që askush nuk mundi ta merr. Ai përpos asaj se u bë zëvendës i All-llahut mbi sipërfaqen e tokës, e pranoi edhe amanetin e Tij. Tani parashtrohet pyetja se çfarë domethënie ka “amaneti”? Çdo kush thotë gjëra të ndryshme lidhur me këtë temë. Sipas Mevlana Xhelaledinit amaneti është vullneti i njeriut... vullneti i lirë. Edhe sipas meje ashtu është.

Njeriu me vullnetin e lirë që e posedon është ngritur mbi të gjitha krijesat në sipërfaqen e tokës. Vetëm ai me vullnetin e lirë që e posedon mund të veprojë kundër instikteve; kjo e bën të dallojë nga kafshët dhe nga bimët të cilat mund të veprojnë vetëm sipas instikteve. Për shembull asnjëherë nuk mund të hasni në ndonjë kafshë e cila me vetëdëshirë agjëron dy ditë, apo në ndonjë bimë e cila nga pikëllimi i madh bën vetëvrasje. Kafshët dhe bimët as nuk mund të bëjnë ndonjë të mirë të madhe, e as nuk mund të bëjnë ndonjë të keqe të madhe. Ato nuk janë në gjendje të veprojnë kundër asaj për çka janë të krijuara. Vetëm njeriu mund t'i kundërvihet asaj se përse është krijuar; vetëm njeriu mund t'iu kundërshtohet nevojave trupore dhe shpirtërore, me vetëdëshirë mund të devijojë nga rruga e të mirës dhe e virtytit. Është i lirë në të qenurit i mirë apo i keq, apo në të pririt kah balta ose kah hyjnoreja. Kjo na tregon se pasuria më e madhe e njeriut është vullneti. Kjo me të vërtetë mund të kuptohet nga marrëdhëniet mes All-llahut dhe njeriut. All-llahu me vullnetin e Tij absolut i ka fryer njeriut nga shpirti i Tij. Edhe njeriu është i lirë deri në një shkallë. Ai brenda kufijve të lirisë që ia ka përcaktuar All-llahu, mund të veprojë kundër ligjeve të konstruktit të vet psikik. Ky vullnet i lirë është shkak i marrëdhënieve mes All-llahut dhe njeriut; kjo është liria e të bërit mirë ose keq apo e të uljes së kokës ose e të shprehurit të revoltit.

Lidhur me krijimin e njeriut, nga Islami mund t'i nxjerrim këto përfundime:

Të gjithë njerëzit përveç se janë të barabartë, janë edhe vëllezër. Është tejet i qartë dallimi mes barazisë dhe vëllazërisë. Përderisa vëllazëria është nocion ligjor, nocioni vëllazëri e shprehë natyrën dhe temperamentin e njëjtë. Pa marrë parasysh se çfarë ngjyre të lëkurës kanë, të gjithë njerëzit janë të njëjtës origjinë.

E dyta, burri dhe gruaja janë të barabartë. Në kundërshtim me të gjitha filozofitë e botës antike, burri dhe gruaja janë krijuar nga e njëjta gjë, nga i njëjti Krijues. I takojnë të njëjtës origjinë, janë vëllezër (vërejtja jonë: vëlla e motër), janë të të njëjtëve prindër.

E treta, shkak i epërsisë së njeriut ndaj melekëve dhe ndaj të gjitha krijesave tjera është dituria. Për shkak se njeriu i ka mësuar emrat e sendeve melekët (edhe pse i takojnë origjinës më të ngritur) iu janë përrulur.

Më e rëndësishmeja nga të gjitha, njeriu për shkak të vullnetit të lirë ka të drejtë zgjedhjeje mes dy poleve, mes baltës dhe hyjnores. Dhe prap, për shkak të vullnetit të lirë mban përgjegjësi për veprat e kryera. Sipas Islamit njeriu është krijesa e vetme e cila jo vetëm që merret në përgjegjësi për fatin e vet, ai merret në përgjegjësi edhe për amanetin hyjnor i cili iu është dhënë. Ai është bartës i amanetit të All-llahut në tokë dhe në natyrë. Ai është që i mësoi emrat e sendeve dhe sipas meje me “emra” nënkuptohet të vërtetat shkencore. Meqë emri i një sendi është simboli i atij sendi, është forma definuese dhe konceptuale. Prandaj me fjalën “mësimi i emrave të sendeve” nga All-

llahu, duhet kuptuar si dhuratë aftësimi që iu është dhënë njeriut për t'i perceptuar dhe konceptuar të vërtetat shkencore të kësaj bote. Kur All-llahu ia mësoi këto gjëra njeriut, ai arriti ta gjejë rrugën e drejtë në sipëfaqen e tokës. Gjetja e rrugës së drejtë e ngarkoi njeriun me përgjegjësinë e dytë. Njeriu fatin e vet duhet ta formatizojë me duart e veta. Edhe shoqëria njerëzore por edhe individi është përgjegjës për fatin e vet: “... *atij i takoi ajo që fitoi, e juve u takon ajo që fituat,...*” (Bekare: 134)

Civilizimet e së kaluarës nuk kanë as ma tepër e as më pak nga ajo që e kanë përgatitur vet me duart e veta. Edhe fati i juaj do të jetë i njëjtë me të atyre të së kaluarës, pra nuk do të jetë as më pak e as më shumë nga ajo që përgatisni. Ky është shkaku që njeriu për shkak të vullnetit të lirë që e posedon të ketë përgjegjësi të madhe ndaj All-llahut.

Kur jemi këtu të flasim për një vëzhgim: Historia ka qenë dëshmitare e një tragjedie të madhe. E ajo është mosnjohja e njeriut si krijesë dydimensionale. Për dallim nga “fetë” tjera të cilat thonë se çdo herë në natyrë ekzistojnë dy fuqi që luftojnë njëra kundër tjetrës, të përfaqësuara me Zotin dhe Iblisin, Islami na mëson se ekziston vetëm një fuqi që është dominuese në gjithësi e ajo fuqi është All-llahu. Mirëpo, djalli lufton brenda në njeriun kundër All-llahut. Njeriu është fushëbeteja. Dualizmi i Islamit nuk është në natyrë por brenda në njeriun. Në natyrë vetëm një princip është valid, e ai është përulja para All-llahut. Në Islami djalli nuk është konkurent i All-llahut, por i njeriut, apo më mirë të themi konkurent i prirjes së njeriut kah hyjnoreja. Për arsye se njeriu është krijesë dydimensionale e krijuar nga balta dhe nga shpirti, ndien nevojë për të dyjat. Feja apo ideologjia në të cilën do të besojë dhe do ta themelojë jetën, duhet të jetë në gjendje t’iu përgjigjet këtyre dy vetive të tij. Tragjedia e shpjegimit të historisë qëndron në një tregim krejtësisht tjetër. Historia thotë se të gjitha civilizimet rrjedhin ose nga orientimi i tërësishtëm kah bota e ardhshme duke e harruar këtë botë; ose kah orientimi kah kjo botë duke e harruar botën e ardhshme. Civilizimi kinez siç mund të kuptohet nga jeta e aristokracisë kineze ka filluar duke u orientuar kah kjo botë, duke iu dhënë përparësi të mirave dhe bukurive të kësaj bote dhe duke i shfrytëzuar deri në maksimum ato. Më pastaj vjen Lao Ce i cili mendon vetëm për botën e ardhshme dhe e themelon “fenë” e cila aspak nuk flet për këtë botë, por vetëm për anën shpirtërore të botës së ardhshme. Aq shumë arrinë të ndikojë te kinezët që më parë nuk kanë menduar asgjë tjetër përpos të mirat e kësaj bote, sa që pjesa dërmuese e kinezëve ka filluar të jetojë jetë të izoluar. Më vonë paraqitet Konfucio i cili përsëri i kthen kinezët në këtë botë, i kthen në jetën ngazëlluese të kësaj bote.

Me mësimet e Vedasë dhe të Budës, vendi i maharaxhëve dhe i legjendave, India, është tërhequr në tërësi nga kjo botë për ta përqaftuar misticizmin, jetën e izoluar dhe dijetën. Prandaj sot India është vend i prapambetur dhe i njohur me njerëz që flejnë mbi gozhdë dhe që kalojnë dyzet ditë me një hurmë.

Për të qenë Roma e Vjetër dominues politik në botë, ka përdorur dhunën dhe ka bërë gjakderdhje në Azi dhe në Evropë që ta marrë pasurinë. Në anën tjetër, për ta bërë ditën ditë, kanë organizuar ndeshje mes gladiatorëve dhe zbavitje të ngashme me ta. Më vonë paraqitet Isa a.s., i cili ua tërheqë vërejtjen për botën e ardhshme. Ardhja e tij bëhet shkak që Roma t’ua kthejë shpinën zbavitjeve dhe ngazëllimeve të kësaj bote dhe të fillojë të mendojë për mundimet dhe për botën tjetër. Mesjeta është fundi i kësaj. Mesjeta në njërin anë është periudha e luftërave dhe e gjakderdhjeve; kurse në anën tjetër është periudha e manastireve dhe e asketizmit. Renesansa ishte ajo që e shpëtoi Evropën nga kjo gjendje dhe që e shtyu lavjerrësin të shkojë në anën tjetër. Civilizimi i Evropës së sotme aq shumë është civilizim tokësor, sa që si qëllim të vetëm të jetës së njeriut e sheh vetëm zbavitjen dhe argëtimin. Prof. Chandel thotë se njeriut bashkëkohor

tërë jeta i kalon duke i prodhuar mjetet që i përdorë. Dhe po ashtu thotë se idiotizmi i filozofisë bashkëkohore që e motivon njeriun, rrjedhë nga teknologjia e paqëllimtë. Civilizimi bashkëkohor aq është bërë i paqëllimtë, aq është bërë tokësor, sa që pothuajse ka ardhur në gjendje të presë një Isa të ri.

Qëndrimi i Islamit ndaj botës, na bën të kuptojmë se njeriu është krijesë dydimensionale e cila ka nevojë për fe e cila është dydimensionale (pra fe e cila mund të ndikojë në shpirtin e njeriut dhe në shoqërinë njerëzore që paraqesin dy dimensione të kundërta). Njeriu vetëm kështu mund ta gjejë barazpeshën, që quhet Islam.

Për ta kuptuar një fe, duhet shikuar të kuptuarit e Zotit, librin e saj, peygamberin dhe njerëzit shembullor që janë edukuar sipas asaj feje.

E para, All-llahu nuk është i paineres për shoqëritë njerëzore dhe për botën. Ai është Ndëshkues, i Gjithëfuqishëm, Mposhtës, i Madhërishtëm... Në të njëjtën kohë Ai është edhe i Gjithëmëshirshëm, Mëshirëplotë, Falës.

Libri i Islamit Kur'ani, sikurse Tevratit (i pafalsifikuar) i sqaron çështjet shoqërore, politike dhe ushtarake, madje na sqaron edhe si duhet luftuar dhe si duhet robëruar dhe liruar robërit. Pra, domethënë se drejtpërdrejtë merret me çështjet e kësaj bote. Mirëpo po në të njëjtën kohë merret edhe me pastrimin dhe edukimin e shpirtit, si dhe me zhvillimin e individit në aspektin moral.

Te Peygamberi i Islamit, apo te ndonjë njeri tjetër, mund të vërehen dy cilësi që mund të duken sikur me qenë në kundërshtim mes vete, mirëpo që janë të bashkuara në harmoni mes vete: Ai ishte një person që vazhdimisht ishte në luftë politike kundër armiqëve dhe kundër të gjithë elementeve destruktive të shoqërisë; ai ishte një person që në këtë botë interesohej të themelojë një shoqëri dhe një civilizim të ri; mirëpo ai ishte person që për primare e kishte të qenurit rob i All-llahut dhe ruajtjen nga bërja e mëkateve për shkak të frikës ndaj All-llahut.

E treta, njerëzit e edukuar sipas Islamit janë shembulli më i mirë i njerëzve dydimensional. Ata janë marrur edhe me politikë edhe me luftëra, janë orvatur për botë më të mirë, çdo herë kanë prezentuar në bisedat shkencore dhe konsultative (shumë më tepër se asketët dhe mistikët e mëdhenj të lindjes dhe të perëndimit), janë falur dhe janë ruajtur nga mëkatet. Ebu Zerri r.a., ka qenë njeri i politikës dhe i ibadetit. Mednimet e thella të tij janë, me vlerë shumë të madhe në të kuptuarit të Kur'anit. Merrni dhe shikojini të gjithë shokët e Peygamberit [sal-lallahu alejhi ve selem]: Të gjithë janë njerëz që për së afërmi janë interesuar për përparimin e shoqërisë, të gjithë në duar kanë mbajtur shpata, të gjithë kanë qenë të drejtë, të mëshirshëm, të dhimbshëm dhe mendimtar. Si përfundim i tërë kësaj dua ta them edhe këtë: Njeriu në Islam është krijesa që e bartë amanetin e All-llahut. Ndien kënaqësi nga të qenurit afër All-llahut. All-llahu ia ka mësuar emrat. Ai ka arritur të shoh se të gjithë melekët iu janë përlurur. Kështu njeriu dydimensional që e bartë këtë përgjegjësi të madhe, ndien nevojë për një fe e cila nuk do ta lë anash asnjërin nga dimensionet, pra ndien nevojë për një fe që do t'i krijojë barazpeshë mes kësaj bote dhe botës së ardhshme. Vetëm një fe e këtille mund të krijojë kushte për t'i zbatuar të gjitha kushtet.

BOTËKUPTIMI MONOTEIST

Sipas meje ekziston monoteizëm. Dhe pa dyshim se të gjithë monoteistët e pranojnë monoteizmin si bashkim të Zotit. Mirëpo, sipas botëkuptimit tim, unë monoteizmin e kuptoj si njësim i tërë gjithësisë, kësaj bote, botës tjetër, natyrës, të mbinatyrshmes, materies, spirituales, shpirtit, trupit. Të gjitha këto i pranoj pa bërë ndasi mes tyre, pra si njësim. Kjo është sikur e tërë ekzistuesja të jetë me një formë të vetmen; të jetë si një organizëm i gjallë dhe i vetëdijshëm me vullnet, me mendje dhe me qëllim të caktuar. Shumë njerëz besojnë në qëndrimin e filozofisë fetare i cili thotë: “Zoti është një, nuk është më tepër se një”. Kuptimi i këtij qëndrimi nuk mund të jetë asgjë tjetër, përpos qëndrim monoteist. Ndërsa unë monoteizmin e pranoj si botëkuptim. Besoj se edhe Islami e pranon ashtu. Edhe shirkun njëjtë e shikoj. Edhe ai është një botëkuptim i cili gjithësinë e shikon si me qenë konfuze, kontradiktore, e llojlojshme, që bie në konflikt mes vete, që është opozitë e njëra-tjetrës, me pole që ndeshen mes vete, me tendencë, me tradita, me qëllime, me vullnete që e përbëjnë një turmë me disharmoni të madhe.

Edhe botëkuptimi im është i mbledhur në pika të ndryshme të materializmit dhe të natyralizmit. Unë botën e shoh si një krijesë të gjallë me qëllim, me ideal, me vullnet dhe me vetëdijë që iu është dhuruar. Prandaj Ekzistencën (Mevxhudatin) e shoh si një gjallesë me një rend të vetëm që është i harmonizuar, pikërisht si një njeri shumë i madh me aftësi të rrethuarit që iu është dhuruar jeta, vullneti, ndjenjat, qëllimi... po ashtu edhe njeriu i gjanë botës; mirëpo botës së vogël, botës që është nominale, botës me mangësi... Me fjalë tjera, nëse e marrim një njeri që iu është dhuruar vetëdija, qëllimi dhe aftësia krijuese, pra një njeri që nga çdo aspekt do të llogaritej si me qenë shembull i mirë, e pastaj nëse e rrisim, përpara nesh do të del një botë.

Marrëdhëniet e njeriut me Zotin, e natyrës me të mbinatyrshmen, e natyrës me Zotin (të gjithë këto terme patjetër i kam me i përdorur), janë sikur marrëdhëniet e flakës së llambës me llambën. Këto marrëdhënie i ngjajnë marrëdhënieve të organit me njeriut që ekziston në vetëdijen e tij: Njeriu nuk është ndaras dhe nuk është i huaj për të.⁷ Ja pra ky është shkaku që unë nuk besoj në panteizëm, në trinitet, apo në dualitet, por në tevhid – domethënë në monoteizëm.

Monoteizmi e përfaqëson botëkuptimin e veçantë që tregon se është njësim universal i Ekzistencës. Sipas këtij botëkuptimi monoteist, ekzistenca i ka dy anë nominale: Të padukshmen dhe të dukshmen. Përdorimi i këtyre dy frazave mund të kuptohet si “perceptim” dhe “tej-perceptim” (ose nëse thuhet më konkretisht si “mbikëqyrje dhe eksperiment”). Ky është një klasifikim nominal që është bërë sipas mjeteve të kuptuarit të njeriut; ky klasifikim nuk nënkupton dualizëm apo ndarje në dy pjesë.

Në fakt kjo ndarje nuk është ndarje ontologjike, por ndarje epistemologjike, e cila në të njëjtën kohë është mëvetësuar dhe praktikohet nga shkenca. Materialistët besojnë se thelbi i botës fizike është materia; ata e mbrojnë tezën se energjia është forma e ndryshuar dhe derivat i materies. Në anën tjetër energjistët e thonë të kundërtën e asaj që e thonë materialistët; ata thonë se themeli i përjetshëm i botës fizike është energjia; këta e mbrojnë tezën se materia nuk është asgjë tjetër përpos energji që e ka ndryshuar formën apo se është energji e dendur. Ajnshtajni thotë se të dy palët gënjejnë; ai duke u bazuar në një eksperiment që e ka bërë në një dhomë të errësuar, thotë se në thelbin e ekzistencës nuk qëndron as energjia e as materia. Këto dy gjëra, ndonjëherë në formë të

7

energjisë, ndonjëherë në formë të materies, i ndërrojnë vendet sikurse me qenë duke e argumentuar thelbin e një gjëje të dukshme apo të padukshme e që është e ndryshueshme. Të vetmën gjë që mund ta bëjë fizicienti është analizimi tej-perceptues i këtyre dy dukurive të një krijese.

Sipas botëkuptimit monoteist, natyra (bota që duket) është krijuar nga bashkimi i shenjave (ajeteve) dhe i serialeve rregullative (suneneve-sunneteve). Është tejet e kuptimshme përdorimi i fjalës shenjë (ajet) për ndodhitë në natyrë. Oqeanet, lisat, dita, nata, bota, dielli, tërmeti, vdekja, sëmundjet, ndjekja e ndërsjelltë e natës dhe e ditës, ligjet e natyrës, madje edhe vet njeriu... të gjitha këto janë shenja. Në shenjë ekzistojnë “dukja” dhe “përcaktimi”. Kjo e ka të njëjtin kuptim me nocionin “fenomen” i cili sot nuk përdoret vetëm në fizikë apo në shkencat tjera që merren me hulumtimin e objekteve të ndryshme. Fenomeni në persisht përkthehet si pedid ose pedidar, kurse në arabisht, *zâhir*.⁸ Fenomenologjia në kuptimin më të gjërë, referohet në të pranuarit se themeli dhe thelbi i të vërtetës absolute qëndron përtej aftësisë sonë së konceptuarit. Njohuritë që i përfitojnë nga eksperimentimet, nga rezonimet dhe nga intuita janë “dukje”; pra nuk janë vetë ekzistenca. Njohuritë tona iu takojnë “dukurive” që perceptohen, që nuk mund të shihen dhe tej-perceptueses së lëvorës së vërtetës themelore. Fizika, kimia dhe psikologjia mund ta ‘analizojnë, zgjidhin dhe dijnë’ vetëm thelbin e vërtetë të pamjes së jashtme të materies dhe të spirituales dhe të asaj që mund të perceptohet. Shkurt thënë, shkenca mund të merret vetëm me shenjat dhe simptomet e ekzistencës, ngase natyra që mund të perceptohet është përzierje e këtyre shenjave dhe simptomeve.

Libri i vetëm nga të gjitha librat fetare, shkencore dhe filozofike që objektet në natyrë, ndodhitë dhe rrjedhat i emërton me emrin “shenja” është Kur'ani. Kuptohet sikurse në panteizmin lindor, ashtu edhe në misticizmin islam bota materiale i përngjajhet fluskave të dhe valëve të vogla e të deformuara të oqeanit të pafundt dhe të pangjyrë. Idealizmi dhe disa filozofi tjera morale dhe fetare botën materiale e shohin si me qenë në kundërshtim me Zotin dhe njeriun dhe si grumbull i objekteve tejet të pavlefshme. Mirëpo, Kur'ani “shenjave” iu jep vlerë pozitive dhe shkencore; ai ato nuk i shikon si me qenë shqetësime apo si perde që e mbulojnë të vërtetën. Por përkundrazi, ato i shikon si simbole që e simbolizojnë të vërtetën. Për të arritur deri te e vërteta, assesi nuk duhet kaluar rreth tyre sikurse nuk jemi duke i parë, por duhet pasur qëndrime serioze dhe shkencore të cilat mund t'i sqarojnë të njëjtat. Vlerësimi i “shenjave” apo i fenomeneve në këtë mënyrë më shumë i ngjanë qëndrimit bashkëkohor shkencor, se sa misticizmit antik. Çështja nuk është çështje e njësimi të ekzistencës (Vahdet-i Vuxhud) të sufistëve; çështja është çështje shkencore dhe zgjidhëse e njëshmërisë së ekzistencës (Tevhid-i Vuxhud). Sipas monoteizmit nuk mund të pranohen kundërshtimet dhe tepricat as në histori, as në shoqëri, madje as te njeriu. Pra monoteizmin duhet komentuar si bashkim të natyrës me të mbinatyrshmën, i njeriut me natyrën dhe si bashkim i njeriut me njeriun.

Ai na sqaron se të gjitha këto bashkarisht, krijojnë një sistem të vetëdijshëm, të gjallë dhe të harmonizuar. Edhe më herët patëm thënë se përbërja thelbësore e monoteizmit nuk e pranon kontradiktën dhe disharmoninë në botë. Kjo është arsyeja që sipas botëkuptimit monoteist nuk pranohen kontradiktat: Domethënë se nuk mund të bëhet fjalë për kontradikta mes njeriut dhe natyrës, mes shpirtit dhe trupit, mes kësaj bote dhe botës së ardhshme, mes materies dhe spirituales. Monoteizmi nuk i pranon as

⁸. Pedid, pedidar: që duket, i qartë, që dallohet.

kontradiktat ligjore, shoqërore, racore, nacionale, rajonale, gjenetike, madje edhe ekonomike. Ai tërë njerëzimin e parasheh të bashkuar.

Mes natyrës dhe të mbinatyrshmes, mes materies dhe spirituales, mes kësaj bote dhe botës tjetër, mes të dukshmes dhe të fshehtës, mes shpirtit dhe trupit, mes mendjes dhe zbulimit, mes fesë dhe shkencës, mes metafizikës dhe natyrës, mes punës për hirë të All-llahut dhe të punës për njerëz, mes politikës dhe fesë, mes logjikës dhe dashurisë, mes bukës dhe lutjes, mes jetës dhe të përjetshmës, mes pronarit të tokave (agës) dhe fshatarit, mes udhëheqësit dhe të udhëhequrit, mes të ziut dhe të bardhit, mes të ngriturit dhe plebesë, mes klerit dhe grupit, mes të lindjes dhe të perëndimit, mes të mirës dhe të keqes, mes dritës dhe territ, mes grekut dhe barbarit, mes arabit dhe axhemit, mes kapitalistit dhe proletarit, mes të zgjedhurit dhe plebehut, mes të shkolluarit dhe të pashkolluarit... të gjitha këto kontraditka mund të përputhen vetëm sipas qëndrimit paganist (politesist-mushrik), sipas dualizmit apo sipas besimit të trinitetit, assesi sipas monoteizmit! Ky është shkaku që qëndrimi paganist duke bërë ndasi klasore dhe racore brenda shoqërisë, çdo herë e ka mbjellur farën e shirkut. Të besuarit në më shumë se një krijues e bën të mundur besimin në shumë krijesa dhe në shikimin e besimit të atillë si me qenë i drejtë.⁹ Po ashtu kontradiktat mes hyjnorëve e lëhtësojnë të llogariturit e kontradiktës mes “natyrës dhe hyjnores” si shkak i kontradiktës mes njerëzve. Në anën tjetër monoteizmi i cili e refuzon çdo lloj të shirkut, të gjitha rrjedhat, fenomenet dhe pjesët e ekzistenciales i shikon si me qenë në përputhshmëri të plotë që ecin në drejtim të një qëllimi. Ajo që nuk ecë në drejtim të këtij qëllimi, çfarëdo që të jetë nuk e meriton të definohet ekzistimi i saj.

Një përfundim tjetër i qëndrimit monoteist është rrefuzimi i çfarëdo lidhjeje të njeriut me ndonjë forcë shoqërore dhe lidhja e tij, pra e njeriut me të gjitha dimensionet poseduese vetëm për vetëdijen dhe vullnetin që dominon mbi ekzistencën... Burimi i shpresës, i qëllimit dhe i besimit të njeriut qëndron vetëm në një pikë qendrore; ajo pikë është boshti për të cilin është lidhur çdo lëvizje e gjithësisë. E tërë ekzistenca sillet rreth rrethit. Burimi i ekzistencës është qendra e rrethit. Ajo është vetëdija dhe vullneti i vetëm. Është fuqia e vetme në tërë gjithësinë. Gjendja e njeriut në këtë botë, është shndërrimi i kësaj të vërtete në formë të kapshme. Nëse thuhet pak më qartë, kjo është pikërisht sikurse rrotullimi rreth Qabes...

Sipas qëndrimit monoteist, njeriu frikohet vetëm pre një Fuqie. Vetëm para të Urtit jep përgjigje. Vetëm kah një kible drejtohet; vetëm prej një burimi pret diçka. Gjithçka që është në kundërshtim me këtë është gabim dhe e kotë. Nëse i drejtohet, nëse shpreson, nëse frikohet dhe nëse pret diçka nga ajo që është në kundërshtim me këtë është e kotë. Monoteizmi njeriut i dhuron liri dhe dinjitet. Ai nga njeriu kërkon që të bëhet vetëm rob i Atij, që nga njeriu kërkon ta ngrisë lart zërin kundër çdo fuqie të gënjeshme, kërkon të menjanohen të gjitha elementet e turpshme dhe të babëzisë.

⁹ Në fetë politeiste shprehja “krijues” nuk e ka kuptimin e “Zotit” apo të “All-llahut”. Disa prej zotërave janë ese i një “Krijuesi” tjetër; për këta mendohet se kanë të drejtë mbi një “lloj” apo mbi një “pjesë” të jetës së njeriut. Prandaj çdo njeri prej tyre i përulet një klasë apo racë njerëzish. Kjo “shumicë” bëhet shkak i “shirkut” mes njerëzve.

HISTORIA E FILOZOFISË: KABILI DHE HABILIT

Sipas Islamit, historia e filozofisë është krijuar mbi një determinizëm historik të përcaktuar. Historia është sikurse njeriu, është zinxhir i ndodhive të pandërprera të konfrontimeve dialektike pas krijimit dhe përhapjes së saj në ambient dhe në kohë, zinxhirë ku dy polet e armiqësuar dhe të konfrontuara vazhdimisht luftojnë mes vete. Historia është lëvizja e njeriut e cila mund të shihet si gjurmë në rrugë të cilën e ka regjistruar koha. Njeriu në llojin e vet është përfaqësuesi më i mrekullueshëm i “ekzistencës”, është një “gjithësi e vogël” që e “demonstron” më së miri të krijuarën. Në të natyra e arrinë vetëdijën vet dhe bashkë me të, ecë drejt të mrekullueshmës. – Natyrë e gjallë, e vetëdijshme, e zgjuar – Me fjalë tjera, njeriu në tërë ekzistencën është demonstrim i vullnetit dhe i vetëdijes absolute. Dhe sipas antropologjisë, njeriu është zëvendës i All-llahut mbi sipërfaqen e tokës. Ky është shkaku që historia e cila e përmban paraqitjen dhe përbërjen e esencës së njeriut të mos mundë të jetë diçka që i formatizon ndodhitë pjekallarthi, rastësisht, banalisht, pa qëllim, pa cak, apo pa kuptim. Historia pa dyshim se është e vërtetë sikurse të vërtetat tjera të kësaj bote. Fillimin e ka në një pikë të caktuar dhe është e patjetërsueshme që edhe mbarimin ta ketë në një pikë të caktuar. Duhet të ketë qëllim dhe kahje. Edhe ajo sikurse njeriu, fillin e ka me fillimin e kontradiktave. Gjatë diskutimit të antropologjisë patëm thënë se njeriu është nga balta dhe nga shpirti hyjnor dhe se kjo qartë mund të shihet nga kriteri Adem. Po në të njëjtën kohë, ky kriter në kuptimin filozofik dhe të vërtetë të fjalës është edhe rrëfimi për njeriun. Njeriu brenda në vete fillimin e ka në konfrontimin mes baltës dhe shpirtit, mes Zotit dhe djallit. Pika fillestare është konfrontimi mes Habilit dhe Kabilit. Ky është fillimi i vërtetë i historisë.

Të dy djemt e Ademit a.s., ishin njerëz, ishin persona, ishin të natyrshëm; mirëpo ishin të konfrontuar. Njëri e vrau tjetrin dhe filloi historia. Përpyekja e Ademit a.s., ishte përpyekje e brendshme në vete, ishte përpyekje subjektive (ose në përgjithësi përpyekje e tërë njerëzimit). Ndërsa përpyekja mes dy shkollave, është përpyekje që është reflektuar në jetë, në botën e jashtme, është përpyekje objektive. Prandaj ashtu sikurse kriteri Ademi a.s., që llogaritet sikur me qenë burim i filozofisë; njëashtu edhe kriteri Habili dhe Kabili është burim i historisë së filozofisë. Përpyekja mes Habilit dhe Kabilit, gjatë tërë historisë është përpyekje e dy poleve të konfrontuara që ka ekzistuar në dialektikën historike. Prandaj edhe historia, sikurse njeriu, në vete përmban zhvillim dialektik. Kontradikta fillon me vrasjen e Habilit nga Kabili. Sipas meje, Habili e përfaqësonte sistemin ekonomik që referohej në çobani, pra sistem në të cilin ende nuk ekzistonte prona, domethënë se e përfaqësonte shoqërinë primitive. Ndërsa Kabili e përfaqësonte sistemin e pronës monopoliste dhe individuale. Kabili e vret Habin dhe kështu fillon përpyekja. Ja pra, historia është arenë lufte e kësaj përpyekjeje. Përfaqësuesi i ekonomisë që referohej në çobani, Habili, vritet nga pronari i tokës, Kabili; periudha e pronës së përbashkët të burimeve prodhuese – periudha e çobanisë, gjuetisë, peshkatarisë – ndjenja vëllezërore dhe besimi i vërtetë e gjejnë fundin e vet; vendin e kësaj periudhe e mer periudha e trillimive dhe periudha e mosngurrimit për të uzurpuar pasurinë private të dikujt tjetër. Kështu Habili eliminohet nga sipërfaqja dhe në arenën historike paraqitet Kabili i cili ende është duke qëndruar.

Gjërat që i shpjegova i nxjerri nga rasti kur Ademi a.s., nga bijt e vet kërkon që të sakrifikojnë diçka në emër të All-llahut për t'i tejkaluar problemet e papajtueshmërisë që ekzistojnë mes tyre. Kësaj thirrjeje Kabili i përgjigjet me një grusht drithi të

zverdhur, kurse Habili sjellë devenë më të mirë dhe më të bukur me qime të kuqe. Ky ishte shkaku që të parin ta konsideroj si përfaqësues të bujqësisë, kurse të dytin si përfaqësues të çobanisë. Historia na dëshmon se po në të njëjtën kohë edhe peshkataria edhe gjuetia e periudhës së çobanisë, kanë qenë burimi kryesor natyror (kriteri deve e simbolizon këtë). Pyjet, detërat, shkretëtirat dhe lumenjt... të gjitha burimet prodhuese janë nën urdhërin e fisit, ndërsa mjetet prodhuese në pjesë të madhe janë duart e njeriut. Madje nëse ndihet nevoja për ndonjë mjet tjetër, çdo kush mund ta bëjë mjetin e vet; ngase mjetet që përdoren janë tejet të thjeshta. Burimet prodhuese (uji dhe toka) ose mjetet prodhuese (lopët, parmenda etj.) nuk janë pronë monopoliste apo pronë individuale. Gjithçka në mënyrë të barabartë është në shërbim të çdokujt. Rregullat dhe shpirti i shoqërisë, nderi ndaj prindërve, zbatimi i përgjegjësive morale në mënyrë të drejtë, përputhshmëria absolute e rregullave të jetës kolektive, pastërtia e natyrshme dhe e brendshme e ndjenjave fetare... Këto ishin disa vlera shpirtërore të njeriut të këtij sistemi prodhues. Dhe Habilin mund ta pranojmë si përfaqësues i të gjitha këtyre gjërave.

Kur njeriu arriti ta mësojë bujqësinë, jeta dhe në përgjithësi rendi shoqëror në të cilin jetonte, i pësoi ndryshim thelbësor. Sipas meje ky ndryshim është revolucion i më i madh i historisë. Bashkë me këtë revolucion doli edhe njeriu i ri: Njeriu i fuqishëm dhe i keq... Kështu filloi periudha e dallimeve dhe e civilizimit.

Sistemi bujqësor i kufizoi burimet prodhuese në natyrë. U zbuluan mjete të zhvilluara prodhuese, bashkë me to lindën edhe marrëdhëniet konfuze të prodhimit. Për shkak se nuk mjaftonte që toka pjellore, pyjet dhe detërat të jipen lirshëm nën urdhërin e gjithsecilit, për herë të parë në histori lindi nevoja e paraqitjes së pronës private ku një pjesë e natyrës ndahet për vete, pjesë së cilës nuk ka të drejtë t'i afrohet askush.

Më parë në shoqërinë njerëzore nuk ekzistonte individ, ngase individ ishte vet fisi. Mirëpo me paraqitjen e bujqësisë u nda shoqëria që i ngjante një familjeje; u nda shoqëria në të cilën të gjithë jetonin si vëllezër. Kur u bë uzurpimi i një pjese të tokës e cila ishte pronë e përbashkët, kuptohet duke mos i marrë parasyshtë të tjerët që nuk marrin pjesë në këtë uzurpim, nuk kishte kurrfarë ligji, apo ndonjë rregull fetar ose trashëgues i cili do ta zgjidhte atë çështje. Çështja është zgjidhur me dhunë. Në periudhën e çobanisë, fuqia e anëtarëve të fortë të fisit, shërbente për ta mbrojtur në mënyrë efektive fisin, nderin e fisit; apo për ta mbrojtur gjuetinë dhe peshkatarinë. Mirëpo, tani kjo fuqi ka filluar të përdoret në përcaktimin e "të drejtave". Përcaktimin e masës së konsumimit privat dhe të përfitimit të pronës private, parimisht e bënte fuqia. Në këtë çast kur historia në shpinë e kishte të ngulitur thikën, teoria që ishte në kundërshtim të plotë me teorinë e Marksit ishte plotësisht e drejtë: Nuk është prona private ajo e cila e përcakton "Të fituarit e fuqisë"; por fuqia është ajo e cila e përcakton të fituarit e "pronës private". "Fuqia" dhe "përdorimi i dhunës" ishin ato që ia siguruan pronën private individit. Fuqia ia siguroi pronën private njeriut, ajo me kalimin e kohës arriti të futet në këllëf ligjor dhe të natyrshëm i cili me pastaj edhe më shumë e përforcoi vazhdimësinë e vet. Prona private e ndau shoqërinë unike në dy pjesë. Dhe në fund kur prona private u bë rregull, askush më nuk ngopej me atë që i mjaftonte. Tani më për çdo rast duhej vet njeriu ta përcaktonte kufirin e nevojave të veta. Kjo ishte arsyeja që njerëzit kishin filluar t'i gjejnë gjërat vetëm atëherë kur të donin, e jo atëherë kur ndienin nevojë për ta. Kurse në sistemin e Habilit (ose sistemin e pronës së përbashkët) njerëzit peshkonin peshqi vetëm aq sa kishin nevojë. Natyra e hapur dhe bujare ishte çdo herë e gatshme për t'iu dhënë atë që u nevojitej. Mundi harxhohej vetëm aq sa kishte nevojë për t'i kryer nevojat. Më i afti gjatë prodhimit fitonte më së shumti,

mirëpo edhe pse natyra ishte e hapur dhe bujare, edhe pse detërat dhe pyjet jepnin ushqim në sasi të mëdha, ato ditë kishin mbaruar, ngase njerëzit kishin filluar me ngarendë pas kafshatës së kufizuar që mund t'ua japë toka dhe bujqësia. Filluan ta ngulfatin njëri-tjetrin, ngase ishin bërë sylugat dhe ambicioz shumë të mëdhenj. Në këtë stil të ri të jetës shoqërore, shqiponjat dhe skifterët (në rastin e Habilit, sorra), ua këputën kthetrat shpendëve të dobët dhe i dëbuan nga vendi i tyre. Më parë shoqëria ishte sikurse shpendët shtegtarë, ajo shëtiste nëpër shkretëtira, rreth lumenjve, rreth bregut të oqeanit e kështu me rradhë. Mirëpo tani shpendët që kanë filluar të fluturojnë mbi kërmën që quhet pronë private, ia nxjerrin sytë njëri-tjetrit me sqepin monopolist. Familja njerëzore e cila më herët jetonte në liri, në paqe, në qetësi dhe në gjallëri, tani është ndarë në dy kampe duke zhvilluar luftë të pamëshirshme mes vete. Njëra anë ishte e përbërë nga pakica e cila ishte pronare e tokës më tepër se sa i nevojitej dhe që mundej ta përpunonte, kjo pakicë për shkak se nuk mundte ta përpunonte tokën, kishte nevojë për forcën punuese të të tjerëve; palën tjetër e përbënte shumica e uritur që nuk kishte tokë dhe mjete për të punuar. Dihej se fati i shumicës në rendin e ri shoqëror është robëria. Kjo klasë e re e dënuar me robëri, nuk kishte as tokë, as ujë, as nderë, as origjinë, as moral, as dinjitet, as mendime, as vërtetësi, as art, as arsim, as vlerë, as të drejtë, as shpirt e as kuptim. E tërë ajo që ndinin nevojë, ishte në duart e tjerëve. Klasa tjetër kishte krijuar monopol edhe mbi burimet prodhuese që nuk ishin materiale. Mundësia dhe kushtet për t'u marrur me arsim, kulturë, letërsi, shkencë dhe art, ishte vetëm në duart e atyre që nuk kishin nevojë të japin mundin e vet për të prodhuar diçka. Këto dy klasa më herët patën jetuar në shoqëri unike, atë kohë jetonin duke e ndarë të njëjtin shpirtë, të njëjtat ndjenja, të njëjtin nderë dhe të njëjtin nocion për dinjitet. Të gjithë së bashku shkonin në detë dhe në pyje për të peshkuar apo për të gjuajtur. Pasuritë natyrore ishin të të gjithëve, pikërisht sikurse ajri që e thithnin të gjithë. Mes vete ishin të barabartë dhe vëllezër. Të gjithë ishin bijtë e Ademit a.s., kurse ai ishte nga dheu. Ndërsa tani për shkak të kërmësë që quhet "pronë", janë bërë armiq të njëri-tjetrit. Lidhjet fafëfisnore janë zëvendësuar me zinxhirë të robërisë; barazia me pabarëzi; vëllezëria me armiqësi. "Feja" nuk ishte asgjë tjetër, përpos mjet mashtrimi për interesa materiale. Mëshira dhe pajtimi u zëvendësua me tirani, epsh, tashësi, krim, arrogancë, ndjenja dominimi, privilegjione, tolerancë ndaj të huajve, zhdukje të të dobëtit, mbyqje e të tjerëve për para, vrasje të vëllait, rrahje të prindërve, madje edhe me tentime për ta gënjyer Zotin.

Kështu nëse ambientet, klasat dhe preokupimet e këtyre dy tipave (tipi i Habilit i cili është njeri i besimit, paqes dhe i sakrificës dhe tipi i Kabilit i cili është njeri i arrogant dhe pasionist) i marrim dhe i analizojmë në aspektin shkencor dhe sociologjik duke u bazuar në psikologji, do të mundemi ta kuptojmë dallimin e madh mes këtyre dy nocioneve. E dijmë se e kanë pasur të njëjtën origjinë, baba, nënë, familje, mënyrë të edukuarit dhe fe. Shoqëria njerëzore nuk ka arritur të krijohet aq sa duhet në këtë mjedis të parë. Prandaj edhe jemi të mendimit se nuk ka arritur të krijohen qarqe ideologjike, kulturore apo shoqërore. Domethënë se shkak që këta dy vëllezër të jenë në këtë shkallë të armiqësuar mes vete nuk ka mundur të jetë ndikimi i elementeve të ndryshme fetare dhe edukative.

Edhe pse në fillim në çdo aspekt kanë qenë të njëjtë, paraqitja e dallimeve kontradiktore mes tyre dhe krahasimi i këtyre dy fenomeneve, kërkon përgatitjen e një liste në të cilën do të regjistrohen të gjitha elementet, shkaqet dhe kushtet që i kërkon aplikimi i metodave shkencore dhe logjike. Në këtë mënyrë do të arrijmë t'i kuptojmë edhe vetitë e përbashkëta edhe vetitë kontradiktore dhe të konfrontuara. Nga rrëfimi kuptojmë se

vetia e vetme që dallon mes këtyre vëllezërve është preokupimi me punë të ndryshme. Dallimi i punës me të cilën janë marrë, ka bërë që të dy vëllezërit të kenë pozita të ndryshme ekonomike, shoqërore, sisteme të ndryshme ekonomike dhe ka bërë që të konfrontohen mes vete.

Identifikimi i prerë i personalitetit të Habilit me psikologjinë klasore të periudhës së shoqërisë primitive, pra të periudhës së ekonomisë së çobanisë dhe të gjuetisë; dhe në anën tjetër identifikimi i personalitetit të Kabilit me njerëzit e klasifikuar të shoqërisë me cilësitë klasore (psikologjia e sistemit klasor), shumë qartë e mbështetë teorinë tonë. Komentuesit e Kur'anit dhe dijetarët tjerë, ajetet që e shpjegojnë vrasjen e Habilit nga Kabili, thonë se kanë zbritur për të treguar se duhet ndëshkuar të vrasurit e njeriut (krim). Sipas meje komentimi i këtillë i këtyre ajeteve është shumë i thjeshtë dhe sipërfaqësor. Edhe pse ndoshta teoria ime nuk është e drejtë, kuptimi dhe qëllimi i këtyre ajeteve nuk është aq i thjeshtë dhe i paqëllimtë sa edhe mendojnë ata që i përmendëm pak më parë. Fetë ibrahimiane (sidomos Islami), rastin në fjalë, e përmendin si rast të parë të rëndësishëm për njeriun në jetën e kësaj bote. Për mua nuk është shumë e besueshme ajo se thonë se qëllimi parimor ka qenë të tregohet nevoja e ndëshkimit të njeriut. Pa marrë parasysh se çfarë domethënie ngërthen në vete e tërë kjo, ne nuk duhet shikuar këtë ndodhi si rast i cili thotë se “është keq të vritet njeriu, prandaj ne duhet të qëndrojmë larg nga rastet e këtilla... Pas kësaj të kemi kujdes të mos vrasim, sidomos kur është fjala për vëllezërit tonë”.

Sipas meje, rasti i vrasjes së Habilit nga Kabili, është rasti më i rëndësishëm i cili e ka ndryshuar rrjedhën historike. Ky rast, i cili aludon në klasët e shoqërisë, sqarohet nga këndi shkencor dhe sociologjik. Ky rast e shpjegon mbarimin e rendit vëllazëror dhe të barazisë së shoqërisë primitive kur prodhimi përbëhej nga gjuetia dhe peshkataria dhe zëvendësimi i tij me prodhim bujqësor; gjithashtu ky rast e shpjegon edhe lindjen e pronës private, të shoqërisë klasore, të sistemit kolonialist dhe të privilegjuar; të përkuljes para pasurisë; të humbjes së besimit të vërtetë; të armiqësisë, të ambicjes, të babëzisë, të plaçkitjes, të robërisë, të vrasjes së vëllait (që përmendet për Kabilin). Vdekja e Habilit dhe mbetja gjallë e shëndoshë e Kabilit, janë të vërteta objektive historike. Analiza e vërtetë dhe kritike, tregon se qysh nga ajo periudhë çdo herë fati i “fesë”, jetës, ekonomisë dhe i njerëzve ka qenë në duart e Kabilit. Po ashtu e dijmë se Habili ka vdekur pa lënë ndonjë brez pas vete dhe se njerëzimi i sotëm është trashëgues i Kabilit. (Fjalën trashëgues këtu e kemi përdorur në kuptimin tipologjik, jo në kuptimin biologjik.) Shkaku i anarkisë ideologjike dhe shpirtërore dhe i destabilizimeve të vazhdueshme është universalizimi i qëndrimit të Kabilit lidhur me shoqërinë, udhëheqjen, “fenë” dhe me moralin.

Konfrontimi mes Kabilit dhe Habilit lindë për shkak të fejuarës së Habilit të cilën Kabili e pëlqenë më shumë se të fejuarën e vet. Ai vazhdimisht insistonte në të fejuarën e Habilit, prandaj kërkoi anulimin e fejesës të cilën e kishte aprovuar Ademi a.s. Të dy vëllezërit kishin shkuar te Ademi a.s., i cili iu kishte propozuar të sakrifikojnë diçka në emër të Zotit. Iu kishte thënë se kurban i atij që do të pranohet do të ketë të drejtë të zgjedhë se me cilën do të martohet, kurse tjetri, pra ai të cilit nuk do t'i pranohet kurban do të pajtohet me rezultatin. Kabili ishte munduar të bëjë dredhi, kishte sjellur një grusht drith të zverdhur, që natyrisht se nuk iu kishte pranuar si kurban. (Ua tërheqi vëmendjen se Kabili kur e ka parë të nevojshme është munduar të bëjë dredhi, madje edhe Zotin. Dhe të gjithë njerëzit e kalibrit apo të rendit të Kabilit veprojnë në të njëjtën mënyrë). Kur Zoti nuk ia pranoi kurbanin, Kabili përsëri duke përdorur dredhinë, zgjodhi të mos veprojë sipas gjykimit të Zotit, por sipas pasionit të vet dhe e vrau Habilin i cili nga ai

nuk kërkontë asgjë dhe i cili në e emër të Zotit e patë sakrifikuar pasurinë më të vlefshme, devenë me qime të kuqe të cilën edhe e kishte pranuar Zoti si kurban.

Pak para se të ndodhë vrasja e Habilit, mes tyre zhvillohet një bisedë tejet domethënëse. Fjala është për përgjigjën e Habilit, kur Kabili i kërcënohet se do ta vrasë. Përgjigja e Habilit: “Unë nuk do të ngrrej dorë kundër teje.”

Kështu shoqëria dhe rendi të cilën e përfaqëson Habili, pa kurrfarë rezistence ia lëshon vendin rendit agresiv dhe uzurpues të Kabilit.

Përderisa isha duke menduar për kriterin Habili dhe Kabili, në shikim të parë fillova të dyshoj se mos vallë çështja e seksualitetit është faktor dhe përcaktues më i madh se ekonomia.

Në këtë rast a nuk do të ishte në të drejtë frojdizimi? Ngase shkaku i konfrontimit, para së gjithash ishte “grua”. Vallë problemet e babait të tij a nuk kishin filluar me Havvanë? Mirëpo nëse mendojmë pak më shumë, do të shohim se gjërat nuk janë edhe aq të thjeshta ashtu siç na duken neve. Është fakt se shkaku i konfrontimit të parë mes vëllezërve ka qenë pëlqimi i të fejuarës së Habilit nga Kabili. Deri këtu mund të duket se Frojdi ka të drejtë. Mirëpo sikur Frojdi të kishte pranuar se ekzistojnë edhe disa faktorë tjerë që janë më të rëndësishëm se faktori seksualitet, edhe ai do të kishte pranuar se ky problem nuk mund të zgjidhet nëse seksualiteti konsiderohet si faktor më i rëndësishëm. Para se të përmendet çështja e seksualitetit, duhet të rregullohet kjo çështje: Është fakt se të pëlqyerit e të fejuarës së vëllait nga Kabili, ka qenë shkas për lindjen e këtij problemi. Mirëpo, përse vetëm Kabili sillet ashtu? Meqë e dijmë se të dy rrjedhin nga e njëjta origjinë dhe mjedis, a nuk duhet që të dy të kenë sjellje të njëjta dhe ta kenë të njëjtën vendosmëri dhe sinqeritet? Madje edhe pse sipas shkencës është e mundur që njëri nga vëllezërit, përsikaj kushteve identike në të cilat janë zhvilluar, të veprojnë ndryshe, parashtrohet pyetja se përse Kabili të jetë ai i cili do të sillet ashtu? E treta, kur të vlerësohet biseda mes dy vëllezërve, mund të vijmë në përfundim se Habili ka qenë tip i mirë, kurse Kabili i keq (e njëjta bisedë është e transmetuar edhe në librat e kristianëve dhe të hebrenjve). Qëllimisht e kemi përdorur fjalën “tip” në vend të fjalës “karakter”. Ngase sikur të kisha përdorur fjalën “karakter” do të nënkuptohej se Kabili ka karakteristika të këqija të pasionit dhe të materializmit, kurse për Habin do të mendohej se ka karakteristika të mira fetare dhe të ndieshmërisë. Në fakt njëri prej këtyre është simbol i një “njeriu të keq” tërësisht, kurse tjetri simbol i një “njeriu të mirë” tërësisht. Kjo është arsyeja që për Habin të vij në përfundim se është njeri me temperament të shëndoshë; njeri që nuk ka mundur ta devijojë, ta shtrembojë, ta bëjë të huaj për veten, apo ta fëlliqë rendi jonjerëzor, rendi i shoqërisë labile, rendi ekonomik dhe mënyra e punës. Të gjitha këto nuk kanë mundur ta paralizojnë dhe ta gjymtojnë. Apo siç do të kishte thënë Marcuses, ai nuk u fëlliq dhe “thye” me komplekse. Ai kishte një dashuri të madhe ndaj babait të vet, e donte edhe vëllanë dhe besonte në All-llahun. Nuk ishte rob i pasionit sikurse vëllai i vet. Mirëpo nuk i ishte i pandjenja dhe i pa interes ndaj bukurisë. Përsikaj të gjitha kërcënimeve dhe përpjekjeve të Kabilit (shpeshhere iu është kërcënuar edhe me vdekje), asnjëherë nuk e uli kokën dhe t’i thotë: “Merre më, sepse unë po heqi dorë. Merre e ytja qoftë, merre se nuk e meriton të diskutohet më!”

Habili as më shumë e as më pak, ai ishte mashkull, ishte i biri i Ademit a.s.... në të gjitha tregimet, pa përjashtim flitet për këtë. Sipas meje shkaku i kësaj, ishte të jetuarit e tij në shoqëri pa konfrontime e ndasi. Punonte punë të lira dhe pa zinxhirë. “As nuk i hypete devesë, e as nuk u ngarkonte si gomar, nuk ishte as zotëri i robërve, e as shërbëtor

i sultanëve.”¹⁰ Ai ishte vetëm një njeri. Në një shoqëri ku çdo kush njëjtë argëtohet, ku bashkarisht përdoren të mirat e kësaj bote dhe të gjitha burimet materiale dhe shpirtërore, të gjithë janë të barabartë dhe vëllezër. Bukuria, mirësia, pastërtia, dashuria dhe mëshira blerojnë nga vetvetiu.

Kabili nuk është i keq që kur lindë. Thelbin e ka të njëjtë me të Habilit. Askush nuk është i keq nga lindja, ngase thelbi i çdokujt, është i njëjtë me thelbin e Ademit. Ajo që e bëri të keq Kabilin, që bëri të lindë robëria dhe zotërimi, që e bëri njeriun ujk, dinak apo dele ndaj të tjerëve, ishte rendi jonjerëzor, shoqëria klasore dhe prona private. (“Prona private” ishte ajo që bëri t’i sundojë njeriu të tjerët, të bëhet egoist, të mbledhen burimet ekonomike në duart e një grupi njerëzish dhe që bëri të refuzohet ky ajet i Kur’anit Famëlartë: **“Atë që All-llahu nga banorët e vendeve (jobesimtare) ia dha pa luftë të dërguarit të vet, ajo i takon All-llahut, të dërguarit, të afërmve, jetimëve, të varfërve, kurbetçinjve. (Kështu veprohet) Që ajo të mos ndahet ndërrmjet pasanikëve tuaj. Çka t’ju jep i Pejgamberi, atë merrnie e çka t’ju ndalojë, përmbanju dhe kinie frikë All-llahun, se All-llahu është ndëshkues i ashpër.”** (Hashr: 7)

Ky ambient është ambient i cili e lindë armiqësinë, tashësinë, trafikun me njerëz, tiraninë, shtypjen, grykësinë, urinë, ambicjen dhe babëzinë. Në të filozofia e jetës është e ndërtuar mbi plaçkitjen dhe lajkatarinë. Jeta është e përbërë nga shtypësit dhe të shtypurit, egoizmi, mendjemadhësia aristokrate, akaparimi, hajnia, kryelartësia dhe mendjemadhësia. Themeli i marrëdhënieve të ndërsjellta është lajkataria e ndërsjellte dhe kolonizimi. Të vetmën gjë njerëzit presin nga jeta është argëtimi, prosperiteti, pasioni dhe pushteti i pafundt. Gjithçka bëhet për të tmerrshmin dhe lakmonjësin “unë”. Këto janë ato gjëra që të birin e Ademit a.s., Kabilin, vëllai i pastër i Habilit që ishte i mirë, i mëshirshëm, e bënë rob të seksualitetit, të gatshëm për të gënjyer në çdo çast, të bëjë dredhi, të bëhet krijesë që i ngjanë baltës dhe ta bëjnë të marrë që vrapon pas epshit. Jo zotëri Frojd, jo!.. Ai të gjitha këto nuk i bën për shkak se instiktet seksuale të tij janë më të mëdha se të tjerëve, por për shkak të dobësimi të jashtëzakonshëm të viryeteve të tij. Sikur të ishte në rregull ajo që e thotë Frojdi, ai do të kishte rrezikuar gjithçka për t’ia arritur qëllimit, domethënë se para Habilit do ta kishte sakrifikuar devenë e bukur me qime të kuqe. Sikur të kishte qenë në rregull ajo që e thotë Frojdi, me të dëgjuarit e propozimit të Ademit a.s., menjëherë do të kishte vrapuar në arë dhe do ta kishte ndezur tërë drithin. Mirëpo ai nuk veprooi ashtu për ta fituar pëlqimin e Zotit, ai solli vetëm një grusht drith.

Qëllimi i analizimit të hollësishëm të këtij tregimi nuk ka qenë për t’i deargumentuar qëllimet morale dhe për ta shpjeguar konfrontimin mes dy vëllezërve. Qëllimi ishte të shpjegohen dy llojet e prodhimit dhe dy kahjet e njerëzimit. Kjo është historia e njerëzimit, ku tregohet për njerëzimin e përçarë në dy grupe gjatë të gjitha periudhave, për atë se si ka filluar kjo luftë e cila ende është duke vazhduar mes këtyre dy grupeve. Grupin që e përfaqëson Habili është i përbërë nga të shtypurit të cilët gjatë tërë historisë janë të robëruar nga sistemi i pronës private të përfaqësuar me Kabilin. Grindja mes Habilit dhe Kabilit është një grindje e pafundt të cilën e përjeton çdo gjeneratë. Klasa dominante çdo herë e ka mbajtur lart flamurin e Kabilit. Ndërsa në anën tjetër janë ata të cilët çdo herë kanë jetuar me ndjenja hakmarrjeje për gjakun e Habilit dhe kjo ndjenjë është përcjellur të të gjitha gjeneratat të cilat në çdo periudhë kanë lufuar për drejtësi, liri dhe për besim të vërtetë.

¹⁰ Një varg nga “Gylistani” i Sadiut

Arma e Kabilit ishte “feja”, po ashtu edhe arma e Habilit ishte feja. Prandaj luftimi i fesë kundër fesë, është gjëja më e vjetër e historisë së njerëzimit. Në njërin anë është “feja e shirkut” e cila i emëron shok All-llahut dhe bëhet shkaktare e paganizmit dhe e ndasive në popull, kurse në anën tjetër është feja monoteiste e cila e mbronë njësimin e All-llahut dhe barazinë mes të gjithë njerëzve dhe klasave... Konfrontimi historik mes Kabilit dhe Habilit është konfrontim mes monoteizmit dhe paganizmit, mes drejtësisë dhe barazisë dhe mes ndasive shoqërore dhe racore. Konfrontimi mes “fesë” së rrejshme e cila thërret në mpierje dhe në statikë dhe fesë së vërtetë e cila thërret në gjallëri dhe në revolucion, ka vazhduar gjatë tërë historisë së njerëzimit dhe do të vazhdojë deri në fund. Ky konfrontim do të vazhdojë deri atëherë kur të vdesë Kabili dhe në vend të tij të vendoset përsëri “Rendi i Habilit”. Ky revolucion i pashmangshëm do të jetë fundi i historisë së Kabilit. Atëherë, në tërë botën do të ketë barazi, bashkim dhe vëllazëri mbi themelet e barazisë dhe të drejtësisë. Kjo është rrjedha e pashmangshme e historisë. Të gjitha sferat e jetës së njeriut do të përjetojnë revolucion universal. Do të realizohet sihariqi i All-llahut: ***“E Ne duam t’i lartësojmë ata që u shtypën në tokë, t’i bëjmë udhëheqës dhe t’i bëjmë trashëgues. Dhe atyre t’u japim pushtet në tokë, e faraonit, Hamanit dhe ushtrisë së këtyre dyve t’ua tregojmë atë që ruheshin (ia kishin frikën).”*** (Kasas: 5-6)

Ky revolucion i pashmangshëm i ardhmërisë, që ka filluar me konfrontimin e Kabilit me Habilin, kulminacionin e vet do ta arrijë me ndeshjen dialektike mes udhëheqësve dhe të udhëhequrve. Dhe pa dyshim se fundi apo fitorja, do të jetë e drejtësisë, barazisë dhe e të vërtetës.¹¹

Është detyrë e çdokujt ta gjejë vendin e vet në këtë konfrontim, e assesi të mos mbesë vetëm spektator i tij. Në njërin anë besojmë në determinizmin historik, kurse në anën tjetër besojmë se në thelbin e procesit të determinizmit historik gjendet liria e individit. Dhe nuk shohim ndonjë kontradiktë mes këtyre dy gjërave. Sepse historia që mund të tregohet shkencëtarisht, përparon në një determinizëm universal, mirëpo, individët janë ata që duhet të zgjedhin se a do të marrin pjesë me shkencë dhe me dituri në këtë rrjedhë, për ta përshpejtuar historinë drejt qëllimit të paracaktuar të saj; apo do të fusin injorancë, egoizëm, interesa që t’i kundërvihen drejt qëllimit të paracaktuar.

¹¹ Fjala drejtësi zakonisht përdoret kur ka të bëjë me lidhjet ligjore mes individëve apo mes bashkësive. Kurse barazia nënkupton përdorimi i të drejtës pa marrë para sysh se a i është njohur ajo e drejtë me ligj apo jo, pra përdorimi i të drejtës së mundit të dhënë. Drejtësia në mënyrë indirekte e simbolizon rendin juridik. Kurse barazia është e lidhur me përbërjen e shoqërisë. Ashtu siç është e nevojshme drejtësia për rendin juridik, poashtu edhe barazi nevojitet ndryshimi rrënjësor i përbërjes së shoqërisë.

DIALEKTIKA E SOCIOLOGJISË

Edhe sociologjia është ndërtuar mbi dialektikën. Shoqëria dhe historia janë të përbëra nga dy klasë prej të cilave njëra është klasa e Habilit, kurse tjetra është klasa e Kabilit. Paj edhe ashtu historia nuk është asgjë tjetër përpos se rrugë që e ka kaluar njeriu gjatë kohës së vet. Prandaj themi se shoqëria është sekcion që i përshtatet një periudhe të caktuar të historisë. Po qe se e nxjerrim nocionin kohë nga historia e një populli, do të ngelë vetëm shoqëria.

Sipas meje të gjitha bashkësitë njerëzore mund të vërehen dy lloje përbërjesh; njëra prej tyre është përbërja e Kabilite, kurse tjetra është përbërja e Habilite. Robërinë, kryepleqësinë, borgjezinë, feudalizmin dhe kapitalizmin nuk i shikoj si përbërje themelore të shoqërisë. Të gjitha këto hyjnë në përbërjen burokrate të shoqërisë. Marksi këto pesë faza (bashkë me një fazë tjetër e cila quhet Stil i Prodhimit të Llojit Aziatik) i shikon si me qenë brenda kufijve të socializmit primitiv dhe final. Të gjitha këto i futë në një kategori dhe çdo njërin e konsideron si me qenë “përbërje”. Sipas Marksit atëherë kur fshatari do të bëhet “agë” e qytetari “zotëri” ose atëherë kur fshatarët do të bëhen punëtorë, mund të flitet për ndryshim në përbërjen e shoqërisë. Ndryshimi që ndodhë pasi të zëvendësohet prona e përbashkët me pronën private, nuk dallon nga ndryshimi i sipërm.

Në shoqëri mund të ekzistojnë dy lloje përbërjesh: Shoqëria është zot i vetvetes, pra çdo kush punon për shoqërinë; ose individi është pronar i pronës dhe gjithësecili ia bën çaren vetes. Mirëpo të dy përbërjet bëhet fjalë për mënyra të ndryshme të prodhimit, të marrëdhënieve, të mjeteve, burimeve dhe mallërave. Të gjitha këto janë përbërja burokrate e shoqërisë. Për shembull, rendi i Habilit bazohej në barazi ekonomike, domethënë se ka ekzistuar pronë e përbashkët ku prodhimi është bazuar në çobani dhe në gjueti (që të dyja kanë ekzistuar në shoqërinë primitive); ose në prodhim që bazohet në industri (shoqëri pa klasa e post-kapitalizmit); pra në mjetet që janë përdorur për prodhim në stilin borgjez; apo mund të flitet për kulturë fshatare apo partizane e periudhës së feudalizmit. Në anën tjetër, në “përbërjen e Kabilit” ose në rendin e ekonomisë ku prona është e monopolizuar apo është në duart e një individi, mund të flitet për sisteme të ndryshme ekonomike, për marrëdhënie të ndryshme klasore, apo për mjete, lloje dhe burime të ndryshme. Robëria, kryepleqësia, feudalizmi, borgjezia, kapitalizmi industrial dhe imperializmi gjenden në përbërjen e sitemit të Kabilit. Mirëpo sipas meje, Marksi aq shumë i ka përzier disa vlera në historinë e filozofisë, sa që nuk ka arritur dot ta bëjë klasifikimin e fazave të zhvillimit shoqëror. Marksi i ka përzier tre gjëra: llojin e pronës, llojin e marrëdhënieve mes klasave, llojin e mjeteve për prodhim... Sipas Marksit këto janë periudhat e zhvillimit historik (ai të gjitha këto i pranon si ndryshime të përbërjes së shoqërisë):

- 1) Socializmi primitiv: Në këtë periudhë shoqëria jeton bashkë duke u bazuar në barazi. Prodhimtaria përbëhet nga gjuetia dhe peshkataria. Burimet prodhuese (pyjet dhe lumenjt) janë pronë e përbashkët. Masa përcaktuese e kësaj përbërjeje është lloji i pronës (pra prona e përbashkët).
- 2) Robëria: Në këtë periudhë shoqëria ndahet në dy klasa. Në zotërinj (pronarë të robërve) dhe robër. Marrëdhëniet mes këtyre dy klasave janë marrëdhënie mes “pronarit” dhe “mallit” (ose marrëdhënie mes “njeriut” dhe “kafshës”). Pronari i robit mund të veprojë si të dojë me robin (mjetin): Mund ta vrasë, ta rrahë, ta

shesë... Faktori përcaktues i përbërjes së kësaj faze janë lloji i marrëdhënieve të njeriut.

- 3) Kryepleqësia: Në këtë fazë toka është pronë e një klase të caktuar. Kurse klasa tjetër edhe nëse ka shpëtuar nga robëria, janë të lidhur me tokën dhe janë robër të saj. Kjo klasë mund të blehet apo të shitet bashkë me tokën. Statusi i tyre është më i lartë se statusi i robit, por më i ulët se statusi i fshatarit.
- 4) Feudalizmi: Është periudhë që bazohet në bujqisë dhe në pronën e tokës. Pronari i tokës, në masë të caktuar posedon forcë politike mbi fshatarët. Kanë të drejtë të mbledhin tatimin dhe nga lindja i kanë disa privilegjione shpirtërore të cilat ua trashëgojnë pasardhësve.
- 5) Borgjezia: Është periudhë e përbërë nga tregëtia, arti, jeta qytetare dhe nga këmbimi i parave. Klasa e mesme, (pra klasa mes fshatarëve dhe pronarit të tokës, apo klasa mes aristokracisë dhe serfit) që është e përbërë nga esnafët, tregëtarët, zejtarët, duke u bazuar në pasurinë e përfituar e mer vendin e aristokracisë. Në këtë periudhë zhduken marrëdhëniet pronar i tokës – fshatarë dhe në vend të tyre vërehen animet kah liberalizmi dhe demokracia.
- 6) Zhvillimi i borgjezisë dhe i industrisë në kuptimin e plotë të fjalës: Në këtë periudhë bëhet akumulimi i kapitalit dhe prodhimi fillon të bëhet në fabrikat e mëdha industriale. Dyqanet zëvendësohen me biznes qendra, dyqanet e vogla të çarshisë me kompani, punëtoritë zejtare me fabrika, këmbimore me banka, karvansarajat me bursa dhe tregëtarët me kapitalistë. Krahas parave, kanë filluar të përdoren poliset, çeqet, aksionet, letrat me vlerë. Fshatarët i lënë arat, punëtorët i lënë çarshitë, dyqanet dhe punëtoritë dhe kalojnë të punojnë nëpër fabrika dhe nëpër qendrat e ndryshme industriale. Për shkak se në vend të shatit, lopatës, sharrës, sopatës apo lopës, gomarit dhe parmendës fillon të përdoren maqinat, punëtorët tërësisht futen në shërbim të kapitalistit. Për arsye se punëtori përpara kapitalistit del duar thatë, mund të kërkojë t'i paguhet vetëm munda i dhënë. Në këtë periudhë është më shumë peng dhe i kolonizuar se sa në të kaluarën. Kjo është arsyeja se tanimë nuk quhet punëtor, por proleter.
- 7) Në këtë periudhë në njërin anë numri i kapitalistëve zvogëlohet, kurse në anën tjetër iu rritet kapitali industrial dhe pasuria. Ndërsa kjo krijon shtypje mbi proletariatin. Mirëpo, në të njëjtën kohë fillon të forcohet edhe proletariati, që më vonë të rezultojë mes luftë mes këtyre do poleve, luftë që do të mbarojë me fitore të proletariatit. Pas kësaj, industria dhe kapitali nuk do të jenë pronë private, por do të jenë pronë shoqërore, e bashkë me të nuk do të ekzistojë edhe ndasi klasore në shoqëri.

Nga e tërë kjo shohim se nuk ka kurrfarë dallimi në përbërjen e asnjë periudhe, duke ia filluar nga periudha e parë e deri te ajo e fundit, e shtata. Pra nuk dallojnë mes vete as e para, as e dyta, as e treta, as e katërta, as e pesta e as e gjashta. Kjo na dëshmon edhe një herë se gjatë tërë historisë kanë ekzistuar vetëm dy përbërje dhe se nuk është e mundur këtyre dy përbërjeve t'iu shtohet edhe ndonjë e tretë. Për shembull përbërjet e feudalizmit dhe të kapitalizmit industrial janë të njëjta; këtu shohim se në të dy rastet mjetet e prodhimit dhe burimet e prodhimit janë pronë private. Po ashtu shohim se në të dy rastet përbërja e shoqërisë bazohet në ndasi klasore. I vetmi dallim që mund të vërehet qëndron në përdorimin e mjeteve për prodhim, në teknikën prodhuese dhe në pamjen e jashtme e marrëdhënieve prodhuese që janë rezultat i procesit prodhues. Edhe e kundërta e tërë kësaj mund të jetë plotësisht e drejtë: Për shembull mund që marrëdhëniet prodhuese të jenë të njëjta, por shoqëria të ketë tjetër përbërje. Nëse japim

ndonjë shembull kjo do të kishte mundur të jetë kështu: Një shoqëri që merret me bujqësi dhe që përdorë mjete të njëjta, edhe pse mund të mos ketë kurrfarë ideshë për kapitalizmin dhe për industrinë, apo të mos ushqejë borgjezinë, me revolucion, me luftë apo me puç, mund të krijojë përbërje socialiste në shoqëri apo rend të pronës së përbashkët.

Më parë unë dhe anëtarët tjerë të fisit tim kemi jetuar me peshkim dhe gjueti të gjithë së bashku në barazi dhe vëllazëri. Shoqëria jonë e kishte vetëm një përbërje. Pastaj ai u bë pronar i pasurisë, kurse unë u varfërova. Ai u bë udhëheqës, e unë i udhëhequr... Çdo gjë mori tjetër ngjyrë, mjetet ndryshuan, mënyra e prodhimit u ndryshuan... mirëpo ai përsësi mbeti pronar i pasurisë, aspak nuk punoi; kurse unë vazhdova të jem i varfër dhe të punoj. Një ditë unë isha rob, e ai zotëri... Pastaj unë u bëra serf, ai pronar toke... Unë u bëra fshatar, ai agë... Pastaj unë e lash shatin dhe lopatën, ai zbriti nga kali dhe të dy së bashku erdhëm në qytet. Ai nga paratë që i kishte fituar nga shitja e tokës, bleu disa taksi vetura, kurse unë u bëra vozitës i taksi veturave. Tani ai ka një fabrikë ku unë punoj si proleter.

Ku dhe kur ndryshoi përbërja? E vetmja gjë që ndryshoi është forma, procesi, mjetet dhe lloji i mundit; të gjitha këto janë gjëra që kanë të bëjnë me përbërjen burokratike... Në të gjitha periudhat, me përjashtim të periudhës së parë të vëllazërisë dhe të barazisë, ai gjithmonë mbeti udhëheqës, kurse unë gjithmonë mbeta duke vrapuar për t'i shërbyer atij. Kjo përbërje do të ndryshojë vetëm atëherë kur të fillojmë të punojmë në të njëjtën tokë, me të njëjtat qe, me të njëjtën parmendë dhe me të njëjtën lopatë.

Nëse kjo është kështu, mund të themi se sipas këtyre dy përbërjeve shoqërinë mund ta ndajmë në dy pole: "Poli i Kabilit" dhe "Poli i Habilit".

1) Poli i Kabilit: Monarkët, pasanikët (pronarët e pasurisë), patricianët, (aristokratët)... Fazat e parë e zhvillimit social është përfaqësuar nga një person i cili në duar të veta e kishte pushtetin dhe fuqinë të përbëra nga monarkia, pasuria dhe patricia. Ajo përfaqësohej nga një fytyrë e vetme, nga fytyra e Kabilit... Mirëpo zhvillimi dhe evoluimi i sistemit social, i kulturës dhe i civilizimit dhe rritja e dimensioneve të ndryshme të jetës sociale dhe të përbërjes klasore, bëri që ky pol të fitojë tre dimensione dhe ta tregojë veten në tre forma. Njëra nga format është politike dhe quhet "pushtet", tjetra formë është ekonomike dhe quhet "pasuri" dhe e treta është fetare dhe quhet "fetari".

Në Kur'an Faraoni është simbol i fuqisë dominante politike, Karuni i fuqisë dominante ekonomike dhe Hamani është simboli i klasës dominante e cila është zyrtarizuar. Ata janë forma e trefishuar e Kabilit njëjës.

Në Kur'an këto tre forma janë përmendur si "mele", "mutraf" dhe "rakib", që nëse përkthehem me radhë do t'i kishim përkthyer kështu; gjakatarë dhe ambicioz, grykës dhe i babëzitur dhe klasa klerike që është e përbërë nga demagogë dhe mjekërrgjatë të zyrtarizuar dhe të institucionalizuar. Këto tre klasa, sipas radhitjes, vazhdimisht tentojnë të sundojnë, kolonizojnë dhe ta mashtrojnë popullin.¹²

¹² Islami e ka zhdukur çdo lloj të ndërmjetësimit të zyrtaritur (profesional) mes All-llahut dhe njeriut. Në Kur'an kur flitet për formën e tretë të Kabilit, pra për klerikalizmin zyrtar, përdoren shprehje (fjalë) të rrepta, madje duke shkuar edhe më tej, duke mallkuar, pasuesit e kësaj forme krahasohen me qenin dhe me gomarin. Pejgamberi i Islamit kështu thotë: "Ai që ka mjekër më të gjatë se sa kapë dora, do të jetë (do të digjet) në zjarrin e Xhehennemit." Ai nga njerëzit ka kërkuar që skajet e mangëve dhe të fundëve t'i mbajnë të shkurtëra. Të gjitha këto, tregojnë në luftën që e ka zhvilluar Islami kundër nocionit klerikalizëm që gjendet në fetë tjera dhe për tërheqjen e vërejtjes për rolin e tyre në çmendjen, devijimin dhe në shkatërrimin e njerëzve. Gjëja që duhet mbajtur mirë mend është ajo se në Islam nuk ka klasë klerike. Fjala "ruhaniun" e cila përdoret kohëve të fundit është marrë nga kristianizmi. Ne kemi dijetarë

2) Poli i Habilit: Të udhëhequrit, populli. Monarkët-pasanikët-patricianët, përballë klasës së trefishuar gjendet klasa e popullit, Nasi: këto dy klasa gjatë tërë historisë kanë qenë njëra kundër tjetrës dhe njëra përballë tjetrës. Në shoqërinë klasore, All-llahu është bashkë me Nasin (me popullin që i është bërë padrejtësi). Në çdo vend në Kur'an ku bëhet fjalë për temat sociale, emrat All-llah dhe Nas përmenden për njëri-tjeterin. Që të dy fjalët shpeshherë i ndërrojnë vendet në mënyrë reciproke dhe prap iu ngelë i njëjti kuptim.

Për shembull, *“Nëse All-llahut i huazoni diçka të mirë, Ai juve ua shumëfishon atë dhe ju falë; All-llahu është shumë mirënjohës, i butë.”* (Tegabun: 17) në ajetin që fillon në këtë mënyrë, qartë shihet se fjala All-llah e ka për qëllim fjalën “popull”. Ngase All-llahu nuk ka nevojë të marrë borxh nga askush.

Me përjashtim të temave ekonomike, në të gjitha temat shoqërore, sociale apo në temat që kanë të bëjnë me rendin e gjithësisë fjalët “Nas” dhe “All-llah” korrespondojnë mes vete. Kështu kuptimi i thënies *“grykimi (udhëheqja) i takon All-llahut”* është se udhëheqja është e popullit dhe se ajo bëhet me grykimet e All-llahut që në tërësi i takojnë popullit: pra jo atyre që veten e llogarisin si përfaqësues apo djem të All-llahut ose që mundohen të bëhen hyjnor apo të tregohen se janë të afër me All-llahun. Kur thuhet *“Pasuria i takon All-llahut”* mendohet në atë se e tërë pasuria nuk i takon vetëm një klase, por se në emër të All-llahut i takon tërë popullit, në të kundërtën thënien në fjalë do ta kishim kuptuar sikurse me qenë duke thënë se pasuria nuk i takon Karunit. Kuptimi i thënies *“Feja i takon All-llahut”* është se feja me tërë përbërjen dhe përmbajtjen e vet i takon popullit, në të kundërtën do ta kishim kuptuar si me qenë duke thënë se nuk iu takon personave të cilët veten e quajnë “kler” apo institucioneve që veten e quajnë “kishë”.

Fjala Nas (popull, njerëz) ka një kuptim të thellë dhe të veçantë në Islam. Kur'ani fillon me emrin e All-llahut dhe mbaron me emrin e popullit, Nas. Qabeja është Shtëpia e All-llahut, është Bejtull-llah, mirëpo All-llahu kur flet për të, e përdorë fjalën “shtëpia e popullit” apo “shtëpia e lirë” (Bejt’ul-atik) (22/29,33). Përdorim i kësaj fjale tregon se nuk është fjala për ndonjë shtëpi që është sikurse me qenë pronë private. Këtu shohim se fjala Nas nuk është koleksion personash, por se është e kundërta e “personave”, pra është “shoqëria”. Kuptim i fjalës Nas është shumës, kurse rrokja e këtij emri është njëjës, pra është fjalë që nuk ka njëjës. Cila fjalë më mirë mund ta shprehë identitetin e të gjithë personave, pra të “shoqërisë” sikurse kjo fjalë?

Të gjitha shoqëritë që kanë ekzistuar gjatë historisë, pa marrë parasysh se si i kanë definuar terminet nacionale, politike apo ekonomike, janë krijuar mbi sisteme kontradiktorë. Kjo kontradiktë në zemrat e tyre ka zënë vend. Në çdo shoqëri klasore, çdo herë kanë ekzistuar klasa e armiqëve dhe e kundërshtarëve të tyre: Në njërin anë

fetar, por ata nuk i krijojnë autoritetet zyrtare monopoliste që mundohen ta imponojnë veten, apo që e trashëgojnë pushtetin. Ata nuk janë dijetarë të specializuar që kanë dalur thjesht si rezultat i nevojës nga themeli i institucioanlizuar në shoqërinë islame. Ata prezencën, ndikimin dhe fuqinë e vet në shoqëri e marrin nga populli dhe nga zgjedhja e lirë dhe e natyrshme e anëtarëve të shoqërisë. Ata janë nxënës që qëndrojnë larg mëkateve dhe që iu përballojnë mundimeve, ose janë dijetarë që merren me arsim dhe me hulumtime. Nëse vendin e tyre e kanë okupuar injorantët, ajo mund të ketë ndodhur për shkak të injorancës së përgjithshme të shoqërisë, apo për shkak të disa faktorëve tjerë. Veshëmbathja e tyre nuk ka të bëjë me atë se i takojnë ndonjë kleri, por thjesht është simbol i diturive, analizave personale dhe hulumtimeve.

kanë qenë mbreti, patricët dhe aristokratët, kurse në anën tjetër Zoti dhe populli.¹³ Në njërën anë kanë ekzistuar disa fe, kurse në anën tjetër ka ekzistuar vetëm një fe.

¹³ Tre ajetet e para të kaptinës Nas kështu janë: ***“Thuaj: “Mbështetem (mbrohem) me Zotin e njerëzve! Sunduesin e njerëzve. Të adhuruarin e njerëzve,...”*** All-llahu nuk është Zot vetëm i një klase apo shtrese elite të caktuar, ai është Zot, Sundues dhe i Adhuruar i popullit.

SHOQËRIA IDEALE: UMMETI

Shoqëria ideale islame quhet ummet. Fjala ummet e cila i ka zëvendësuar fjalët “shoqëri”, “komb”, “racë”, “popull”, “klan” etj., që përdoren në gjuhët dhe kulturat tjera, është përplot e mbushur me shpirtë përparimtar dhe dinamik, dhe po ashtu e përfaqëson shoqërinë me besim dhe ideologji.

Fjala ummet rrjedhë nga fjala umm që e ka kuptimin e rrugës dhe qëllimit. Kjo është arsyeja që ummeti dotëthotë shoqëri me një besim, me qëllime të përbashkëta, drejt të cilave në mënyrë të harmonizuar ecin të gjithë së bashku.

Nocionet tjera edhe pse si bazë të veten e kanë gjakun, bashkimin mbi pronën tokësore dhe interesat materiale, Islami duke e zgjedhur fjalën ummet, e ka vënduar themelin e filozofisë shoqërore të përgjegjësisë ideore dhe të ecej drejt qëllimit të përbashkët.

Baza materiale e ummetit është ekonomia. Sepse “ai që nuk ka botë materiale nuk mund të ketë as botë shpirtërore”. Rendi shoqëror bazohet në barazi, drejtësi, në pronën e shoqërisë, si dhe në ringjalljen e rendit të Habilit të shoqërisë pa klasa. Ky është parimi kryesor dhe nuk e ka qëllimin e njëjtë me socializimin perëndimor i cili nismën e vet e ka nga qëndrimi i borgjezisë perëndimore.

Regjimi dhe filozofia politike e ummetit nuk është demokracia e kotë, liberalizmi i paqëllimtë dhe i papërgjegjshëm, aristokracia e glinës, diktatoriati armik i popullit dhe oligarkia; por udhëheqësi revolucionare me besim dhe me përgjegjësi që krijohet mbi themelet e qëndrimeve dhe të ideologjisë së shoqërisë që e lëvizin njeriun drejt qëllimit të krijimit të tij. Ky është kuptimi i vërtetë i imametit.

NJERIU IDEAL

Njeri ideal është ai që i ka fryer All-llahu nga shpirti i vet; është njeriu teomorfik që ka e ka mundur Iblisin (djallin), baltën dhe dheun. Që ka shpëtuar nga dyshimi dhe hezitimi dhe nga “dy kontradiktat e pafundta”. “*Me u moralizua me moralin e All-llahut*”, kjo është filozofia edukative dhe masa primare e yneja. Lënia anash e të gjithave vlerave konstante dhe tradicionale dhe moralizimi me moral të All-llahut; dotëthotë ecje përpara drejt qëllimit dhe perfektizmit Absolut. Kjo nënkupton edhe evoluimin e pafundt në vend të mbetjes si njeri monotip i cili mbyllet mbrenda kornizave. Njeriu që duhet të jetë, por që assesi nuk mund të arrijë të bëhet, është dydimensional; është shpend që mund të fluturojë me të dy kthetrat. Ai dallon nga njerëzit e mirë dhe të fortë të edukuar sipas kulturave dhe civilizimeve të tjera. Njerëzit e këtyre civilizimeve ose janë të pastër dhe besimtarë, mirëpo të pavetëdijshëm dhe të mpirë, ose janë të fuqishëm dhe gjenij, mirëpo janë guximfortë dhe mëkatarë. Në njërin anë, veten e japin pas jetës së fshehtë, bukurisë dhe pas sekreteve të shpirtit, mirëpo jetën e kanë të varfër, të prapambetur, të mposhtur dhe të dobët. Pikërisht sikurse qindra mijë hindusë të varfër me ndjenja të thella që i kushtojnë rëndësi tepër të madhe spiritualizmit, por që ishin robër të një grusht anglezësh. Në anën tjetër janë ata të cilët me forcën e industrisë kanë ecur mbi tërë sipërfaqen e tokës, kanë hypur mbi të gjitha majet, kanë lundruar në të gjitha detërat dhe jetën e kalojnë në argëtim dhe pasuri, kurse bashkë me to, i zhdukin edhe vlerat njerëzore; nuk mund ta konceptojnë kuptimin e botës, thellësinë e jetës, krijimin e bukurisë; nuk e dijnë se ekziston diçka tjetër jashtë historisë dhe natyrës që duhet besuar.

Njeriu ideal duke u nisur nga natyra, orvatet ta kuptojë All-llahun: e kërkon njerëzinë, arrinë të Zotit. Nuk i mbyllë sytë para natyrës, nuk ia kthen shpinën njerëzimit. Në dorë e mban shpatën e Cezarit, kurse në gjoks guximin e Isasë a.s. Mendon me trurin e Sokratit, kurse All-llahun e don me zemrën e Hallaxhit. Bukurinë e shkencës dhe të Zotit i sheh me mallin e Alexis Carelit; i dëgjon fjalët e Pascalit dhe të Descartesit.

Zbret sikurse Budha nga kulla e fildishtë e egoizmit dhe e argëtimit; mendon sikurse Lao Ce për urtësitë e fshehura të krjimit; mendon sikurse Kjonfuçio për fatin e shoqërisë.

E ngrit zërin kundër robëruesve, sikurse Spartacusi.

Në vete e mban mesazhin e dashurisë dhe të paqes të Isasë a.s., dhe mesazhin e xhihadit dhe të shpëtimit të Musasë a.s.

Nuk qëndron pa u interesuar fare për fatin e njerëzve për shkak të mendimeve filozofike; marrja me politikë nuk e çon në demagogji dhe në adhurim të famës.

Nuk e pengon as shkenca në besim, e as besimi në të menduarit dhe në përdorimin e logjikës. Ai është njeri i xhihadit dhe i interpretimit, i poezisë dhe i shpatës, i vetmisë dhe i besimit, i ndjenjave dhe i mendjes, i fuqisë dhe i dashurisë, i besimit dhe i diturisë.

Ai në vete i bashkon të gjitha dimensionet e njerëzimit të vërtetë. Jeta që e jeton nuk e bën krijesë njëdimensionale, të thyer dhe të mposhtur. Duke u bërë rob i All-llahut, shpëton nga të qenurit rob i objekteve dhe njerëzve. Duke iu dorëzuar vullnetit absolut të All-llahut, e pranon se do t'i kundërvihet çdo vështirësie që do t'i del përballë. Egon e vet të vdekshme e shkrinë në identifikimin e përjetshëm të njerëzimit dhe duke kaluar nga egoja, arrinë në përjetshmëri. Mbi vete e ka marrë amanetin e All-llahut, prandaj është bërë krijesë e varur dhe që merret në përgjegjësi për vullnetin e lirë. E din se përsosmëria nuk iu është dhënë si privilegjion për ta përdorur kundër njerëzve të tjerë,

por për t'u orvatur që të bëhet vet i përsosur, për t'iu afruar All-llahut, për t'i ndihmuar tërë njerëzimit që të përsoset, për ta fituar shpëtimin dhe lirinë njerëzimi, për të mundë me duruar para vështirësive, urisë, varfërisë dhe torturës, për të qenë i lidhur me përpjekjen shoqërore dhe ideologjike.

Ai nuk e ndryshon formën sipas mjedisit, por përkundrazi, mjedisit ia ndryshon formën. Të gjitha presioneve që i vijnë nga shkenca dhe teknologjia iu shpëton me besim dhe me vetëdije. Arrinë të shpëtojë nga vështirësitë e natyrës dhe trashëgimisë, historisë, shoqërisë dhe mjedisit. Gjithashtu arrinë të mbrojë veten nga inovacionet shkencore dhe teknologjike. Nga epshi i vet shpëton me dashuri. Individualitetin e vet e mbron nga vlerat dhe rregullat e trashëguara nga shoqëria apo nga raca (të gjitha janë relative dhe produk i mjedisit) e vet dhe të njëtat i zëvendëson me rregulla të përjetshme, hyjnore. Moralizohet me moral të All-llahut. Hjekë dorë nga të menduarit vetëm për arsye se ia ka bërë detyrë vetes. Moralin nuk e shikon si me qenë përmbledhje ndalesash që ia ka imponuar vetëdija shoqërore. Mirësinë e identifikon me njerëzi; vlerat e larta bëhen thelbi i individuës. Të jetuarit, të menduarit, të dashuruarit unifikohet me këto që u numëruan.

Arti në duart e tij nuk është lodër apo argëtim që i shërben për ta zbrazur energjinë e akumuluar. Nuk është robër i seksualitetit, politikës apo i kapitalit. Arti është amanet i posaçëm që ia ka dhënë All-llahu njeriut. Fuiqa e lirisë, vetëdijes dhe e krijimtarisë absolute i takon All-llahut. All-llahu njeriut që ia ka dhënë amanetin e që e ka krijuar në përputhshmëri me formën, është vullnet i pafundt i mbushur me bukuri, virtyte dhe me urtësi. Në tërë natyrën njeriu është i vetmi që ka liri, vetëdije dhe krijimtarie relative.

Njeriu ideal i ka tre cilësi: Dretësinë, mirësinë dhe bukurinë; me fjalë tjera i ka diturinë, moralin dhe artin. Ai është zëvendës i All-llahut. Është lëshuar mbi sipërfaqen e tokës duke u pajisur me dashuri dhe me dituri. Gjithçka është nën urdhërin e tij. Madje edhe melekët iu janë përrulur. Zëvendësi i All-llahut, duke e bartur barrën e amanetit me robëri, ka arritur të vijë deri në fund të historisë dhe të natyrës.

Ringjallja është në prag të fillimit.